# P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.12.2020,** me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatoj se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës **z. Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,**
3. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen " Qytetar Nderi " Gjeneralin Ton van Loon,**
4. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB ) për vitin 2021,**
5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth Shërbimeve të varrimit për vitin 2021,**
6. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve, lagjeve urbane rreth emërtimeve të reja,**
7. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private,**
8. **Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për dalje ne debat publik të Draft rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës se Rahovecit,**
9. **Shqyrtimi i Planit vjetor të prokurimit për vitin 2021,**
10. **Shqyrtimi i realizimit të planit të punës për vitin 2020 të Auditorit të Brendshëm si dhe shqyrtimi i planit të punës për vitin 2021,**
11. **Shqyrtimi i Raportit të punës të Kuvendit Komunal për vitin 2020,**
12. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës se Kryetarit të Komunës për vitin 2021,**
13. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës se Kuvendit të Komunës për vitin 2021,**
14. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.131/20, të datës 30.11.2020, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër,**
15. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër,**
16. **Informatë rreth konkursit ndërkombëtar për dizajnimin e Sheshit Qendror të Qytetit të Rahovecit,**

Të nderuar kolegë kuvendarë, ky është rendit i ditës por desha të ju informoj dhe të ju njoftojë se është kthyer një vendim nga MAPL-ja për shfuqizimin e vendimit nr.132/20, i datës 30.11.2020 për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore ne tokë ndërtimore. Kështu që ju kisha lutur që ta kemi edhe këtë pikë shtesë të rendit të ditës që ta shfuqizojmë këtë vendim.
**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për ju, kryetarin e komunës, nënkryetarin, anëtarët e Kuvendit Komunal, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-së, të mjeteve të informimit dhe të gjithë të pranishmit në sallë.
Unë desha të ngre një shqetësim rreth pikës dhjetë, ku mendoj që pika e dhjetë është e përberë prej dy pikave të rendit të ditës sepse  se paku duhet te jetë ashtu, pasi bëhet fjalë për raportin vjetor të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm e pastaj e kemi edhe planin e punës, kështu që do të ishte mirë këto me i trajtua si dy pika të veçanta dhe jo në pako dhe për me dëshmua është që me pas për punën e Kuvendit, ku e kemi rastin që plani i punës së Kuvendit është i veçantë dhe raporti për punën e Kuvendit është i veçantë. Kështu që propozoj që këto të trajtohen ndaras si pika të veçanta njëra pas tjetrës menjëherë, besoj që edhe kolegët tjerë pajtohen për këtë propozim.
**Kryetari** – Përshëndetje për të gjithë. Kjo është në kuadër të planit vjetor të punës se kuvendit që është miratuar nga ky kuvend dhe kështu janë hy si dy pika të integruara në një fjali por në fakt janë dy pika, pasi ky Kuvend ka vendosur kështu qysh para një viti prandaj ne e kemi paraparë sipas planit të Kuvendit. Pasi edhe ashtu de fakto do të diskutohet ndaras mirëpo në planin e punës se kuvendit është kështu e formuluar dhe është futur kështu.
**Kryesuesi** – Faleminderit shume kryetar, gjithsesi pika e dhjetë  rendit të ditës trajtohet ndaras njëra me tjetrën.
**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë të pranishmit. Po ashtu edhe unë dua të ndërlidhem sa i përket rendit të ditës, në pikën e gjashtë shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të komisionit për emërtimin e rrugëve shesheve dhe lagjeve urbane rreth emërtimeve të reja, ku propozoj që edhe kjo pikë të ndahet ne dy pika, ku e para të jetë aprovimi i listës rezervë apo përditësimi i listës rezervë me emrat që i ka propozua komisioni për emërtim që i ka në regjistër e pastaj emërtimet pasi edhe udhëzimi administrativ na sugjeron që fillimisht ne duhet ta aprovojmë një listë rezervë, meqenëse listës se vjetër i ka kalua afati 5-vjeqar i validitetit dhe ne duhet ta përditësojmë listën  e pastaj të kalojmë ne vendimmarrje për emërimin e rrugëve dhe shesheve të reja. Pra propozoj konkretisht që fillimisht të jetë aprovimi i listës rezervë e pastaj kjo pikë ashtu siç është formuluar në rend dite.
**Kryesuesi** – Faleminderit z. Durguti, kur të mbërrimë te pika e gjashtë do ta trajtojmë mirëpo edhe në mbledhjen e kaluar e kemi marr një vendim kuvendi sa i përket listës rezervë.
Të nderuar kolegë kuvendarë, e qesim ne votim rendin e ditës me pikën shtesë. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikën shtesë. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Të nderuar kolegë kuvendarë, siç po shihni edhe ju, ne sot po mbledhjen po e zhvillojmë ne kushte pak jo edhe te zakonshme për shkak të rregullimit të sallës se kuvendit dhe mbledhjen e radhës do ta zhvillojmë ne sallën e re dhe njëkohësisht kërkoj edhe mirëkuptimin e juaj. Kështu që a ka dikush diçka rreth procesverbalit. Atëherë nëse jo e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pare e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e Kuvendarëve.**

**Fehmi Hoxha –** Përshëndetje i nderuari kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të ekzekutivit, kolegë kuvendarë. Para se me kalua atë që deshta të them, kryetar se bashku me ekzekutivin është dashtë me na sigurua parkingun për kuvendarë para shtëpisë se kulturës që të kishim mundësi ku te parkojmë makinën. Në këtë pikë të rendit të ditës i kam dy çështje, e para ka të bëjë me vendim marrjen e kaluar në kohen e qeverisë tonë, kam marr një vendim për zgjerimin e zonës ndërtimore në pjesën përsipër të rrugës qarkore e cila ka

qenë ne ndërtim atëherë dhe me pastaj e keni vazhduar edhe e keni përfunduar edhe ju. Aty është një vendim i kuvendit komunal me 103 hektarë që është bërë zgjerimi i zonës ndërtimore dhe sipas Planit Zhvillimor Komunal të ri është paraparë që ajo të jetë zonë ekonomike komerciale, me të vetmin qëllim atëherë kur kemi shpallur atë kemi kërkuar dhe që kemi pasur mirëkuptim nga të gjithë kuvendaret atëherë dhe me vota unanime është marrë vendimi për zgjerimin e asaj zone, me të vetmin qëllim që Agjencioni Pyjor i Kosovës të mos i jep më shfrytëzim individëve të ndryshëm që mos me degradua atë zonë. Mirëpo një ditë unë kalova andej edhe e pash se në atë peisazh natyror që fillon me një mrekulli siç është Maja e Shkodranit dhe gjitha ato shtigje që janë bërë me rrugën që vërtetë është një mrekulli në vete dhe që Rahoveci duhet të mburret me atë pjesë, mirëpo dikush patjetër i ka dhënë ndonjë pëlqim ose vërtetim individit i cili tani e ka hapur fermën e dhenve atje e që është degradim total për Rahovecin. Pra pa një vetëtimë apo pëlqim nga ana e Komunës ai nuk mundet me marr në shfrytëzim atë nga Agjencioni Pyjor i Kosovës dhe sinqerisht të them se është bërë një gabim shumë i madh dhe kërkoj urgjentisht të tërhiqet ai pëlqim ose vërtetimi që i është dhënë dhe të kërkohet nga Agjencioni Pyjor i Kosovës që të largohet operatori faktikisht ajo fermë që është atje që shumë keq është për Rahovecin. Mirëpo pasi që veç është miratuar rendi i ditës, kërkoj kryesuesi, kryetari , Komiteti për Politikë dhe Financa që në seancën e parë të muajit janar të dilni me një propozim vendim para kuvendit dhe te merret vendimi këtu pas shqyrtimit që të subvencionohen bizneset kryesisht në rrugën Xhelal Hajda – Toni prej Kosova Petrol e deri në fund atje në dy anët, duke ditur që ne këtë kohë pa kohë të pandemisë ato biznese mëzi po funksionojnë për shkak të ndërtimit që po bëhet aty dhe që është mirë që po ndërtohet kanalizimi atmosferik mirëpo ato biznese janë të bllokuar dhe njëkohësisht edhe në rrugën në fshatin Fortesë ku janë duke u zhvilluar punimet e asaj rruge me katër korsi. Pra, duhet të dilni me një propozim vendim para Kuvendit që të subvencionohet bizneset dhe kërkesa jonë është që minimum të jetë 1000 euro. Ju lus që ta shqyrtoni mundësinë nga pozicionimi i subvencionimit për vitin e ardhshëm edhe të ju dalim në ndihmë bizneseve që janë në prag të falimentimit.

**Ali Morina –** Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asamblistë. Unë deshta me ngritë një çështje rreth një kërkese të banorëve të fshatit Ratkoc. Kërkesa ka të bëj me vendosjen e rrethojave ne urën që është ne rrugën kryesore R-111 të rrugës rajonale apo konkretisht rruga Visar Hoti si dhe ne urën ne rrugën Vëllezërit Lleshi. Këto kërkesa janë të domosdoshme sepse paraqet pengesë për këmbësorët mos prezenca e rrethojave e sidomos ne urën ne rrugën Vëllezërit Lleshi, tash është mirë që është zgjeruar ajo rruge dhe është bërë me funksionale sepse vërtet ka qenë shume e ngushtë.

**Rasim Fazliu –** Unë e di që nuk është në kompetencë të Komunës që do ta ngrisë këtë çështje por më që Kryetari është përfaqësues i të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit, e kisha lutur kryetarin që të bisedojë me KEDS-in sepse kemi shumë probleme të mëdha me rrymën elektrike pasi nuk funksionojnë pajisjet që i kemi nëpër ekonomitë familjare dhe kemi shume prishje dhe probleme tjera, kështu që edhe pse nuk është në kompetencën tuaj mirëpo si Kryetar Komunë do ishte mirë me bisedua edhe me zgjidhë këtë problem.

**Fehmi Cena –** Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorë të drejtorive, media dhe që janë prezentë në këtë sallë. Unë desha shkurt me ngritë një çështje që pastaj ndërlidhët ngushtë me një pyetje për kryetarin në fund. Viti që po e lëmë pas pra viti 2020 ishte një vit i vështirë për të gjithë për shkak të pandemisë Covid-19 ku janë infektuar shumë qytetarë dhe kemi pasur shume raste që kanë përfunduar fatkeqësisht me vdekje, që edhe me tutje pandemia po vazhdon. Ne jemi ne dijeni që një numër i madh i komunave e ndoshta edhe të gjitha në nivel të Kosovës kanë ndarë një pjesë të buxhetit për me i dalë në ndihmë qytetarëve që kanë qenë të sëmurë nga kjo sëmundje. Atëherë pyetja është për kryetarin që a keni menduar edhe ju me nda një pjesë të buxhetit për të ju dalë në ndihmë këtyre qytetareve të komunës tonë.

**Sali Sallteku –** Përshëndetje për te gjithë juve. Më herët z. Fehmi Cena e fajësoj kryetarin mirëpo për atë që unë dola jashtë, mendoj që fajet i ka kryesuesi e jo kryetari. Ka me shume se 2 muaj që nuk kamë qenë ne Rahovec mirëpo për fatin e mirë e pashë që rruga ne fshatin Fortesë ishte bërë me asfalt mirëpo shihet që është punuar dobët dhe nuk ka jetëgjatësi kështu që i keni maltretuar qytetaret e komunës se Rahovecit duke përdorur atë rrugë te dëmtuar me pluhur dhe me gropa. Po ashtu e kam një pyetje edhe për drejtorin e arsimit, pasi nuk kam qenë para kësaj here dhe ka qenë drejtori i shkollës bashkë me një qytetar që për mua nuk është qytetar i ndershëm pasi ka marr një pronë mbi 1 hektar fshatit tonë në kohën e pushtuesit, mirëpo tash ai qytetar që e ka marr atë pronë ka kërkuar me i hap rrugë apo diçka tjetër. Kështu që kisha kërkuar nga kryetari që me ardh gjeodetët edhe me caktuar pikët e hapësirës së pronës së shkollës pasi e gjitha është pronë e shkollës dhe e gjithë fshatit, kështu që mundësisht drejtori i arsimit me na tregua se çka ka kërkuar ai qytetar apo çka ka kërkuar tjetër dhe nëse nuk ka kërkuar rrugë me ardh me gjeodetë dhe me i caktuar shenjat për të gjitha pikat. Pra mundësisht kisha kërkuar nga ju kryetar dhe nga drejtori i arsimit që duhet ta kryeni këtë punë pasi ai është një qytetar i pandershëm, kështu që duhet të intervenohet sa me shpejt që të vendosen pikat me gjeodetë ashtu siç kanë qenë dhe kërkoj nga drejtori i Arsimit me na dhënë një përgjigje rreth kësaj çështje.
**Refki Kryeziu –** Faleminderit i nderuar kryesues, përshëndetje për kryetarin, drejtorët, kolegë asamblistë dhe gjithë të pranishmit. Unë e pata një pyetje pasi qysh ne fillim të mandatit e kam ngritë një shqetësim të banoreve të fshatit Xerxë që rruga Rrustem Kryeziu ne Xerxë është pa kanalizim dhe pa ujësjellës. Aty janë me shume dhjetë familje që banojnë dhe e kisha lutë drejtorin e Shërbimeve publike që ta ketë parasysh që edhe këtë shqetësim të banoreve të asaj lagje të zgjidhet kjo çështje sa i përket problemit me kanalizim dhe ujësjellës.
**Rukije Krasniqi –** Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin dhe gjithë të pranishmit në sallë. Kam një pyetje për kryetarin në lidhje me parkingjet që po ndodhin tek pallati jonë, pasi janë katër garazhet të vjetra të makinave dhe përsëri kanë ndërtuar të reja dhe njëkohësisht i kanë uzurpuar me shenjat e trekëndëshit, kështu që kemi trefishin e uzurpimeve të parkingjeve në atë lagje dhe nuk kemi vend ku të i parkojnë makinat banoret tjerë të pallateve. Pra duhet të intervenohet që të lirohen dhe te merren masa për këto uzurpime.
**Kryetari –** Faleminderit shume të gjithëve, i dëshiroj mirëseardhje Refkisë, e di që ka pasur probleme shëndetësore kështu që mirë se ke ardhur në Kosovë dhe besoj që do të jenë të shkuara dhe të harruara problemet që keni pasur. Ka pasur dilema rreth mandatit por është fat i mirë por që krahas përballjes që ka pasur me gjendjen shëndetësore ka arrit me dokumentua dhe me plotësua kërkesën që sot është përsëri anëtar i rregullt i kuvendit komunal në Rahovec. I nderuari kryesues, nënkryetar, anëtar të kuvendit komunal, drejtor të drejtorive, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Është takimi i fundit i rregullt i kuvendit të Komunës se Rahovecit, ku fillimisht dëshiroj të ju falënderoj për bashkëpunimin për një komunikim mjaft intensiv edhe për një punë jashtëzakonisht të madhe që kemi bërë bashke me te metat dhe përparësitë e arritjet e sfidat dhe te gjitha ato që i kemi diskutuar në këtë kuvend, kështu që ne kemi arrit bashkërisht me ndikua ne mirëqenien e qytetareve të Komunës se Rahovecit sepse janë diskutuar dhe janë marr shume vendime te rëndësishme nga ky kuvend ne 12-të seanca dhe shpresoj që edhe ne këtë mbledhje te rregullt do të merren vendime. Unë ju falënderoj publikisht edhe si kryetar i komunës por edhe ne emër të qeverisë që unë e drejtoj. U ngritën disa shqetësime si zakonisht dhe besoj që të gjitha këto shqetësime janë me vend dhe reale, ku fillimisht Rukije Krasniqi ka ngritur çështjen e parkingut i cili është i rregulluar por nuk është ende parking legal me vendim të Kuvendit të Komunës. Zakonisht ne raste te tilla parkingjet shfrytëzohen prej atyre që banojnë dhe jetojnë aty, që po ashtu janë ndërmarr disa veprime që kanë qit edhe pengesat e veta që secili me parkua makinën e veta secili por si duket edhe ne atë aspekt nuk ka ndonjë rend, po ashtu ju e dini që janë edhe disa baraka që mund te jen legale që paguajnë qira por ka edhe ilegale. Mendoj që duhet me marr

seriozisht edhe me u lirua parkingu edhe me u shpall si parking zyrtar ose me u dedikua për ata që banojnë apo jetojnë aty edhe sigurisht edhe me u largue ato baraka aty që realisht ja shtojnë bukurinë atij vendi. E kemi diskutuar bashke ne bordin e drejtoreve edhe me drejtorin e shërbimeve publike dhe është konsideruar si hap jo i duhur e ndoshta edhe arrogant nëse do të ju merren ato baraka apo ndërtime ku njerëzit kanë vendosur aty gjësende te ndryshme dhe e kanë në shfrytëzim për me shume se 20 vite. Por sigurisht që ne mundemi me shqyrtua edhe njëherë vitin 2021 këtë çështje. Pastaj Refki Kryeziu e ka ngritë çështjen e rrugës Rrustem Kryeziu që ka mungesë të kanalizimit dhe të ujësjellësit. Ne tashme kemi një kontratë e ndarë në 3 pjesë apo 3 lote edhe besoj që kompania do të mbërrin me realizua edhe këtë rrugë, mirëpo tani janë ndërpre punimet për shkak të kushteve atmosferike pasi tash jemi në stinën e dimrit dhe nga data 23 dhjetor me përjashtim te dy apo tre kompanive që janë ne punim mirëpo këto tjerat i kanë ndërpre punimet dhe unë besoj se është në agjendën e aktiviteteve tona, në momentin kur krijohen kushtet dhe rregullohet koha dhe besoj që do të jemi aty dhe ne plot rrugë tjera në qytet dhe ne fshatra, po ashtu edhe ne kanalizim kemi kontratë dhe besoj që nuk do të ketë ndonjë problem rreth kësaj. Pasta Sali Sallteku ka folur për rrugën në Fortesë, si e dini se e kam thënë disa herë dhe po e përsëris se jam i pakënaqur me mënyrën se si ka operuar kompania ose operatori ekonomik Viktoria Invest bashkë me nënkontraktorin tjetër dhe mëzi që kemi mbërri me prua punën që me shtrua një shtresë të përkohshme dhe për këtë nuk e ka marr asnjë edhe një cent dhe nuk ju ka pranua puna pasi që ka edhe dy shtresa tjera e me pastaj të i pranohet puna. Pra qëllimi im si kryetar komune edhe i drejtorit të shërbimeve publike ka qenë me mbërri deri në një pozicion se me qenë e kalueshme për këtë vite. Pra kjo ka qenë zgjidhje e përkohshme dhe jemi duke shqyrtuar mundësitë dhe modalitetet e shkëputjes se kontratës, pasi e di shume mirë për vështirësitë që kanë pasur qytetaret që kanë kaluar çdo dit aty dhe sigurisht edhe vet kam kaluar andej edhe kemi pasur shume ankesa dhe po ashtu kam pasur problem edhe me pronaret e kësaj kompanie që realisht nuk është se kemi edhe një komunikim jo të duhur dhe i kemi detyruar që me shtrua ashtu siç shihni tani që vetëm qytetaret të kenë mundësi që të mos kalojnë neper ato gropa këtë vite. Po ashtu ka ngritë çështjen dhe nuk e di a është drejtori i gjeodezisë mirëpo do të interesohemi pasi nuk jam i informuar dhe shpresojmë që nuk ka ndodhur ndonjë transaksion legal dhe nëse nuk ka ndodhur diçka atëherë do të interesohemi rreth kësaj dhe do të i japim epilog pozitiv kësaj situate në përputhje me shqetësimin ose kërkesën që e patët edhe ju. Te pyetja e drejtuar nga Fehmi Cena që ka folur potencialisht rreth subvencionimit e të infektuarve me Covid-19, me disa komuna te Republikës së Kosovës e dini që kemi marrëdhënie kanë pasur teprica buxhetore apo siç thuhet suficite edhe e kanë thirr kuvendin e komunës për ndihmë një komunë përkatëse edhe i ka subvencionua. Mirëpo ne shkojmë me 99% të shpenzimit të buxhetit edhe nuk kemi suficite dhe sigurisht që do ta shqyrtojmë dhe e kemi shqyrtuar gjatë se qysh do të gjejmë mënyra apo modalitete me ju ndihmua atyre që kanë qenë të infektuar me Covid-19 dhe atë që kanë vdekur si pasoj nga Covid-19, që sigurisht që do ta diskutojmë ne seancën e janarit apo të shkurtit dhe nuk ka mundësi tjetër përveç subvencioneve dhe ju e dini sa ka subvencione komuna e Rahovecit sepse e keni votua buxhetin por do të shohim se cilat do të jenë modalitetet dhe mundësitë që do të i shqyrtojmë bashke me ju. Pra e kemi diskutuar mirëpo nuk kemi pasur mundësi buxhetore për shkak se i kemi hargjuar mjetet pra edhe subvencionet edhe kapitalet edhe mallrat dhe shërbimet kështu që jemi bukur mirë sa i takon edhe realizimit të buxhetit dhe po ashtu edhe shpenzimit të buxhetit dhe kjo është një performancë e mirë për te gjithë ne bashkë për qeverisjen kryetarin e komunës por edhe për kuvendin e komunës. Pra jemi nder komunat që nuk e ka problemin e suficitit e që është mirë pasi ndikon edhe ne vlerësimet tjera që i bëjnë organizatat tjera. Pastaj pyetja e drejtuar nga Ali Morina për rrugën rajonale siç është rruga Gradish – Kramovik por edhe rrugët tjera rajonale magjistrale, ju them të drejtën ata i kanë disa kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve, ne vazhdimisht ju bëjmë presion me shkresa e ankesa por absolutisht nuk varet nga ne. Tash te rrethimi i një ure apo dy urave që pajtohem edhe unë që është rrezik edhe për ura tjera që janë neper rruge tjera rajonale është përgjegjësi e

ministrisë mirëpo për këto raste që po ka edhe donatorë që po investojnë ne këso raste edhe pse nuk kanë të drejtë me intervenua pasi është përgjegjësi e Ministrisë përkatëse kështu që nëse edhe vet kemi mundësi me krye ato punë por jo me buxhete të komunës siç është rasti ne Ratkoc te rrethojat e urës se madhe që donator është një qytetar i lagjes se Bilallve dhe mundet edhe dikush tjetër me investua edhe nuk besoj që na pengon ministria dhe kudo që ka këso raste ne zyrtarisht si komunë nuk kemi të drejtë me ndërhyje sepse e kemi të ndaluar me intervenua në rrugë rajonale por nëse ka donator që investojnë nuk besoj që ka me pasur pengesa. Pastaj Rasim Fazliu ka pyetur për problemet me KEDS-in, siç e dini ne kemi pasur vështirësi dhe vazhdojmë me pas vështirësi në furnizim me energji elektrike dhe po ashtu ndonjëherë qytetaret kanë si adresë komunën por unë si kryetar dhe bashkë me drejtorin e Shërbimeve Publike jo vetëm këta të KEDS-it përgjegjësit këtu e pastaj përgjegjësit rajonal por si komunë kemi ndërhyje edhe deri tek autoriteti qendror i KEDS-it. Ata i kanë disa arsyetime të veta pse ndodh kjo te furnizimi me rryme për shkak se është ngarkuar me pajisje te reja shtëpitë e banimit edhe pa pëlqime energjetike, pra ky është arsyetimi dhe versioni i tyre zyrtar. Por tash ka avari dhe defekte që bile defektet në amvisëri familjare janë evidente edhe unë mendoj që ata që kanë marr pëlqime energjetike edhe ju kanë dëmtuar pajisjet e kanë të drejtën individuale me paditë KEDS-in dhe unë jam për këtë mirëpo një pjesë nuk kanë të drejtë sepse nuk kanë pasur një komunikim apo një raport të qartë të definuar me KEDS-in dhe kanë bërë veprime që nuk kanë marr pëlqimin ose janë pa dijeninë e KEDS-it edhe e kanë ngarkua sistemin edhe tash na kanë shkaktuar telashe në investime publike edhe neve si komunë jo në objektin e komunës por na ka shkaktuar probleme ne ndriçim publik ku na ka dëmtuar pajisje të ndriçimit publik ku në këtë pikë kemi biseduar shumë seriozisht për këtë çështje, bile sot me ka ardh edhe një shkresë prej tyre e ju kemi drejtuar edhe me shkrim e po ashtu kemi pasur edhe takime fizike e ndonjëherë edhe probleme në komunikim, bile për këso raste jam ne gjendje me protesta me shkue para zyrave të KEDS-it në Prishtinë mirëpo këta ne Rahovec nuk kanë asnjë mundësi tjetër dhe fajet për ketë. Këta edhe natën mundeni me i pa ekipet e këtyre punëtorëve neper shtylla elektrike, këta po e bëjnë punën e tyre por problemi është në qendër. Unë personalisht nuk ja kisha lejua një shtrirje të tillë të kabllove edhe me kutia nëpër shtylla elektrike nëpër gjithë Kosovën pasi siç e dimë që ka modalitete tjera për shtrirjen e rrjetit elektrik. Sipas shkresës që kam pranuar sot, pra menaxhmenti i lartë i KEDS-it ata sot me janë zotuar mua se kemi një planë operativ për datën 28,29,30,31 dhjetor se qysh ata kanë me u kujdes që me pas sa me mirë furnizim me energji elektrike. Kjo shkresa ka ardhur nga menaxhmenti i KEDS-it pasi ne e kemi bërë problem këtë punë dhe nuk e di se nuk oshtë bërë problem ne parlamentin e Kosovës edhe pse jemi ne këto zhvillime që jemi por është deshtë edhe atje edhe ne qeveri por ne si komunë e kemi bërë problem. Pastaj te pyetja e drejtuar nga Fehmi Hoxha, parkingu tek pjesa e qendrës e dini të gjithë se çfarë është dhe mirë që kanë ardhë bashkatdhetarët dhe për shkak te qarkullimit të shumte dhe ardhjes se bashkatdhetarëve pasi edhe mbledhja e kuvendit po mbahet këtu dhe kjo ka ndikua për këtë tollovi. Pastaj zona ekonomike komerciale 103 hektar që është vendim i kuvendit dhe do të kujdesem që me pae se qysh është ky vendim i kuvendit pasi nuk jam ne dijeni por e di që në bazë të një konsulte që e bëra me drejtorin e urbanizmit ku sipas Planit Zhvillimor Komunal është zonë bujqësore ajo stalla apo ferma e deleve ku është e ndërtuar. Tash a ju ka përshtat vërtetimit urbanistik të drejtorisë se urbanizmit edhe pastaj ka bërë shmangie nga lokacioni por ajo është zonë bujqësore me PZHK. Unë i besoj z. Fehmi Hoxha në shqetësimin që e ngriti por duke i besuar edhe drejtorit të urbanizmit prandaj do të interesohem personalisht për më shumë rreth kësaj situate, që ndoshta përgjigjen ne seancën e radhës kemi me pas më të saktë edhe në vendimin e Kuvendit të Komunës por edhe sa i takon vërtetimit urbanistik se çka në fakt ka ndodhur. Dhe nëse është vërtet ajo që the ti atëherë qysh e kemi të drejtën me lëshuar vërtetim urbanistik e kemi edhe te drejtën edhe me revokua vërtetimin urbanistik nëse ka ndonjë situatë që shkakton pasoja të caktuara ose kundër planifikimit që bënë komuna e Rahovecit. Prandaj nuk po dua me u lëshua sot pasi po dua me u konservua për seancën e radhës dhe besoj që keni me pas një përgjigje të saktë nga unë apo

prej drejtorit të urbanizmit. Sa i takon subvencionimit të bizneseve, unë i kam pritur përfaqësuesit e bizneseve ne momentin kur ka filluar kanali i ujërave atmosferik dhe po ashtu i kam autorizua me bo një kërkesë dhe kam vendos me i subvencionua, por a do të subvencionohen përmes komunës apo përmes një thirrje dedikohet vetëm për bizneset ne rrugën Xhelal Hajda-Toni e që i atakon puna që bëhet dhe ju ka vështirësua punën kanali i ujërave atmosferik dhe puna që po bëhet aty, kështu që kjo punë është kryer mirëpo tani do të bisedojmë vetëm për modalitetet me siguri vitin e ardhshëm dhe a do të lëshohet një thirrje vetëm për ata që realisht është e ligjshme apo do të kërkojmë ndihmën e kuvendit. Kështu që ata do të subvencionohen dhe e din saktë se kryetari i komunës dhe drejtori i ekonomisë ne bashkëpunim me gjithë ekipin e kemi miratua edhe ka zotim të qartë edhe e din që ne do ti subvencionojmë.

**Sali Sallteku –** Unë kërkova një përgjigje nga drejtori i arsimit pasi drejtori i shkollës bashkë me qytetarin ka kërkuar që pronës që ja ka marr fshatit tani ka kërkuar edhe rruga te i krijohet asaj prone dhe unë kërkova nga drejtori i arsimit që ta njofton se si ka qenë puna. Po ashtu kisha kërkuar nga ju kryetar që ju me drejtorin e kadastrës të vendosen pikat dhe te mos lejojmë që të marr pronën e fshatit.

**Fehmi Hoxha –** Faleminderit shumë për përgjigjen por do të kthehem përsëri ne pyetjen e parë që e pata për zhvillimin e zonës. Vendimi i Kuvendit komunal është ashtu siç po ju them unë dhe ju mund ta shikoni dhe po ashtu është shume e vërtetë që me planin zhvillimor komunal aktual ajo zonë është e dedikuar për bujqësi. Mirëpo kur te merret një vendim tjetër nga ana e kuvendit komunal, atëherë kuvendi komunal është i autorizuar dhe i vetmi organ për përcaktimin e hapësirave publike të pronës komunale ne përgjithësi. E ka marr një vendim me te vetmin qellim siç e thash edhe me herët që të mos degradohet ajo bukuri që ka filluar me u ndërtua që të mos degradohet edhe me ja pamundësua Agjencionit Pyjor të Kosovës për me i dhanë në shfrytëzim. Në baze të ligjit për vetëqeverisje lokale neni 12 që nuk ju përmenda këtë me herët, kryetari i komunës së bashku me ekzekutivin është i obliguar me zbatua vendimin e kuvendit komunal, përndryshe është vepër penale. Unë ju lusë që urgjentisht të bëni një kërkesë dhe të tërhiqeni atë pëlqim sepse është vepër penale. Nëse ju kujtohet ne seancën e radhës kur ju kam lutur që ju thosha se nuk po dëshiroj me ju lejua me gabua e që tash na vjen prej MAPL-së që u rikthye një vendim. Ne jemi opozitë e qeverisjes aktuale mirëpo jemi pozitë e komunës dhe do ishte mirë që me ndëgjua njeri tjetrin që mos me bo këso gabime pasi është vepër penale.

**Refki Kryeziu –** Faleminderit kryesues, unë harrova për pjesën kryesore që u deshtë ta them që veç ma kujtoj kryetari, që është fakt unë kam munguar për disa mbledhje që kam pasur probleme shëndetësore dhe kam qenë për trajtim jashtë vendit dhe të gjitha i kam argumentua si dëshmi ndaj organeve kompetente gjë që i falënderoj shumë që e kanë kuptuar gjendjen time shëndetësore.

**Kryetari –** Natyrisht që jeni në dijeni Fehmi Hoxha se ka edhe organe tjera që e vlerësojnë këtë pozicion dhe nuk kemi dëshirë me na i kthye vendimet kurkush, që ka ndodh një gabim tek ridestinimi i tokës dhe kur të vijmë aty po besoj që e sqarojmë, pavarësisht paralajmërimeve se ne kemi të drejtë secili me paralajmërua vetveten edhe ne jemi kuvend i komunës dhe shpesh herë edhe na kthehen vendimet për shkak se janë disa organe tjera që e shqyrtojnë ligjshmërinë. Por sidoqoftë nuk jemi askush të interesuar të bëjmë vepër penale por me herët u zotova se do të interesohem për këtë punë. Unë po dua të i besoj Fehmi Hoxhes, por dua me i besua kuvendit të komunës gjithsesi por dua me i besua edhe drejtorit të urbanizmit edhe do të shohim për me tutje edhe me hulumtua me materiale edhe me pa se cila është PZHK e vjetër e çka është PZHK e re, prandaj dua të rezervohem sot për me pa në muajin janar saktë se si qëndron situata.

**Avni Morina –** Përshëndetje kryesues, kryetar dhe gjithë ju të pranishëm. Është e vërtetë që qytetari ne fjalë ka qenë në DKA por kjo punë ka me shume se 3 muaj dhe ka pasur vetëm një bisedë formale bashke me drejtorin e shkollës mirëpo kërkesë zyrtare nuk kam pranuar nga ai dhe nuk e di se a ka bo ndonjë kërkesë te drejtoria e gjeodezisë dhe kadastrës por me sa me kujtohet biseda ka qenë për çështjen e një rrugës që e

kërkonte e cila faktikisht përmes pronës se oborrit të shkollës. Ne kemi pasur vetëm një bisedë formale dhe nuk është paraqitur asnjëherë dhe as kërkesë zyrtare të protokolluar nuk ka bërë dhe nuk e di se a ka bërë ndonjë kërkesë te drejtoria e gjeodezisë dhe kadastrës dhe a ka pasur ndonjë zhvillim në terrene apo ka ndërhyje diçka në oborrin e shkollës nuk e di por nuk ka asnjë lloj pëlqimi prej DKA-së por vetëm bisedë formale bashkë me drejtorin e shkollës.

**Fehmi Cena –** Në lidhje me pyetjen që bëra, kryetari i dha shpjegimet dhe po me vjen mirë edhe mua që qenka shpenzuar buxheti dhe ju e thatë që për vitin e ardhshëm do të angazhohu që me pas parasysh këtë çështje dhe unë kisha me thënë që mos e lini ne harresë që se paku duhet të ju dilet në ndihmë një pjesë e qytetareve që i kanë kushtet me te vështira nëse jo të gjithëve. Një ndërlidhje të shkurt kisha me bo edhe për çështjen që e ngriti Fehmi Hoxha se pa hyje ne detaje, a i dha karakter atyre serave dhe degradim të asaj pjese dhe unë kisha me shtuar edhe pamje të keqe por është edhe ajo si rrezikim i sigurisë se qytetareve. Ajo rrugë transit është bërë atraksion për qytetaret pasi çdo ditë e frekuentojnë atë pjesë mirëpo tash nuk munden se prej atyre stallave dalin qentë edhe me te vërtet rrezikohet edhe jeta e qytetarëve dhe e kam cekur edhe me përpara kur kemi folur për këtë rrugë se do të ishte mirë të ndërtohet edhe një trotuar për qytetaret pasi e kemi qenë ne dijeni se ka me pasur këtë rolë kështu që edhe unë mendoj që serrat apo stallat nuk e kanë vendin aty pasi është degradim por edhe rrezikim i sigurisë së qytetarëve që duhet ta keni parasysh këtë.

**Kryetari –** E përsëris edhe njëherë se ne do ta vërtetojmë atë ja thash Fehmi Hoxhës e po ju them edhe juve, por ne duhet gjet zgjidhje dhe nuk po flas për rastin konkret dhe ju e dini që ka shume stalla ne komunën e Rahovecit e po ashtu disa stalla që kanë qenë te Stone Castle dhe ka shumë të tilla që janë brenda në vendbanim edhe vazhdimisht po kemi ankesa edhe probleme rreth kësaj çështje. Kështu që unë nuk po them se ai vend është i përshtatshëm për stalla mirëpo ne duhet me mendua edhe për ata që e shohin se është me interes me u marr me blegtori dhe ka një numër i madh i stallave me bagëti të imëta të mesme dhe të trasha ka në komunën tonë, kështu që edhe për ata që nuk kanë vend se ku ta zhvillojnë veprimtarin e tyre duhet me ju bo zgjidhje dhe ndoshta edhe duhet me i largua edhe pjesa ku ekzistojnë shtëpi banimi dhe duhet me ju gjet ndonjë vend tjetër aty ku ka mundësi në ndonjë vend të përshtatshëm por duhet me bo diçka edhe për ata që skanë zgjidhje.

**Kryesuesi –** Faleminderit kryetar për sqarimet, atëherë kalojmë pikën e tretë të rendit të ditës:

3. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen „Qytetar Nderi „ Gjeneralin Ton van Loon.**

**Kryesuesi –** Të nderuar kolegë kuvendarë, ne e kemi trajtuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa për shpalljen qytetar nderi të gjeneralit holandez i cili ka shërbyer në vendin tonë gjatë viteve 99. A ka dikush diçka rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e qesim ne votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për miratimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2021.**

**Kryetari -** Besoj që sipas planit të punës, ne i kemi zhvilluar të gjitha aktivitetet e KKSB-së, kemi zhvilluar procedura ligjore edhe për komente propozime e ide kështu që materialin e keni përpara dhe ju ftojë që ta miratoni.

**Kryesuesi –** Faleminderit kryetar, atëherë e qesim ne votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimit të varrimit për vitin 2021.**

**Samir Mustafa** – Duke u bazuar ne nenin 11/13 të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe statutit të komunës, Kryetari i komunës i propozon kuvendit të komunës se Rahovecit miratimin e vendimit me te cilin i lejohet kryetarit të Komunës që ne interes të qytetareve ne emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të lidhë

marrëveshje me te gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës se Rahovecit. Pakoja e shërbimeve primare do të definohet me një marrëveshje te re e cila nuk do të ketë koston me te lartë se 200 euro për një rast ndërsa për shërbime tjera që nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetaret do të i sigurojnë ato personalisht. Ftojë që ta miratoni propozimin e kryetarit.
**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, atëherë e qesim në votim pikën e pestë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. **Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve, lagjeve urbane rreth emërtimeve të reja.**

**Besa Bytyqi –** I nderuar Kryesues i Kuvendit, kryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblistë dhe gjithë ju të pranishëm. Ne si komision për emërtimin e rrugëve, shesheve, parqeve publike ne komunën e Rahovecit kemi mbajtur takime ne secilën lagje të qytetit dhe ne secilin vendbanim të komunës se Rahovecit ku jemi takuar me kryesin e këshillave lokal për të diskutuar për emërtimin e rrugëve te reja shesheve ose ndonjë hapësirë tjetër publike. Siç edhe keni mundur me pa ne material kemi filluar diku me datën 14 tetor me takime deri me datën 21, ku ka pasur disa kërkesa dhe jo aq sa kemi pritur por me shume ka pasur kërkesa për emërtimin e rrugëve ekzistuese do të thotë që i ka takuar një komisioni krejt tjetër. Përpara juve keni 34 kërkesa dhe secila prej tyre ka përmbajtur nënshkrimin e banoreve të lagjes, një biografi të shkurtër për personin dhe arsyen se pse ata dëshirojnë të i vendoset emri asaj rruge apo atij vendi. Unë ju ftoj që ta diskutojmë e më pas edhe ta votojmë.
**Kryesuesi** – Faleminderit shume znj.Bytyqi, komisioni vërtetë ka kryer punën dhe është marrë mjaft shumë rreth kësaj dhe janë takuar disa herë dhe normal që janë edhe kërkesa tjera të vendbanimeve por mendoj që tash në ditët ne vijim do të kryhen edhe do të trajtohen edhe kërkesa tjera të banorëve tjerë.
**Munib Durguti** – Në fillim e hapa diskutimin kur e kishim ne propozim rendin e ditës dhe propozova që jo rastësisht që kjo pikë të ndahet ne dy pika, pra pika e parë aprovimi i listës rezervë gjithmonë duke u bazuar ne ligjin për emërtime dhe udhëzimet administrative ngase kemi katër udhëzime administrative që e rregullojnë këtë fushë apo këtë lëmi mjaftë komplekse. Seancën e kaluar e kemi bërë një debat apo bisedë për procedurën se si duhet të ecim tutje, ndoshta kemi gabuar të gjithë se bashku por tash po e shoh edhe vet që kemi gabuar kur kam menduar që nuk është obligative lista rezervë dhe tash po del se lista rezervë oshtë obligative dhe secili ndryshim propozim i ri apo emërtim i ri duhet te merret nga lista rezervë. Listën rezerve kuvendi paraprak e ka aprovua mirëpo ajo e ka një validitet prej 5 vite d.m.th. ajo liste nuk është valide, kështu që kuvendi duhet të hije në miratim te ri dhe te aprovoj listën, që po konsideroj që lista paraprake ka qenë rezultat i debateve dhe dëgjimeve publike nëpër lagje dhe po ashtu emrat e propozuar të inkorporohen ne listë dhe të marrin nje vendim për plotësimin e listës dhe pastaj të shkojmë tutje. Si argument ju kisha lexuar disa nene, që është neni 6 i udhëzimit administrativ 017/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtimin e listës rezervë dhe vendosjen e tyre ne regjistrin komunal të adresave. Pastaj pika 1.1.15 thotë emrat e zonave të qarkullimit publik mbeten ne listën rezervë për një periudhë 5 vjeçare d.m.th. ato që i përmenda se afati ka kaluar. Emërtimi i ri ose riemërtimi merret nga lista rezervë pika 1.1.16. Tash nëse ne marrim vendim ashtu siç propozoj kryetarja e komisionit për emërtim atëherë unë jam shume i bindur se ky emërtim do të kthehet nga MAPL-ja dhe ne prape si kuvend duhet të mblidhemi ti ndajmë këto dy pika dhe fillimisht të aprovojmë listën rezervë e pastaj të kalojmë në vendimmarrje për emërtime te reja. Për ndryshe unë jam anëtar i komisionit për ankesa dhe ne kemi një liste që kemi formuar nga shqyrtimet e lendeve, do të paraqesim ndryshimet ne seancën tjetër, i kemi disa emra të propozuar për listën rezerve dhe unë i kisha dhënë kryesuesit të gjithë emrat e kanë biografinë dhe besoj që i plotësojnë të gjitha kushtet në bazë të udhëzimeve edhe ligjit, të kalojnë emrat e propozuar që i dha me herët kolegia, të aprovojmë listën rezervë e pastaj kalojmë në vendim marrje për emërtime.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, në këtë pike te rendit të ditës e kemi pasur edhe ne Komitetin për Politike dhe Financa  mirëpo aty kurrkush nuk ka prezantuar që me na dhanë disa sqarime që kishim nevojë me i sqarua. Tash për këto dy prezantime që u bënë nga Besa Bytyqi dhe Munib Durguti rreth listës rezervë. Por unë nuk jam në dijeni që kemi pasur këtu material dhe tash materialin që e kemi ne nuk është listë rezervë dhe unë besoj që janë propozimet konkrete te emrat e rrugëve shesheve dhe te institucioneve. Unë dua të bëj një ndërhyrje për sqarim tek faqja e parafundit emri Xhemail Hajrullaaga në Rahovec ku ceket se ka qenë propozim për rrugë por nuk ceket se cila rrugë d.m.th. kjo mbetet edhe për të ardhmen se a është pjesë e kësaj liste apo ne listën rezervë pasi nuk është punë e kryer plotësisht. Në faqen e fundit thotë që komisioni për emërtime te reja të rrugëve shesheve parqeve dhe objekteve komunale ka dalë edhe me disa propozime konkrete dhe emërtimet e rrugëve. Propozimet janë si në vijim, rruga transit mbi Rahovec të emërtohet Toka e Rrushit dhe rruga Fortesë-Hamos të emërtohet Vreshtari. Kështu që tash po më intereson se kush ka dhënë këto propozime dhe si kanë ardh këto emra, për arsye se kam pak vërejtje për këto dy emra, pasi unë mendoj që emërtimi qoftë i rrugës i sheshit apo një institucioni duhet ta ketë kuptimin e vet të plotë pra emri duhet të ketë një kuptim dhe domethënie për atë emër p.sh. nëse themi toka e rrushit dhe bëhet fjalë për rrugën transit mbi Rahovec, pasi realisht populli ja ka dhënë një emër dhe këndo me pyet ne Rahovec  se ku është rruga e transitit, atëherë menjëherë bëhet fjalë për rrugën mbi Rahovec dhe pas një kohë me pyet se ku është toka e rrushit atëherë me hamendje kanë me shikua ka vreshtat dhe nuk do të shikojnë ka malet ku atje nuk ka rrush. Pra çdo emërtim duhet ta ketë kuptimin  dhe mendoj se nuk di sa është diskutuar seriozisht kjo dhe unë kam dilema për këtë rruge pasi është rrugë mal bjeshkë gur por rrush nuk mund të quhet. Por unë kisha propozua që kjo me mbete kështu pasi është transit dhe po e emërtojmë transit apo e lëmi për një herë tjetër për me vonë. Edhe rruga Fortesë – Hamoc që është propozuar vreshtari, pasi çdo qytetar me pyet se ku gjendet rruga e Hamocit, menjëherë kanë me u përgjigj se gjendet ne Hamoc, pastaj rruga e Dublanës në Dublanë pra duhet ta ketë kuptimin e vet sepse kjo vreshtari siç e dimë është krejt Rahoveci me vreshtari. Gjithashtu edhe këtu propozoj që të mbetet pa emërtuar ose le te quhet rruga e Hamocit, pasi e ka atë kuptim. Po ashtu kam një pyetje për komisionin se a ka pasur emra të tjerë të propozuar të cilët nuk janë të përfshirë ne këtë listë dhe ne nuk po i shohim këtu dhe pyetja e dytë është se a kemi të drejtë ne si delegatë me propozua emra edhe ne mbledhje te kuvendit për listën rezervë që u cekë tash prej anëtarit të komisionit Munib Durgutit.
**Masar Popaj** – Përshëndetje për te gjithë. Edhe unë te lista e emrave te rinjë të propozuar për emërtimin e rrugëve te reja shesheve parqeve dhe objekteve komunale. Po e shoh se janë 30 propozime nga fshatrat dhe lagjet e Rahovecit dhe kanë marr vendim që me u sjelle ne kuvend për tu votuar. Te propozimet si ne vijim, po lidhem me kolegun tim rruga transit mbi Rahovec të emërtohet toka e rrushit, rruga te maja e shkodranit të emërtohet dëshmoret e korrikut, rruga Fortes Hamoc te emërtohet Vreshtari pastaj shtegu për te maja e shkodranit të emërtohet shtegu i lirisë. Këto propozime a janë ardhë prej komisionit dhe a ka drejt komisioni me i dhanë këto propozime e kam fjalën për këto katër propozime që janë ardh dhe sa kanë drejt komisioni me i dhanë këto propozime dhe me kënd janë konsultuar që me i dhanë këto propozime, pra vetëm kërkoj si sqarim.
**Sali Sallteku** – Siç po e shihni se jemi duke mbajtur mbledhjen në kushte jo të përshtatshme dhe salla është paksa e ftohtë, ju kisha lutur që ta keni në konsideratë që kryejmë me shpejtë sepse vërtet është ftohtë.
**Ali Zhuniqi** – Përshëndetje kryesues, kolegë asamblistë dhe gjithë te pranishëm. Në lidhje me listën që është propozuar nga ana e komisionit, unë kam një çështje e qe sigurisht se këta kanë mbajte mbledhje me kryesin që është e zgjedhur aty ne fshat dhe kanë marr mendimet për secilën rrugë dhe në çdo fshatë dhe qytet. Më intereson  për fshatin Fortesë e pash që hapësira përball xhamisë të quhet sheshi i flamurit  dhe kisha kërkuar nga komisioni që me na dhanë sqarim se a ka pasur me shume se dy apo tre emra, për arsye se  nëse hiqet ai flamur nesër dhe ajo zonë mbetet e thatë. Kështu që unë kisha propozuar që për fshatin Fortesë pasi që njihemi

edhe mediat ndërkombëtare është prezantuar si lumi i përgjakur dhe nuk do të ishte mirë me dal prej këtyre vlerave sa i përket emërtimit e sidomos te shesheve. Fshati Fortesë njihet për dy emërtime sa i përket vlerave kombëtare që ka dhënë secilido fshat, si emrat ne sheshe dhe lumi i përgjakur. Kisha kërkuar që nuk është mirë me dal prej jashtë këtyre pasi te paktën hapësira publike me këto emërtime me na identifikua kushdo qoftë që na viziton dhe ne momentin kur te sheh një emërtim do të interesohet edhe për historikun te atij fshati lokaliteti qyteti. Pra edhe njëherë kisha kërkuar prej anëtareve të komisionit me na tregua se kur është mbajtur mbledhja ne Fortesë dhe a ka pasur me shume se dy propozime lidhur me sheshin e Flamurit.
**Dervish Çadraku** – Përshëndetje për ju kryesues dhe gjithë të pranishmit në sallë. Kur është fjala te lista rezervë nuk e kam të qarte se nga kush formohet lista rezervë dhe çfarë roli ka ajo listë. Pastaj rrugët kanë disa role, ne radhë te pare te orientojnë njerëzit që me lehtë te komunikojnë dhe të gjejnë vendbanimet e tyre apo adresat e caktuara. Dhe e dyta përmes këtyre emrave, i respektojnë i nderojnë dhe i falënderojnë figurat e ndryshme që kanë bërë në faza te ndryshme te historisë se popullit shqiptar dhe po atë ditë kam pasur një vërejtje që disa emra që janë këtu të shënuar nuk kanë biografi se cili është arsyetimi që e meritojnë për ta vendos atë emër sepse e di se ne disa vende i kanë larguar ata emra ne tabela edhe madje edhe te ushtrisë çlirimtare te Kosovës. Pastaj e dyta që po me intereson këto figura që i kemi shënuar këtu, ka disa prej tyre që përfaqësojnë lagje si p.sh. lagja e Morinëve apo lagja e Thaqëve që d.m.th. se jemi larguar pak nga qëllimi i parë dhe me i rëndësishëm i këtyre shënimeve d.m.th. që te mos dalim ne pjesën personale apo grupore që do ta dëmtonte tjetrin si p.sh. këtu si shihet qe edhe e keni ne material, pasi mua nuk po me pëlqen te vendosen emrat e lagjeve sepse aty mund te kemi një familje që është i lagjes tjetër dhe pastaj ajo familje ndjehet i dëmtuar. Prandaj është mirë që te kemi kujdes që herëve tjera që figurat ose emrat që i vendosim aty të jenë në mënyrë të përgjithësuar për te gjithë njësoj dhe jo te marrim emrat që në njëfarë mënyre i diskriminon te tjerët.
**Kryesuesi** – Faleminderit z. Çadraku, para se me ja dhanë fjalën znj. Bytyqi, pjesë e kësaj rrugë ka qenë edhe një rruge ne Ratkoc që të emërohet rruga e livadheve.
**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, unë nuk e diskutova fare listën pasi mendova që do të kaloj në propozim për me i ndaje këto dy pika mirëpo përndryshe përderisa te gjithë e diskutuan edhe unë dua të jap kontributin tim dhe unë e përgëzoj komisionin për punën që kanë bërë ne terrene dhe për standardin që kanë aplikua dhe besoj që janë bazua në dispozitën e nenit 6 të pikës 1.1.6 të udhëzimit që e kam cekur, ku thotë që emrat e propozuar me shume se 50% i banoreve që kanë adresën e tyre në këtë rruge të jenë të pranuara për kuvendin d.m.th. propozimi për lagje kurse për rrugica duhet me ardh gjithmonë komunitetit e jo prej komisionit pasi komisioni e ka mandatin e kuvendit dhe përfaqëson kuvendin dhe propozon për sheshe publike rruge publike ku asnjë qytetar nuk mundet te thotë se jam hisetarë aty dhe unë vendosi aty d.m.th. për rrugë me karakter të përgjithshëm. Për ndryshe e ngrisë shqetësimin pasi si banor i lagjes përball gjimnazit që jemi aty ka kohë qe kemi bërë një peticion dhe kemi kërkuar prej komisionit atëherë ne vitin 2017 që ta merr përsipër emërimin e rrugës se re e cila nuk është e emërtuar që lidh rrugën Gëzim Hamza dhe Ibrahim Rugova që është segment i shkurtë i rrugës me emrin e ish asamblistit dhe ish ish drejtorit të Kulturës Idriz Vuçiterna. Ne ja kemi bashkëngjit edhe biografinë dhe ai emër e ka miratimin e mbi 95% të banoreve te lagjes, që janë vetëm dy familje që kanë dal me një propozim tjetër pasi për emrin që kanë propozua është edhe një biografi tjetër mirëpo nuk e ka pasur miratimin e banoreve te lagjes ngase ai propozim ka ardhur pak me vonë pasi ne tash banor aty e kemi ndaje mendjen njëherë mirëpo atë emër nuk po e shoh në rrugë dhe ajo rrugë ende mbetet pa emërtuar. Unë po kërkoj një arsyetim pse po ndodh kjo, ngase derisa jeni bazua për te gjitha këto emërtime në standardin e propozimit të banoreve atëherë pse nuk po bazoheni edhe këtu edhe te marrim një vendim. Unë kam një respekt shume te madhe për emrin e propozuar prej banoreve tjerë aty që nuk e ka pëlqimin e banoreve te lagjes që bëhet fjalë për Destan Kërqakun që ka rënë dëshmor në kohën e luftës se dytë botërore dhe e ka biografinë e vet mirëpo për këtë emër nuk ka pasur miratimin e banoreve të lagjes pasi

banoret kanë dal me një emër tjetër dhe besoj që edhe ai emër i plotëson kushtet e parapamë në ligjin për emërtime saktësisht ne nenin 1 pika 2. Andaj të kalojmë dhe ta emërtojmë edhe këtë rrugë edhe paraprakisht të që propozova të marrim një vendim për krijimin e listës rezervë dhe te kalojmë në vendimmarrje por kërkoj prej kuvendareve dhe prej kryesueses se komisionit që edhe këtë emër ta inkorporoj ne emërtimin e rrugës se paemërtuar.
**Besë Bytyqi** – Unë kam disa sqarime shtesë lidhur me pyetjet që u bënë këtu, po filloj me z. Fehmi Cena, a ka pasur emra tjerë të propozuar që faktikisht pyetje e ngjashme edhe me Ali Zhuniqin. Ne si komision i kemi verifikuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur tek komisioni jonë . Dhe nuk jemi organ kompetent për të hedhur poshtë një kërkesë të bazuar. Këtu i kemi sjellë vetëm kërkesat e bazuara në kriteret e vendosur nga ligji e jo nga ne, që do të thotë një biografi e emrit të propozuar dhe patjetër nënshkrimet e banoreve. Kështu që nuk ka pasur emra tjerë sidomos me rrugën e Hamocit që po besoj që ju keni referuar asaj rruge z. Fehmi, dhe a kemi te drejtë me propozua ne si delegatë. Këtë përgjigje me shume mund ta jap dikush tjetër pasi unë si delegat këtu ne kuvend nuk e di. Gjithashtu për propozimet që i kemi dhënë si komision, që ishte te toka e rrushit ne pjesën mbi qytetin e Rahovecit te rruga e transitit, arsyeja e propozimit të këtij emri ka qenë sepse në një mënyrë përrallore mund te shihet rrushi dhe tokat e rrushit nga ajo pjesë. Ndërsa rruga Fortesë-Hamoc, rruga vreshtari kemi propozuar sepse me një vend me një vreshtari shume te mirë nuk ka asnjë rrugë ku përmendet vreshtari kështu që ne si komision kemi menduar që edhe vreshtarët si punëtor të vyeshëm dhe si bujk faktikisht të vlerësojmë me këtë gjë. Pastaj pyetja e parashtruar nga Masar Popaj, se a kanë drejtë komisioni për propozime, une mendoj se komisioni ka të drejtë për propozime. Pastaj pyetja nga Ali Zhuniqi, sheshi i Flamurit dhe a ka pasur me shume emra. Nuk ka pasur me shume emra pasi ka qenë i vetmi emër i propozuar dhe ne i kemi mbajtur takimin me këshillin e fshatit Fortesë dhe i pranishëm ka qenë edhe Masar Popaj pasi ka qenë[ ftesë vetëm për këshillin e fshatit dhe ne i kemi marr kërkesat nga ana e tyre dhe ende po marrim kërkesa nga fshatrat tjerë të cilët nuk i kanë sjellë. Pastaj pyetja nga z. Çadraku se pse nuk kanë biografi emrat e propozuar. Ne si komision jemi munduar në material që ta shkurtojmë pak a shume biografinë e personave dhe te shkojmë vetëm me thelbin se pse është propozuar ai emër dhe pse ka ardh deri ne kuvend, përndryshe listat janë të hapura dhe mundemi me ju sjellë të gjithëve me i lexua se bashku se qysh i kanë propozua këshillat e fshatrave. Pastaj pyetja e drejtuar nga Munib Durguti, rruga për te cilën kemi problem ka kohë pasi nuk janë vetëm dy emrat e propozuar siç e thoni ju sepse janë me shume se dy emra dhe personat që dëshirojnë me vendos emrin e familjarit e tyre, ne si komision nuk e kemi sjellur ne këtë seancë dhe presim ta sjellim ne seancën e radhës sepse kemi dashur ta verifikojmë shume mirë çështjen dhe nuk kemi deshtë që te kemi me asnjërën prej familjeve që kanë propozuar emrat por edhe si komision të mos vendosim si emër që disa persona janë pro e disa të tjerë janë kundër. Ditëve ne vijim do të dalim ne teren me pae për se afërmi se çka po ndodh dhe si është gjendja që të kemi mundësi me marr një vendim definitiv.
**Fehmi Hoxha** – Unë e kam një pyetje para se me vazhdua me diskutua për administratën e kryesuesit. A mundeni me na tregua datën e vendimit që është marrë në kuvend komunal për emërtimin e rrugëve dhe për listën rezervë. Po pyes për këtë pasi me parë e konsultuam udhëzimin administrativ dhe nëse ka kaluar 5vite nëse ka kaluar një ditë atëherë ne mund ta diskutojmë këtu dhe nëse ska kaluar 5 vite lista aktuale rezervë është që vetëm me atë listë mund te plotësohet vetëm te emërtimet e reja të rrugëve dhe jo të zëvendësohen pra hapja e rrugëve te reja me atë listë plotësohet dhe nëse ka kaluar atëherë e para që duhet me bo ky kuvend është me miratua listën rezervë dhe me pas të emërtojë rrugët të pa emërtime. A ka mundësi me na tregua datën se cila është dhe nëse ka kaluar 5 vite atëherë ky organ duhet me miratua listën rezerve dhe me plotësimet në bazë të komisionit që kanë dalë dhe me pastaj mund të procedojmë me tutje.
**Rukije Krasniqi** - Faleminderit kryesues, e përshëndes edhe kryesuesen e komisionit për emërtimin e rrugëve shesheve dhe lagjeve. E nderuara Besë, nuk e di sa ju keni përmbajt kritereve dhe udhëzimeve

administrative rreth emërtimeve sepse mjaft skandaloze po vinë kërkesat dhe emërtimet nga e kaluara dhe kur tha që nuk ka nevojë për biografi. Unë mendoj se biografia është pika e parë që kërkohet në lista për emërimin e rrugëve, pasi po vinë persona me te vërtet me një biografi jo e përshtatshme p.sh. i ka vdekë djali 9-vjeqar si pasoj e aksidentit me makinë dhe kërkon që të emërtohet rruga me emrin e tij. Kështu që aty janë kriteret që nuk lejojnë me gabua dhe urojë që nuk keni gabuar si ne mandatin e kaluar dhe të ju keni përmbajt kritereve dhe udhëzimeve administrative ligjeve pastaj nenet i keni të specifikuara dhe unë me sa dëgjova urojë që të jetë ne rregull çdo gjë.

**Ali Zhuniqi** – Besë, sigurisht se e vlerësoj punën e komisionit për te cilat ka edhe vështirësitë e veta të përzgjidhen emrat pasi nuk është e lehtë dhe ju kuptoj plotësisht. Por r secili i dha sugjerimet e veta ne lidhje me këto problematika por e potencuat tek biografia dhe pikërisht emërtimet e shesheve duhet me pas një biografi dhe një historik ne vete edhe kjo është kushti kryesor që nevojitet për emërtim. Ju e përmendët edhe Masari dhe un nuk e di se edhe Masari është anëtar i këshillit dhe i kryesisë në fshatë. Dhe kjo len me nënkuptua që aty ka mundur me pas ndikime por prapë se prapë dhe sido që të jetë unë mendoj se në fshatin Fortesë po flas se janë dy emra që për mendimin tim i kishin shkuar edhe fshatit Fortesë dhe gjithë banoreve aty., pasi emrat ne shishe për banoret e Fortesës e din historikun shume mirë dhe lumi i përgjakur ku ne te gjitha mediat botërore si BBC, Washington Post dhe plot media tjera kanë shkruar për ,,Blood River,, për fshatin Fortesë i kishin ngjasue sa i përket historikut, kështu që prapë se prapë nëse vendosni si listë që na me votua, ne nuk jemi kundër por te paktën prej historikut nuk mundemi me dalë. Unë po flas për fshatin Fortesë ndërsa për fshatrat tjera nuk dua të ju nënqmoj për punën që keni bërë dhe e vlerësoj punën që keni bo ne teren dhe me krejt këshillat e bashkësisë lokale që keni pasur por do të ishte mirë që mos me dal prej historikut.

**Kryetari** – Besoj që jemi dakord rreth kësaj pasi është situatë ashtu siç edhe përshkruajti Alia dhe gjithë të tjerët, pra është pak e ndjeshme kjo punë dhe nuk duhet me harrua edhe anët subjektive që mbizotërojnë tek njerëzit, vështirësi ka me pak ne qytet për shkak se konsiderohet se është kryer me herët pasi ka nis procesi i emërtimeve qysh pas luftës dhe kanë ardhë duke u minimizua problemet kështu që ndjeshmëria ka ardhë duke rënë kurse nëpër fshatra emërtimet janë bërë më vonë edhe ka pasur vështirësi dhe jemi dëshmitarë të gjithë pasi vështir është me gjete në këtë kuvend të komunës ndonjë që është i kënaqur jo vetëm me emërtime por ka edhe plot tema siç e tha edhe me herët Fehmia se kur të kalon një periudhë atëherë ne mund te ndërmarrim edhe veprime tjera te cilat unë jam dakord se komisioni e ka krye një punë të mirë dhe unë në cilësinë e kryetarit i kam bo presion edhe Rumirit se vendimin e kuvendit duhet me zbatua dhe duhet me qenë me te përkushtuar dhe te fokusuar ne këtë projekt për shkak të ndjeshmërisë dhe nevojës që e kemi. Besoj që ne muajt e ardhshëm do të kemi aktivitete të kësaj natyre dhe do të plotësojmë edhe pozicionet të cilat janë të munguara po ashtu do kemi edhe rrugë dhe sheshe të reja. Te emrat e përgjithshëm nuk ka ndonjë problem pasi besoj që jemi edhe dakord të gjithë p.sh. sheshi i Flamurit tani po e dëgjoj mirëpo vërtet po me pëlqen si emër dhe siç po me pëlqen edhe Kroi i Përgjakur edhe emrat në sheshe, por ne do të shkojmë p.sh. aty ku ka ndodhur masakra te lumi Bellaja që mund te ja lëmë emrin edhe atij lumi po ashtu edhe asaj kodrinës ku kanë të varrosur fillimisht që realisht ne i patëm varrosur e me pastaj janë rivarros. Pra mund te kemi plot aktivitete të kësaj natyre dhe unë e inkurajoj komisionin për emërtime që jo vetëm që ti merr parasysh kërkesat edhe te asamblistëve se tek e fundit Masar Popaj është anëtar i kuvendit që krejt në rregull është qe edhe ju me propozua por gjithashtu ti merr në konsideratë edhe këto hapësira që i kemi tash e tutje e ndoshta vitin e ri 2021 mund të kemi edhe kode të reja por mund të kemi mundësi te korrigjimit te ndonjë gabimi që e kemi. Kuvendi i Komunës është për atë punë dhe mendoj se komisioni tash e ka bërë një punë të mirë edhe ne mjediset e komunës por edhe ne teren edhe sigurisht se është shume mirë me ftua sa me shume njerëz që mos me lejua me dominua aspektet subjektive. Duhet kuptuar se çdo kush dëshiron m i vendos emrin e dikujt te familjes edhe është njerëzore mirëpo duhet me gjete emërtime që kanë një bazë histori një biografi të mirë. Po

ashtu Rukija e ka ngritë një çështje me herët, unë jam dakord për këto por besoj që është momenti për me votua një listë e cila mund te jetë një fillim i mbarë apo një vazhdim i një punë që ka me ndodh ndoshta edhe ne seancat e radhës dhe unë i kam sugjeruar komisionit se ju duhet me vazhdua punën pasi nuk është punë që kryhet shpejt dhe që përmbyllet ky proces kaq shpejt, pasi përditë mundemi me pas sheshe te reja parqe te reja lëndina te reja shtigje te reja që të gjithëve mund te ju vendosim një emër edhe me i shifrua qoftë me emra të përgjithshëm apo konkret, p.sh. rruga vreshtari shume mirë është edhe pse nuk jam në dijeni por sipas ligjit kryetari i komunës është garantuesi edhe propozuesi i  kësaj. Mirëpo nuk involvuar fare dhe për këtë mundet me u demantua dikush por vetëm i kam kërkuar drejtorit të urbanizmit që ti thërret ata të komisionit që ta kryen punën e vet pasi moti ka marr vendimin kuvendi. Kjo ka qenë kërkesë dhe këtë kërkesë kam kërkuar që me ju bo presion këtyre ne emër tuajin. Mënyra se si e kanë krye punën komisioni po besoj që e kanë këqyrë udhëzimin administrativ edhe besoj që kanë me plotësua punën e tyre në muajt ne vazhdim. Unë ju ftojë me votua edhe aty ku ka paqartësi mund te definohen edhe ne te ardhmen që ndoshta ne muajin shkurt mund te ketë pikërisht një pikë të ngjashme te rendit te ditës me propozime te reja. Kështu që nuk kisha deshtë me u vonua edhe për shkak ndjeshmërisë dhe unë nuk kam qejf që dikush me thanë që me ju lakua emri i dikujt në kuvend, që ndoshta edhe nuk e meriton kuvendi i komunës me diskutua tema të ndjeshme por sido qoftë unë ju ftojë për me miratua listën e propozuar nga komisioni për emërtime që  në përbërjen e së cilës janë anëtaret e kuvendit të komunës që e ka marr vendimin vet për te gjitha që kemi bërë dhe i kemi shtyje dhe që e kanë përkrahjen tonë dhe ju ftoje që ta përkrahni dhe me miratua këtë listë.

**Kryesuesi –** Faleminderit kryetar, gjithashtu dua të falënderoj të gjithë për kontributin edhe unë mendoj që edhe komisioni i ka trajtuar krejt por siç e potencoj edhe znj. Besa Bytyqi që për shkak edhe te materialit që me kompletua për kuvend pasi secili ka emërtim dhe biografi dosjen dhe propozimin prej kryesive të fshatit. E qesim në votim pikën e gjashtë te rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e gjashtë e rendit te ditës. Kalojmë pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private.**

**Afrim Oruqi –** Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtare të kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm. Para jush e keni vendimin në bazë të ligjit për këmbimin e pronës, të statutit të komunës, kryetarit të komunës për këmbimin e pronës komunale me pronë private. Bëhet fjalë për zonë kadastrale për Xërxë, për këmbimin e pronës me sipërfaqe prej 87m2 ndërmjet pronës private dhe pronës shtetërore. Kjo gjendet skaj rrugës Gjakovë – Prizren. Prona komunale shtetërore është me numër te certifikatës 1015/10 ndërsa prona private është në emër të pronarit privat Faton Zenel Thaqi nga Xërxa, e cila sipas certifikatës është me numër t[ certifikatës 1015/9 në emër te hardhi haus sh.p.k.  Qëllimi i këtij këmbimi ose marrja e pëlqimit prej juve është që te hapim rrugë edhe pse faktikisht është rrugë që është hapur n mandatin e kaluar e cila është kubëzuar dhe tani po dëshirojmë me i rirregullua kufijtë sepse ka pronë shtetërore skaj rrugës. Kjo rruge e kubëzuar që ju e keni një skicë para vetes, ka prekur edhe një pronë private në këtë sipërfaqe. Gjithashtu sipas ligjit e keni edhe një raport të komisionit i cili është nxjerrë me vendim te kryetarit i cili ka dalë ne terrene edhe e ka verifikuar dhe behet fjalë për sipërfaqe te njëjtë klase te njëjte për vlerë te njëjtë të këmbimit në sipërfaqe prej 87m2. Pas përfundimit te këtyre procedurave dhe pas marrjes se pëlqimit nga ju, drejtoria e gjeodezisë do të kujdeset që ti kryej punët tjera teknike. Ftojë kuvendaret që pas shqyrtimit, të votojnë propozim vendimin e kryetarit për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës private me pronë publike.

**Refki Kryeziu –** Faleminderit kryesues, sa i përket kësaj pike te rendit të ditës për këmbimin  pronës komunale me pronë private në zonën kadastrale ne Xërxë, konsideroj që është në interesin e qytetareve për hapjen e kësaj rruge. Personalisht e përkrahi këtë pikë te rendit te ditës dhe sugjeroj edhe kolegë tjerë asamblistë që ta përkrahin këtë pikë te rendit te ditës.

**Rasim Fazliu –** Unë te them të drejtën është mirë me u hapë rruga për qytetarë por diçka me pengon se pse bëhet shtruarja e rrugëve edhe nuk kryhen procedurat paraprakisht, pasi në muajin e kaluar e kemi shpallë me interes te përgjithshëm dhe tash që është normale me bo këmbimin e pronës por pse me ardh deri ne këtë çështje kur ka mundur me kohë rruga me u ndërtuar nëpër pronë publike, pra kjo është ajo qe s'po e kuptoj edhe le te shërben kjo si mësim për te ardhmen që se pari të shpallet me interes te përgjithshëm publik e më pastaj të ndërtohen rrugët për cilindo qoftë qeveri që ka qenë.
**Kryesuesi –** Faleminderit z. Kryeziu dhe z. Fazliu, e qesim në votim pikën shtatë te rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. **Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për dalje ne debat publik të Draft rregullores komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës se Rahovecit.**

Të nderuar kolegë kuvendarë, ne sot duhet te marrim vendim vetëm për dalje ne debat publik të rregullores rreth organizimit funksionimit dhe bashkëpunimit të komunë s me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Atëherë nëse nuk ka dikush diçka, e qesim në votim pikën e tetë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. **Shqyrtimi i Planit vjetor të prokurimit për vitin 2021.**

Të nderuar kolegë kuvendarë, ne edhe ne mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi trajtuar këtë pikë dhe i kemi diskutuar të gjitha të dhënat që na kanë ardhë nga prokurimi publik. Në mungesë te z. Mullabazi, fjalën ja kalojmë nënkryetarit z. Fatmir Iska.
**Fatmir Iska** – I nderuar kryesues, të nderuar asamblistë dhe ju gjithë të pranishëm në sallë. Në mungesë të ushtruesit të detyrës se shefit të prokurimit, unë vetëm po e propozoj planin e prokurimit që ju ta përkrahni dhe me miratimin e buxhetit që bëhet sot me lexim të dytë në Kuvendin e Kosovës ky planifikim paraprak do të bëhet edhe plan final i prokurimit. Ideja ka qenë që të gjitha projektet nëpërmjet Zyrës së Prokurimit të shpallen tek fundi i muajit qershor por vetëm disa mund të mbeten si p.sh. sigurimi i automjeteve që e ka afatin e vet që bëhet në gusht ndërsa të gjitha këto deri në qershor. Bëhet fjalë për 3 lloje kontratash, kontrata për punë furnizime dhe shërbime. Kështu që nëse keni diçka me shtua atëherë e inkorporojmë dhe nëse jo atëherë kërkoj që ta përkrahni.
**Rasim Fazliu –** Deshta vetëm me shtua se për shkak së dokumenteve ju mungojnë faqet dhe vështirëson punën e mëtutjeshme dhe është mirë që për mbledhje të radhës me qenë dokumentet me numra në faqe si sugjerim. E kam fjalën për furnizimi me materia reagenca shpenzues për laboratorë, nuk është bërë përshkrimi i kontratës edhe data e parashikuar e fillimit të prokurimit gjithashtu mungon, që realisht është mirë me qenë këto të plotësuara. Gjithashtu me një faqe tjetër ku shkruan ndërtimi i ngrohjes qendrore në objektet e komunës në nr. rendor 18 do të ishte mirë me formulua fjalinë ngase shkruan kështu qendrore ne SH.M.L. Xhelal Hajda-Toni në Rahovec d.m.th. të theksohet nxemja qendrore në shkollën e mesme XHELAL Hajda Toni në Rahovec. Me që janë dokumente do të ishte mirë që të plotësohen siç duhet pasi që janë dokumente zyrtare.
**Fehmi Cena –** Kur jemi te plani vjetor i Zyrës së Prokurimit për vitin 2021, mendoj që kështu dizajni është i mirë dhe i qartë edhe për këtë vite është shtuar edhe pjesa sipas drejtorive që për neve e bën më të qartë me kuptua. Unë po dua me ndërhy te pjesa kontrata për furnizim te shëndetësia, ku shoh se në shëndetësi janë të parapara disa furnizime të mira me aparate, me reagenca për laboratorë dhe barnat gjithashtu emergjente mirëpo mendoj që është diçka që mungon duke ditur gjendjen si është në teren në institucione tona, nuk po shoh diku pajisje medicinale për punëtorë shëndetësorë pasi janë të nevojshme që disa pajisje ë dukje nuk janë aparate te mëdha por që janë të domosdoshme dhe kryejnë punë shume sidomos tash në kohen kur jemi ballafaquar me pandeminë edhe është kërkesë e kahershme e mjekëve e mbledhjeve që i mbajmë ne atje po janë tensionmetra që është e nevojshme për secilin mjekë pastaj janë otoskopa aparate që na duhen për

ekzaminim të veshëve dhe me gjërë edhe ne jemi te detyruara me huazue me njeri tjetrin që e vështirëson punën pastaj pulsoksigjenometra që duken shume te vegjël por janë shume te rëndësishëm. Gjithashtu kërkesa edhe për veshmbathje sepse ka qenë tradite edhe me përpara çdo here edhe për personel shëndetësor pasi ne i kemi veshjet tona të caktuara por po e shoh që çdo vit po kemi furnizim me veshmbathje për punëtoret e inspekcionit dhe asnjëherë nuk ka për shëndetësi dhe duhet te këtë edhe për shëndetësi bile njëherë ne 3 apo 4 vjet dhe nuk duhet me u bazua vetëm ne donacione që vinë sepse shpesh herë ato nuk janë edhe te përdorshme. Po ashtu tjetër që me ka rae në sy në këtë plan është se tek vlera e parashikuar e disa kontratave ne mjaft raste vlera po e tejkalon vlerën e parashikuar sipas planifikimit te buxhetit që e kemi bo në kuvend, qe ka mjaft projekte që janë të parapara me shumën me të vogël edhe e këtu e kam vërejt që janë në shumën më të madhe dhe a ka mundësi me na shpjegua sepse nëse rritet vlera ne tender mos ndoshta është largua ndonjë projekt që ne e kemi paraparë sidomos te pjesa e projekteve kapitale.

**Fatmir Iska –** Te pyetja e kolegut z.Fazliu, furnizimi me material reagenca shpenzues për laborator d.m.th. është data e planifikimit 20.02.2021, mirëpo këtu ne tabelar kur ti bashkojmë dy faqet atëherë del ajo shumë d.m.th. është e bashkangjitur me furnizime me material shpenzues mjekësor për nevojat e QKMF-së por këtu ne tabelar nuk duket pasi është në fund. Po ashtu për gabimet gjuhësore mund te ketë pajtohem rreth kësaj pasi jo veç ne këtë por në te gjitha vendimet. Pastaj te pyetja e drejtuar nga z. Cena sa i përket planit të prokurimit dhe pajisje mjekësore pastaj për staf shëndetësor pasi është deshtë me u diskutua në buxhetin komunal pasi është plani kështu që po e diskutojmë tash që lidhet me buxhetin e vitit 2021 të cilin e kemi votua në shtator por kjo nuk do të thotë që nuk mundet me u bo pasi ka kohë sepse është kodi për mallra dhe shërbime që kryhen edhe këto punë qoftë ne drejtorinë e shëndetësisë apo edhe ne drejtori tjera. Pastaj pyetja tjetër sa i përket vlerave, siç e dimë edhe me herët që prej pasluftës që një projekt p.sh. një shkollë 500,000 euro por ne kemi paraparë me buxhete 10,000 euro dhe 10,000 euro e kemi shpallë tenderin. Pra këto janë vlera të parashikuar te një projekti i cili sa mundet me qenë vlera e atij projekti pastaj ne buxhete i kemi me pak mjete e me pastaj shtohen me rishikime ridestinime kontrata dy vjeçare tre vjeçare pra kjo është ajo sa për sqarim.

**Kryesuesi –** Faleminderit shume te nderuar kolegë, e qesim ne votim pikën e nëntë te rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e nëntë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. **Shqyrtimi i realizimit të planit të punës për vitin 2020 të Auditorit të Brendshëm si dhe shqyrtimi i planit të punës për vitin 2021.**

**Fehmi Hoxha –** Faleminderit kryesues, edhe në seancat e kaluara kam kërkuar që Auditori i Brendshëm i raporton vetëm kryetarit edhe nuk duhet te bëhet publike, kështu që kërkoj që kjo pikë të tërhiqet pasi Auditori i Brendshëm është këshilltari i kryetarit edhe nuk bën me raportua.

**Rasim Fazliu –** Faleminderit kryesues, unë mendoj që raportin vjetor duhet me ditë se kush e ka sjellë dhe ne jemi të vetëdijshëm që Auditori i Brendshëm i jep llogari kryetarit edhe është në rolin këshillëdhënës siç e potencoj edhe kolegu Fehmi Hoxha mirëpo kryetarin nuk e ndalon askush nëse ai e ka vullnetin me sjellë këtu atëherë pse mos me u diskutua apo pse mos me qenë si pikë e rendit te ditës. Por auditori apo njësia e auditimit neve kuvendareve drejtpërdrejtë nuk na jep llogari edhe e kemi qartë pasi nuk është e obliguar me na dhanë llogari por nëse kryetari e ka sjellë si pikë te rendit te ditës dhe mirë ka bërë që e ka sjellë edhe për hire të transparencës. Edhe ne që kemi pasur në disa seminare na është thënë se neper komuna është mirë me i sjellë kryetari raportet e auditimit pasi ne se deputet të kuvendit nuk po kërkojmë prej njësisë se auditimit me na sjellë pasi e dimë se nuk kemi të drejtë por nëse kryetari e sheh të arsyeshme atëherë kjo është mirë edhe për shkak të transparencës. Kështu që kryetari ka bërë shumë mirë që e ka sjellë këtë raport të auditimit mirëpo ky më së paku është raport sepse në fakt është shumë i mangët pasi janë vetëm dy faqe edhe realisht është shumë i paqartë, për shkak se raport i thuhet ashtu siç e ka shkrua Njësia e Audimit të Brendshëm edhe më pastaj ne i gjejmë të dhënat, vërejtjet pastaj sa janë zbatuar rekomandimet por në këtë formë si ka ardhur me vetëm dy faqe ky thjesht emrin ja kanë vendos raport vjetor i punës mirëpo ky nuk është raport. Por, edhe njëherë po e potencoj se kjo mbetet në vullnetin kryetarit të komunës kjo punë më qe kolegu Fehmi Hoxha e propozoj që të

mos diskutohet edhe unë i bashkëngjitëm që të mos diskutohet pasi nuk ka nevojë me u diskutua sepse edhe nuk kemi çka me diskutue këtu se nuk është raport.

**Kryetari –** Plotësisht pajtohem me z. Rasim Fazliun dhe gjithë të tjerët që eventualisht kanë të njëjtin mendim. Ky është raport i Njësisë së Auditimit të Brendshëm i cili flet se sa ka mbërri me realizua planin vjetor Njësia e Auditimit të Brendshëm. Në planin e punës se kuvendit si pikë e rendit të ditës nuk ka te bëj me raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe në këtë pikë jam dakord me z. Fazliu se nuk bëhet fjalë për raportet veç e veç edhe punën deri ne detaje që e bën Njësia e Auditimit të Brendshëm sepse ligji nuk na obligon madje na ndalon edhe të drejtën me komunikua. Pra vullneti i im i plotë është me i dorëzua raportet e auditimit të brendshëm të gjitha mirëpo ligji nuk e parasheh këtë. Edhe një shpjegim shtesë dhe besoj që e dini, se te gjitha raportet e auditimit të brendshëm janë të hapur për auditimin e jashtëm për Zyrën Kombëtare të Auditimit, i cili rekomandimet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të gjeturat konkluzat i inkorporon ose i integron Yyra Kombëtare e Auditimit ( ZKA ), prandaj nuk ka të bëj aspak me jo transparencë por vetëm që me i sjellë raportet veç e veç që unë vet e kam preferuar dikur por mu ka dhënë rekomandimi edhe në këtë kuvend ka pasur plot zëra të arsyeshëm që kanë thënë që e keni të ndaluara me i sjellë raportet e auditimit të brendshëm ndërsa raporti i auditorit të jashtëm pa diskutim është publik për me u diskutua në kuvend dhe ne atë raport të auditorit të jashtëm janë edhe raportet e auditimit të brendshëm. Pra ky është vetëm plani i punës se sa ka mbërri Njësia e Auditimit të Brendshëm me krye punën e vet se është ne përputhje me planin vjetor të punës se kuvendit, pra kështu është kërkuar dhe kështu është ne plan edhe ne, ne funksion të zbatimit të planit të punës se kuvendit është paraparë që të jetë pikë e rendit të ditës edhe raporti i ecurisë se punëve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për një vit. Prandaj nuk besoj që ka arsye për debat mirëpo atëherë kur vjen raporti i auditimit të jashtëm atëherë jemi ne rregull.

**Kryesuesi –** Faleminderit kryetar, atëherë edhe me propozimin e z. Hoxha, kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

**11. Shqyrtimi i Raportit të punës të Kuvendit Komunal për vitin 2020.**

**Kryesuesi –** Të nderuar kolegë kuvendarë, materialin gjithsesi e kemi secili, kuvendi i komunës tonë duke përfshirë dhe mbledhjen e sodit ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, 2 mbledhje komemorative me rastin e vdekjes se ish kryetarit të Komunës se Rahovecit z. Esat Haxhijaha dhe inspektorit të komunës z. Sabahudin Qeska. Gjithashtu kuvendi ka mbajtur edhe një mbledhje solemne ku është shpallur qytetar nderi z. Tomor Tomori. Kuvendi mendoj që për këtë vite edhe për kundër sfidave që i kemi pasur lidhur me pandeminë, jemi munduar të i kryejmë obligimet tona dhe mënyrën ma te mundshme vlerësoj se i kemi krye. Komiteti për Politike dhe Financa gjithashtu në bazë të rregullores ka organizuar edhe këtë vite mbajtjen e dëgjimeve buxhetore të cilat në një mënyre duke respektuar të gjitha rekomandimet apo rregullat e IKSHPK-së kemi marrë të gjitha prioritet e kërkesat e qytetareve të Komunës tonë rreth prioriteteve te tyre dhe gjithsej kemi organizuar 10 dëgjime buxhetore ku se bashku kanë marr pjesë me neve çdo herë drejtori i Financave z. Limani dhe drejtorët e tjerë. Për te mos ju marr me tepër kohë për shkak të rrethanave që jemi duke mbajtur këtë mbledhje ne sallën e shtëpisë se Kulturës dhe kushtet e ftohta që janë dhe jo të zakonshme, materialin e keni përpara që si kuvend po du me ju falënderua të gjithëve për vitin që e kaluam për kontributin e gjithë kolegëve, gjithsesi duke mos e anashkaluar edhe Zyrën e Kuvendit me z. Skender Hamza dhe bashkëpunëtorët e tij që i kanë kryer obligimet e veta. Nëse dikush ka diçka atëherë ne jemi këtu për çfarëdo çështje, edhe njëherë ju falënderoj sinqerisht të gjithëve për kontributin që e kemi dhënë për këtë vite.

**Ali Zhuniqi –** Unë veç deshta një koment përkundrazi me gjithë respektin që kam z. Salltekun, puna e kuvendit meqenëse jemi edhe përmbyllje te vitit duhet vlerësuar edhe mënyra se qysh i kemi shtyje projektet përpara edhe mendoj që është njëra prej arsyeve që funksionimi i kuvendit me ekzekutivin e ka qitë kryetarin të dytin edhe kjo puna nga ana e kuvendit besoj që duhet me u vlerësuar kurse ne anën tjetër e shoh që kam një kritikë për Zyra e Kuvendit pasi materiali po na vjen i skanuar dhe mirë do të ishte që të na vjen sikur përpara

pasi dikush ka problem me sy dhe përdor syza dhe dikush nuk mundet me lexua, kështu që do të ishte mirë që mos me na dërgua të skenuar.

**Kryesuesi –** Faleminderit z. Zhuniqi, materiali gjithsesi duhet te jetë i skanuar për shkak te ndonjë ndërhyrje që mundet me ndodh nëse dërgohet në Word.

**Rasim Fazliu –** Kryesues, unë veç desha me te falënderua publikisht që keni qenë në nivele të detyrës dhe se e keni kryer punën mirë dhe uroj që edhe viteve tjera ju shkon mirë.

**Kryesuesi -** Faleminderit z. Fazliu, unë mendoj që të gjithë se bashku kemi dhënë kontributin tonë. Kalojmë në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

**12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës se Kryetarit të Komunës për vitin 2021.**

**Kryetari –** Ky është plani i punës se Kryetarit dhe qeverisë që e drejtoj, është plan i punës që kryetari i merr përgjegjësitë e veta dhe kemi pritë ndonjë koment sepse sipas standardeve te reja të qeverisjes edhe te përformances komunale, plani i punës publikohet dhe qëndron një muaj, kështu që e kemi publikue me kohë edhe e kemi pritur ndonjë koment. Ne hymë ne vitin 2021 natyrisht me synime objektiva me prioritete siç kemi hyrë këtë vite edhe po besoj që ne mundemi me shqyrtua tash dhe me diskutue pasi materiali është po sidoqoftë mendoj që është një planë ambicioz, një planë i cili përcakton qartë synimet objektivat dhe prioritetet e qeverisjes komunale dhe kryetarit të komunës natyrisht. Rreth printimit te materialit kemi problem siç ka problem edhe krejt Kosova për shkak se u ndërrua kompania pasi nuk është kompetence e jona dhe kemi vështirësi serioze edhe ne furnizimin me pajisje edhe ne printimin e materialeve. Prandaj edhe ato vërejtjet që i dha Alia apo dikush prej juve dhe ndonjëherë edhe unë po kamë problem se nuk po i shoh e sidomos te ky materiali i fundit dhe nuk po kemi mekanizëm për me vendos ne emër te kompanisë që ka marr kontratë ne nivelin qendrorë. Kompania e mëhershme ka qenë me e mirë mirëpo kjo nuk varet nga ne pasi kështu ka vendos niveli qendror që ka lidhë kontratë me dikë tjetër dhe po kemi problem edhe me furnizim me pajisje. Këto po ju them që me qenë edhe ju në dijeni dhe për këtë kërkoj ndjesë për shkak se nuk kemi mundur me ju sjellë materialet që me u pa me mirë. Pra duhet ta kemi te qartë qe ne nuk e kemi lidhur kontratën pasi është e centralizuar dhe nuk kemi të drejtë me shkëputë kontratën. Unë ju ftoj që ta kalojmë ketë pikë pasi plani i punës se kryetarit është publik dhe vlen për vitin 2021 edhe besoj që ne do të përpiqemi maksimalisht me përmbushë planin por edhe nëse del diçka rrugës mundet me u pasurua qoftë nga kuvendi apo grupet e tjera te interesit.

**Ali Morina –** Faleminderit kryesues, unë po dua me falënderua edhe kryetarin për një bashkëpunim të ngushtë, po flas në cilësinë e asamblistit pasi kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me kryetarin por edhe me secilin drejtor te drejtorive komunale. E kemi analizua planin e punës, që vërtet ka prioritete shume te rëndësishme për qytetaret e komunës se Rahovecit që i kisha theksua prioritetet ne bujqësi dhe vendi pothuajse kryesor ne qeverisjen komunale i është dhënë sektorit të bujqësisë, pasi vërtet e meriton sepse jemi trevë bujqësore dhe kemi shume familje që jetojnë prej kësaj veprimtarie. Po ashtu desha me theksua tek prioritetet për shëndetësi, e kuptoj vullnetin edhe dëshirën e kryetarit që me ju ofrua shërbime sa me te mira qytetareve dhe me i shtua kapacitetet humane dhe teknike që me ofrue shërbime sa me te mira mirëpo desha te kërkoj nga kryetari që të bëhet përpjekje deri sa te ofrohen mundësitë për me u rritë dhe i zgjatë ndërrimin e punës nëpër QMF-të neper fshatra, që ne Ratkoc apo ne Krushe të bëhet me 3 ndërrime dhe ne te njëjtën kohe me u bo edhe ne vendbanimet me te vogla ne dy ndërrime. Deri më tani mundësit teknike dhe humane kanë qenë të kufizuara që kjo me u në të gjitha QMF-të dhe unë kisha kërkuar nga kryetari që të paktën të bëhen përpjekje që të paktën ne Ratkoc dhe në Krushe të bëhet me 3 ndërrime kurse në vendbanimet tjera si në Malësi, Çifllak, Opterushë të mbeten me ka një ndërrim deri sa te jepet mundësia që edhe ato me u bo me dy ndërrime, por te paktën këto dy vendbanime te bëhen me ka 3 ndërrime sepse gravitojnë neper zona të gjëra me vendbanime dhe do të ishin një lehtësi shume e madhe për qytetaret.

**Kryetari –** Kërkoj falje dhe njëherë se duhet me u aprovue plani. Ne kemi problem me mjekë pasi nuk kemi te mjaftueshëm dhe fatkeqësisht nuk kemi ende te licencuar për me marr mjekë te ri në komunën tonë dhe kom menduar me marr edhe prej komunave tjera por nuk ka as ne komuna tjera sidomos tash gjatë kësaj periudhe, pasi që te gjithë i ka marr ministria dhe i ka shtie ne punë. Do te kemi probleme me rastin e zbatimit te projektit për specializim te mjekeve që e kemi tash dhe vështir ndoshta do të jetë me zgjatë orarin e shërbimeve ne Krushë dhe Ratkoc, apo në QMF-të e tjera. Do të përpiqemi me i mirëmbajt këto shërbime që i kemi edhe me i pasurua sipas mundësive me mjete tjera por kemi personel te mjekëve e posaçërisht nga marsi fillojmë me u kërcënua në mungesë të mjekëve, infermierë kemi mjaftueshëm por me mjekë kemi problem. Uroj që ndonjë qytetar është afër diplomimit dhe me marr licencën pasi nuk kemi te drejtë me marr mjekë te pa licencuar dhe menjëherë i kishim marr edhe i kishim sistemuar por e vërteta është se nuk kemi mjekë, pasi edhe vetë kemi qenë te dakordit që me zgjat edhe me tutje orarin e shërbimeve mirëpo ne mungesë te mjekeve jemi në krizë rreth stafit me mjekë dhe profesionistë.
**Kryesuesi –** Faleminderit shume kryetar, të nderuar kolegë kuvendarë e qesim ne votim pikën e dymbëdhjetë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e dymbëdhjetë e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e trembëdhjete te rendit të ditës:

**13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës se Kuvendit të Komunës për vitin 2021.**

**Kryesuesi –** I nderuar kryetar, kolegë asamblistë, me datën 09.12.2020 anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe të gjithë drejtorët e drejtorive komunale se bashku edhe me nënkryetarin kemi mbajtur një takim pune ashtu të emëruar dhe kemi bërë hartimin në bashkëpunim me drejtoret te planit të punës se kuvendit për vitin 2021. Gjithashtu siç e potencoj edhe kryetari se ka qenë ne debat publik plani i punës se kryetarit edhe gjithashtu edhe plani i punës se kuvendit, nuk kemi pasur ndonjë informatë apo shkresë nga dikush që të inkorporohet edhe diçka tjetër rreth planit të punës se kuvendit dhe e kemi te gjithë ne material për planin e punës se kuvendit për vitin 2021. Ju kisha ftuar që edhe këtë pikë ta aprovojmë.
**Rasim Fazliu –** Faleminderit kryesues, atëherë pasi pak me parë thamë që njësia e auditimit nuk ka nevojë me dhanë raport do të ishte mirë këtu që në muajin dhjetor për vitin 2021 të jete vetëm plani i punës të njësisë se auditimit për vitin 2021.
**Kryesuesi –** Faleminderit z. Fazliu, atëherë më qe nuk ka tjerë te lajmëruar e qesim ne votim pikën e trembëdhjetë te rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e trembëdhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërmbëdhjetë te rendit të ditës:

**14. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.131/20, të datës 30.11.2020 për dhënien ne shfrytëzim afatshkurtër.**

**Përparim Krasniqi –** Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar dhe gjithë ju të pranishëm. Kam kërkuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa që të kthehet vendimi për deponinë legale që është ne Rahovec për shkak se Ministria e Pushtetit Lokal nuk po mundet me pranua vendimin paraprak për çështjen e deponisë në hedhjen ne ankand ne vlerë financiare zero. Për këtë arsye jemi detyruar me rikthye edhe njëherë vendimin që se paku te jetë vlera minimale pasi e kemi parcelën prej 11 hektarëve mirëpo e kemi ndarë një parcele prej hektar dhe do të jetë një vlerë minimale për kompani që do ta marrin për menaxhim këtë deponi. Ky është vendimi dhe mund te shihni edhe pamjet përmes ortofotos.
**Kryesuesi –** Faleminderit drejtor, e para që duhet te bëjmë është që ta shfuqizojmë vendimin. Të nderuar kolegë e qesim ne votim pikën e katërmbëdhjetë te rendit të ditës për shfuqizimin e vendimit. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërmbëdhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pesëmbëdhjete te rendit të ditës:

**15. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër.**

Përparim Krasniqi – Vendimi paraprak duhet me u shfuqizua edhe duhet me hije vendimi i ri ne fuqi për parcelën prej 3 hektar që shkëputet pjesa prej 11 hektarëve që shkëputet vetëm pjesa prej 3 hektarëve dhe merret vendimi sot, me kohëzgjatje prej 5 vite, me vlerë 300 euro për një vite. Për shkak të rregullores për taksa dhe tarifa ne pjesën e bujqësisë varet prej kategorisë se tokës është 0,01 që d.m.th. i bie afërsisht 300 euro vjetore.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, unë dua të pyes drejtorin se pse e keni cekur 5 vite këtu për shfrytëzim kur dihet se kuvendi është kompetent për caktimin, e që duhet me shkua prej 0-15 vite. Kështu që ndoshta ne dëshirojmë me marr qëndrim që me dhanë për 10 vite dhe si dokument i tillë dhe duhet te përmirësohet e të thuhet se i nënshtrohet ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1-15 vite e me pastaj ne si kuvend marrim vendim sa vite dakordohemi sigurisht, pra vërejtja ime është që si dokumente duhet te shkruhet saktësisht prej 1-15 vite.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Fazliu, sigurisht se do te përmirësohet ajo dhe do të shkruhet prej 1-15 vite dhe ne do ta japim në shfrytëzim për 5 vite.

**Fehmi Cena** – Unë desha me qartësua deri në fund këtë çështje se nuk e kam te qartë, pasi sipas drejtorit po del që ne ankand për këtë pjesën e deponisë së Rahovecit për mirëmbajtje po jepen 3 hektar kurse deponia është 11 hektar, Pastaj çka do te behet me 8 hektar, si do te menaxhohet kjo, duke qenë se është një pjesë dhe tash qytetaret ku do te i hedhin mbeturinat pasi një pjesë do te jetë me pagesë kurse tjetra pa pagesë kështu që kish pas mundësi me na qartësua pak rreth kësaj.

**Perparim Krasniqi** – Krejt ideja e ankandit është për shkak operatoret e kompanive nuk po ofrojnë në komunën e Rahovecit për shkak te pagesës pasi po duhet me dhanë pare komuna e Rahovecit për hedhjen e mbeturina inerte. Kështu që jemi detyruar që një pjesë te parcelës në hyrje te rrugës, te behet parcelizimi dhe pjese pjesë te bëhet mbushja kështu që 3 hektar me i ndaje për fillim me vlerë minimale dhe pastaj pas 5 vite nëse trajtohet ajo 3 hektarshi atëherë fillojmë me procedurë edhe me pjesë tjera dhe të shfrytëzohet e gjithë parcela prej 11 hektar. Pra kjo është ideja, fillohet me hyrjen e parcelës dhe vazhdohet me tutje.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume drejtor për sqarimin, e qesim në votim pikën e pesëmbëdhjete te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pesëmbëdhjetë e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e gjashtëmbëdhjetë te rendit te ditës:

**16. Informatë rreth konkursit ndërkombëtar për dizajnimin e Sheshit Qendror të Qytetit të Komunës së Rahovecit**

**Rumir Zhuniqi –** Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar asamblistë. Në mbledhjen fundit të komitetit për Politikë dhe Financa është kërkuar një informatë për dizajnin e ri apo dizajnin e sheshit qendror të Rahovecit i cili është përzgjedhur në konkursin ndërkombëtar që kemi mbajtur. Komuna e Rahovecit ka iniciuar procesin e ridizajnimit të sheshit qendror apo përcaktimit të zonës qendër të qytetit të Rahovecit, ku e kemi shpallur konkursin ndërkombëtar me 1 shtator i cili ka qenë i hapur i cili ka qenë i hapur deri me 16 nëntor 2020. Në këtë konkurs kanë marrë pjesë gjithsej 80 studio të arkitekturës apo arkitekt nga 37 vende te botës. Juria profesionale e përberë nga 5 anëtar, prej tyre 3 ndërkombëtar dhe 2 vendor i kanë përzgjedhur fituesit e konkursit. Fituesin e konkursit ju kam dorëzuar secilit asamblist që mund ta shihni projektin apo koncept idenë dhe mund te bëni pyetje që mund të ju jap edhe sqarime shtesë.

**Ali Zhuniqi –** Faleminderit që na keni sjellë këtë koncept të fituesit të konkursit që ndoshta edhe e keni nënshkrua kontratën me këtë kompani. Të paktën u deshtë që si lloje informatë për ne me qenë në gjuhen shqipe pasi ka shume që nuk e njohin gjuhën dhe këto specifika të cilat janë të prezantuar ne numra, nuk është që ne mundemi me ditë ne detaje edhe me na tregua se a është brenda konceptit ky shesh që e identifikon Rahovecin qoftë edhe me një specifikë të veçantë qofshin ata gurë pasi nuk jam arkitekt edhe nuk mund ta di dhe tjetra sa unë kam mundur me pa prej projekteve me te mira që është prezantuar në kuadër te gjitha

studiove te arkitekturës është projekti i dy arkitekteve te Rahovecit të cilët është njëri prej projekteve me te mira  të propozuara te paktën sa kam mundur me pa konceptualisht edhe vizualisht nga ana e prezantimit e këtyre dy arkitekteve. Për ndryshe nuk kam mund te jap ndonjë koment përveç një rreth i cili është me hapësirë jashtëzakonisht te madhe edhe pavarësisht që mundet me u prezantua si sukses, edhe lapidari i dy heronjve të Tonit dhe Micit është i futur komplet  në një rreth i cili është i mbushur me ujë që ne datat historike që ata kanë rënë nuk kemi pasur qasjen e tyre që të paktën për me i nderuar ne ato data.

**Fehmi Cena –** Në mbledhjen e Komitetit për Politike dhe Financa që pikërisht jam unë që kam kërkuar një informatë të servohet në këtë kuvend pra një informatat të hollësishme lidhur me këtë projekte. Arsyeja që kam kërkuar informatë të hollësishme lidhur me këtë projekt është se projekti është madhor dhe i rëndësishëm për qytetin dhe komunën tonë dhe shume projekt i kushtueshëm pasi do të kushtojë me miliona dhe ka paqartësi dhe pakënaqësi tek qytetaret për mënyrën se si ka shkuar ky proces deri tek dizajnimi final i projektit. Po ashtu është anashkaluar edhe asambleja komunale sepse është deshtë te sillet materiali si projekt ideor dhe si plan të diskutohet ne asamble dhe pastaj ne ta miratojmë në diskutim publik, d.m.th. gjithçka ka shkua përmes komunës dhe ju do të na qartësoni pse  e keni bërë këtë. Edhe unë mendoj që kjo paqartësi dhe më duket jo vetëm unë që mendoj ashtu por edhe një pjesë e mirë e qytetareve me te cilët ne kontaktojmë është punuar pak me nguti rreth këtij projekti edhe nëse analizojmë te gjitha këto hallka që ka kaluar procesi, atëherë është diku ne listën e pestë për ti ndihmuar unë delegatët. Pra nëse shkojmë nga hartimi i kufijve, tash janë  të  kufizuar kufijtë, pikat ne atë pjesë dhe mendoj se brenda asaj pjese nuk janë kryer te gjitha procedurat e nevojshme para se te kalohet ne konkurs për dizajnin  përfundimtar te projektit. Po ashtu e dimë se aty ka edhe prona private dhe ne nuk e dimë se a është zgjidhur kontesti me ato prona private, me bizneset që funksionojnë po ashtu ka edhe prona nen menaxhim te autoritetit te privatizimit, kështu që ne në njërën nga mbledhjet  e kaluara si kuvend komunal e kemi diskutuar një pjesë te parcelës dhe e kemi shpallë si interes te përgjithshëm mirëpo ne nuk e dimë se a është kryer ky kontest dhe a do të jetë definitivisht brenda kornizave te këtij projekti. Po ashtu janë edhe objekte te tjera e që unë kisha me i veçua  dy parkingje te mëdha janë në këtë pjesë të qytetit që njeri është para hotel parkut kurse tjetri është përpara palestrës sportive dhe ne nuk e dimë se çka do të ndodhë tash me ato parkingje pasi unë mendoj se janë jashtëzakonisht te nevojshëm për qytetin dhe gjithë komunën tonë, e po ashtu edhe hoteli është aty pra çka do te ndodhë me këto pjesë pasi e dimë edhe si komunë si qytet kemi probleme me parkingje dhe a keni menduar që ju dhënë zgjidhje këtyre çështjeve p.sh. shtrohet pyetja se a kishte mundur ky sheshi qendror i qytetit me u bë me këtë sipërfaqe por me i pas parkingjet ne dispozicion. Pastaj hallka tjetër është dialogu me qytetarë, që mendoj se dialogu me qytetarë nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe i zbehtë dhe ka qenë vetëm ne formën elektronike pasi ka munguar pjesëmarrja fizike e debateve sa duhet  dhe ne e kuptojmë se ka qenë kohë e pandemisë dhe kjo nuk është shfrytëzuar ne maksimum mirëpo ndoshta keni mundur me shtyje pakës konkursin për dizajnim deri ne pranverë në një kohë me te mirë e ndoshta pandemia ishte larguar në mase te madhe dhe atëherë qytetaret kishin marr pjesë ne debate me shumicë dhe ne fund pyetja është se a është patjetër ky konkurs te jetë ndërkombëtar dhe a është me qenë patjetër në këtë vite apo ndoshta ka mundur me u shtyje edhe vitin e ardhshëm në një kohë më të mirë kur edhe komuna do të kishte buxhete të mjaftueshëm me punua këtë projekt në mënyrën ma të mirë te mundshme.

**Kryesuesi –** Faleminderit z. Cena, unë po dua me falënderua drejtorin z. Zhuniqi që pas kërkesës nga ana juaj në Komitetin për Politikë dhe Financa ka mbërri me përgatitë informatë shume te mirë dhe te hollësishme.

**Kryetari –** Unë dua te them diçka se as unë, as Fehmi Cnea e as Ali Zhuniqi nuk jemi specialistë e as Rumir Zhuniqi madje si drejtor. Në projekt në dizajnimin e sheshit qendror të qytetit ka marr pjesë një organizate e specializuar për planifikim si UN-Habitati e cila bashkë me drejtorinë e urbanizmit edhe me drejtorinë e gjeodezisë i ka specifikuar të gjitha pronat njëherë se ka do shtrihet projekti. Debati me qytetarë kanë aktiv

dhe ka qenë një interesim i jashtëzakonshëm i qytetareve  dhe te gjitha komentet e bëra UN-Habitati i ka inkorporua komentet e qytetareve dhe ndoshta Fehmi Cena nuk ka mundur me marr pjesë. Kuvendi i komunës nuk vendos se a duhet me pas konkurs ndërkombëtar apo konkurs te brendshëm. Në vlerësimet e kryetarit te komunës të drejtorisë se urbanizmit është se duhet me pas konkurs ndërkombëtar, pasi në përbërje te jurisë kanë qenë 3 ndërkombëtar dhe 2 vendor dhe kuvendi i komunës nuk mundet me përcaktua se kur e ka prioritet kryetari i komunës një projekt. Mirëpo mos harroni se edhe neper kuvend te komunës ka kaluar ky projekt kur u shpall vendimi për mbrojtje të interesit të përgjithshëm te atij territori se ka do te shtrihet sheshi. Kështu që nëse Fehmi Cena është i paqartë atëherë normalisht se ka me krijua paqartësi te qytetaret, por ju kisha lutu që të informoni drejt dhe nëse keni  paqartësi atëherë mund te shkoni ne drejtorinë e urbanizmit dhe a duhet me u shpallë këtë vite apo duhet me u shpallë në një vite tjetër dhe a duhet me u krye sot apo nesër, mirëpo tash për tash komuna e Rahovecit asnjë cent nuk e paguan. Kështu që sot kalon buxheti ne nivele qendror dhe pastaj ne e bëjmë me qeveri dhe me ndihmën e donatoreve te jashtëm do të rregullohet ky shesh dhe sa do te kushton unë nuk e di për shkak se ende nuk është bërë projekti kryesor. Prandaj një asamblist siç është edhe shef i grupit parlamentar duhet me qenë tepër i vëmendshëm se çfarë fletë pasi ë jemi ne kuvend te komunës. Nuk mundet me i tregua kryetarit të komunës se a do me shpall konkurs te projektimit ndërkombëtar apo të brendshëm për një projekt kaq madhor, pra nuk mundet asnjeri me i tregua për prioritetet e kryetarit të komunës. Ky është një projekt që e ne e kemi vlerësuar që do një përkushtim dhe një profesionalizëm pasi juria është ndërkombëtare dhe ata e kanë bërë përzgjedhjen  dhe vetëm njeri nga anëtaret është nga Rahoveci dhe është me emër dhe te gjithë i kanë CV-të e veta dhe unë nuk mundem me i tregua Përparim Ramës njërit prej shqiptareve se a duhet me u përzgjedh ky apo ai projekt dhe për asnjë projekt. Mirëpo ne duhet m qenë t kënaqur se ky proces ka marr vëmendje shume te madhe ndërkombëtare ku 80 studio projektues nga 37 vende te botës në 5 kontinente e madje edhe nga Rusia dhe krejt çka nuk kam dëshirua unë është qe mos me fitua ketë projekt ndonjë studio nga Rusia apo Serbia. Juria profesionale e ka bërë punën e vet pastaj gjeodezia dhe kadastra e ka krye punën e vet, incizimin e gjendjes deri ne detaje e kanë bo dhe ne baze të dokumentacionit që ja kemi ofrua ne kadastra jonë, pastaj situatat kontestuese janë situata që po ashtu janë të përfshira dhe unë mendoj që se ky është një projekt tepër i rëndësishëm dhe është mirë me u realizua pasi është ne te mirën e qytetareve te Rahovecit dhe te komunës se Rahovecit dhe jo vetëm kaq por edhe me gjerë. Konkurse ndërkombëtare ka pasur edhe në komuna tjera  por pos Tiranës dhe Rahovecit në trojet shqiptare asnjë projekt ska marr vëmendje kaq te madhe përveç sheshit Skenderbej. Dhe me i shkua mendja dikujt sot me i kontestua vlerësimet profesionale të një jurie që ka qenë autonome plotësisht nuk është mirë pasi duhet me qenë te matur dhe te kujdesshëm se çfarë po flasim se përfaqësojmë edhe ne diçka, pasi asnjë fjalë nuk e kam thënë unë por vetëm i jemi gëzuar lajmit se projekti ideor është bërë përzgjedhja ne rregull. Të transparenca, procesi ka qenë tërësisht transparent, pasi nuk hynë UN-Habitati, ata arkitekt ata anëtarë të jurisë nuk hyjnë në një proces jo transparent. Sa i takon asaj që është e shkruar ne gjuhen angleze dhe pikërisht për këtë edhe drejtoria e urbanizmit nuk ka se çfarë te ju informoj pasi ata i kanë krye te gjitha punët dhe ne jemi vetëm logjistike. Kurse projektin kryesor ne bazë te projektit ideor, normalisht që ne kemi kontrate me kompaninë projektuese projektues te jashtëm e sigurisht duhet me kërkua ndihmën edhe te këtyre që kanë marrë pjesë ne krejt këtë proces ne mënyrë që projekti kryesor për implementim për me u lidh kontrata dhe me u shpall procedura duhet me qenë sa me mirë edhe me reflektua gjithë atë që e kanë dizajnue ajo studio projektuese që është fituese e projektit sipas jurisë profesionale që e tha edhe me herët drejtori i urbanizmit se janë 3 ndërkombëtar dhe 2 vendor. Debatet me qytetarë, ju mund me hije edhe me pa të UN-Habitati edhe mund ta shini se sa shume qytetarë kanë marr pjesë të Rahovecit që kanë qenë të interesuar rreth këtij projekti. Pra ka shumë qytetarë dhe ne asnjë projekt tjetër nuk ka interesim më të madhe as nga qytetaret e këtij vendi se sa te interesuar rreth këtij projekti. I mirëkuptojmë ata që kanë aplikua edhe të Rahovecit por nuk jemi na ata që kemi vendos sepse

konkursi është ndërkombëtar edhe nëse ka marr ndonjë pozicion ata mirëpo ne bazë të një reagimi te njerëzve që munden me qenë te pakënaqur. Mirëpo tek e fundit me pas qenë vlerësimet tona atëherë keni te drejtë kuvendi i komunës me thanë se pse keni vendos për këtë projekt e nuk keni vendos për këtë tjetrin. Konkursi është ndërkombëtar pasi 75,000 euro ka paguar komuna jonë për këtë proces me sjellë deri këtu sepse UN-Habitati e ka marr përsipër për te gjitha. Pra ne duhet me qenë te kënaqur që UN-Habitati ka qenë pjesë e proceseve dhe me rolin vendimtarë në proces. Pasi ata i kanë bërë detyrat projektuese dhe kanë qenë udhëheqës te proceseve dhe drejtoria e urbanizmit ka qenë shumë e përkushtuar me qenë logjistike dhe asgjë më shumë. Prandaj keni kërkuar informatën edhe ju kemi sjellë kështu nuk kemi informata me shume pasi është ky dizajn, por nëse dëshironi me shume shkoni te drejtoria e urbanizmit pasi që e ka dosjen komplet dhe po ashtu mund te hyni në web-faqen UN-Habitati edhe mundeni me marr ndonjë informacion me shume prej tyre, sa i përket seleksionimit dhe renditjes se studiove. Por nuk mundemi me u pajtue nga një njëri me përvojë siç është Fehmi Cena me hedhë dilema me fol me paqartësi dhe me u thirr në emër të qytetareve që janë të paqartë. Ata që dojnë me qenë te qartë deri ne fund sidomos ju Fehmi Cena por ne mundemi me ftue UN-Habitati edhe me ju tregua që te gjitha por nëse doni me shume mund te hyni webfaqe te tyre edhe ti shikoni dokumentet, pasi te gjitha janë transparente. Pra sikur te ishte projekt i joni atëherë keni te drejtë por ky projekt është menduar që me pas një rrugë ndërkombëtare te projektimit dhe nuk e pyes askënd sa i përket prioriteteve se a duhet me bo sivjet apo vitin e ardhshëm, bile po të mundja krejt sivjet i kisha bërë por kryetari i komunës është zgjedhur dhe ai e vlerëson se kur piqen kushtet sepse unë për këtë projekt flas prej vitit 2017 për sheshin qendror e sigurisht që kanë folur edhe te tjerët që gjithçka është normale dhe duhet me qenë krejt të kënaqur që janë pjekur kushtet për këtë punë dhe që kanë mbërri ndërkombëtaret me u involvue ne proces sepse ata involvohen edhe me fonde pastaj. Kështu që unë jam shumë i qartë dhe e di çka po kërkojë edhe drejtori i urbanizmit e din çka po lyp por nuk po kuptoj se çka po kërkon ti z. Cena dhe nuk e kuptova as Ali Zhuniqin deri ne fund, që për çdo informacion me te detajuar mund te shkoni dhe te kërkoni te ata. E thash edhe me herët se juria profesionale asnjë te komunës se Rahovecit nuk e ka dhe një e ka te qytetit te Rahovecit dashnor Kadiri që ka një cv të veten dhe ata munden me ju tregua për metodologjinë e vlerësimit. Po ashtu është një është Përparim Rama shqiptar që i ka studiot e arkitekturës ne Londer dhe krejt Kosova dhe shqiptaret krenohen për shkak te reputacionit që ka dhe tre të tjerë janë ndërkombëtar, kështu që unë po mendoj që nuk duhet me pas debat rreth kësaj teme.
**Fehmi Hoxha –** Kryetar duhet me pas debat, kështu që nuk pajtohem me ju që thoni nuk duhet me pas, sigurisht që informata është mirë që është sjellë mirëpo ky kuvend komunal është që vendos për hapësirat publikë dhe nuk po me pëlqen se si ju keni vërsulur z. Cena, sigurisht që ka të drejtë sepse është kuvendarë dhe duhet pasur parasysh se është seanca e fund vitit kështu që te gjithë kemi te drejtë pasi kemi marr mandatin prej qytetareve që kemi marr këto vota. Unë po flas në cilësinë e dizajnerit, mendimin tim po e jap dhe po me pëlqen projekti mirëpo po dua me pas ndonjë informatë se a keni ndonjë informatë se a keni ndonjë parallogari përafërsisht sa do të kushton ajo, së po me kthehet ky projekt se po me pëlqen e gjithashtu me ka pëlqyer edhe projekti ne mandatin e parë kur keni qenë kryetar, e këto rreth fontanës ka pasur plot fotografi dhe ide mirëpo asgjë nuk është bërë, kështu që mos është edhe ky projekt sikur ne kohë te fushatës se a do te realizohet apo po jetë vetëm për fushatë, pasi vërtet po kam qejf me u realizua kështu që keni mbështetjen time dhe te gjithëve që me u realizua. Mirëpo po frikohem që mos janë dhënë ato 75,000 euro edhe me mbet vetëm projekt i fushatës sikur ai projekti ne mandatin e parë që keni qenë. Kështu që te gjithë kemi te drejtë me fol dhe me shqyrtua këtë projekt, kështu që është seanca fund vitit dhe ne duhet me fol.
**Kryetari –** I nderuari z. Hoxha, nuk po them që duhet te bëhemi nervoz por duhet te tregojmë maturi sepse një proces është përmbyll pra një fazë dhe sigurisht që jam i vetëdijshëm se çka po flas, pasi nuk mund te ja ndaloj askujt se çfarë flet, por keni kërkuar informatë dhe e kemi sjellë. Por sa kushton ky projekt nuk e di dhe

me dit se sa kushton do te ju tregoj pasi nuk jam jotrasnparent. Por me i thanë një organizate ndërkombëtare siç i tha Fehmi Cena nuk është mirë për shkak se procesi ka qenë dhe ka filluar prej fillimit te vitit 2020 bile për mua është e dhimbshme se është vonuar kaq shumë, pasi ata i kanë procedurat e veta dhe krejt çdo gjë dhe çdo element që bazohet ne ligje të aplikueshme ne Republikën e Kosovës ne konkurse ndërkombëtare te projektimit prandaj edhe ka zgjatur pasi nuk është punë fushate sepse sikur te ishte fushate pasi jo rastësisht e thash se sot kalon buxheti ne lexim te dyte dhe ne kemi në kodin në Ministrinë e Ekonomisë e kemi shtie ne planifikim,pra për mua është e dhimbshme se pse nuk ka filluar sivjet, që unë te vetmen vërejtje të UN-Habitati e kam edhe te ky proces është te vonesa se pse duhet me zgjat gati 12 muaj një proces. Prandaj kur e di këtë mirë, nuk mundesh me i thanë UN-Habitatit që ka bo shmangie nga procesi që nuk ka aplikuar praktika te transparencës, te debatimit edhe marrjes se ideve të propozimeve dhe kur dalim tash tek juria, nuk mundemi me i thanë një jurie e cila është me kredibilitet. Prandaj thash se nuk jam specialist dhe vlerësimi ka ndodhur dhe nuk mundemi me u lëshuar tash ne debate se pse u zgjodh ky apo ai pasi unë krejt diçka tjetër kisha zgjedhur sikur te ishte e jona e komunës që direkt ne te ishim ata që vendosim por asnjë autoritet ne vendimmarrje nuk e kemi pasur ne. Kështu që ai reflekton identitetin e qytetit dhe gjithsesi se ata i kanë marr krejt parametrat dhe krejt ata që kanë aplikuar e kanë bo regjistrimin e gjendjes faktike ne terren pra nuk mundet me shpëtuar askush sepse ka shume madje edhe Rahovecit me fitua te drejtën për me u shpalle sepse marrin poenta ato studio projektuese e ndoshta edhe ne këtë projekt. Kështu që e dini mirë se çka po flas edhe jam brenda kornizave dhe brenda demokracisë kështu jemi ne fund vit dhe gjithçka jemi ne rregull dhe unë i kam pa shume te paarsyeshme disa veprime që eventualisht madje dikush ka tentuar imponua modelin e vet ne emër te qytetareve e ka vendos panon ne palestër sikur palestra sportive është pronë private e tij dhe janë detyruar me ndërhyje inspektorati dhe policia me largua atë. Unë nuk lejoj me pas veprime te cilat janë jo te arsyeshme dhe bien ndeshë me ligjin. Kështu që nuk kanë te drejtë me atakua një proces për shkak se nuk është zgjedhur projekti i dikujt. Pra janë 80 studio projektuese që kanë aplikuar nga 37 vende te botes dhe ne bazë të informatës zyrtare që e kom pa se janë 7 studio projektuese nga Rusia kështu që vlerësimin nuk e kemi bërë ne por te tjerët. Kështu që nëse dëshirojmë me debatua për diçka që nuk është vendimmarrja te na pasi është vendimmarrja te profesionistet me te mirë që kanë vlerësua si UN-Habitati pasi na nuk e kemi përcaktuar as jurinë dhe nuk jemi ne ata që duhet me than qe ky duhet apo nuk duhet dhe sikur ta kishim pasur këtë te drejt ndoshta kishim bo edhe propozimet tona. Mëzi qe kemi mbërri që duhet me qenë edhe një nga qyteti i Rahovecit si anëtar i jurisë, ata fillimisht janë pajtua ne parim por përzgjedhjen e kanë bo vetë. Projekti është ideor dhe është përzgjedh dhe deri te projekti kryesor sigurisht që duhet edhe 2 apo 3 muaj ndërsa deri te fillimi i procedurës se prokurimit për lidhje te kontratës nuk e di sa zgjat dhe sa kushton ne mund ta dimë vetëm kur te bëhet projekti kryesor. Kështu që te gjithë ata që marrin vesh rreth kësaj ne projektin ideor nuk mundesh me ditë se sa kushton. Kështu që ata me siguri i kanë paraparë edhe parkingjet edhe shenjat identitare te qytetit dhe sigurisht qe e din se është qytet i rrushit dhe kanë paraparë plot zgjidhje që natyrisht që kompania për hartimin e projektit kryesor duhet me marr ne konsiderate pasi që duhet me reflektua atë që është e dizajnuar ne projektin ideor. Pra kjo është e gjithë ajo qe desha me than dhe kur e ndien veten te keqkuptuar pasi nuk po flas me individë si me rastin e Fehmi Cenes por po flas me kuvendin e komunës se Fehmia është përgjegjës i një grupi politik dhe tash informata është aq sa është pasi nuk mundemi me dhanë me tepër se edhe nuk dimë pasi nuk kemi informacion dhe gjithashtu informata është ne gjuhen angleze pasi nuk jemi ne dizajnues te projektit dhe drejtoria e urbanizmit ende nuk ka marr përsipër dhe nuk ka mbërri ne pozicionin sa me zgjedh kompaninë për hartimin e projektit kryesor ne bazë te projektit ideor dhe duhet te i mirëkuptoni këto gjëra pasi është ne gjuhen angleze dhe ska informata me shume pasi që sikur te isha ne dijeni se sa kushton e ndiej për obligim që me ju tregua këtu ne kuvend por nuk e din as UN-Habitati dhe nuk e din as ata që e kanë bërë përzgjedhjen dhe sigurisht as ai që ka aplikua me këtë projekt sepse ka

shume elemente ne këtë dizajn që duhet me u reflektua ne projektin kryesor apo projektin për ekzekutim. Besoj që jam shume i qarte rreth kësaj dhe pse ju drejtova një njeriu që është me përvojë te madhe, për shkak se ska transparencë sa duhet dhe qytetaret ka paqartësi dhe  a janë planifikua parkingjet pastaj çështja e pronave dhe po ne këtë kuvend te komunës ne e kemi marr një vendim për me fillua procesin pasi pikërisht vendimi është marrë nga ju kuvendarë e pastaj ka fillua procesi i planifikimit i UN-Habitati, pra ne kemi paguar 75,000 euro dhe pa e miratuar ju buxhetin nuk kemi mundur me pague atë shume pasi është marrëveshje dhe ajo marrëveshje u ardhë ne kuvend. Pra jemi krejt dakord dhe nuk e bëj këtë për me polimizue dikush dhe nuk e bëj që me fye dikën, por vetëm te jemi te kujdesshëm sepse  jemi anëtar të kuvendit te komunës ose përfaqësojmë qytetaret  komunës. Pra është proces që ka marr jehone dhe vëmendje ndërkombëtare dhe ka pasur shume interesim dhe tash e tutje kemi hie në kapitullin tjetër dhe duhet me bo projektin kryesor dhe duhet me ditë sa është vlera dhe gjithashtu qa do të bëjmë me ato prona te kontestuara që janë dhe duhet me ditë edhe shumëçka tjetër dhe ne momentin që vjen projekti kryesor atëherë mund ta dimë pak me mirë. Dhe ne këtë proces vazhdojmë ne, pasi tash komuna ka autoritet.

**Fehmi Cena –** Në fakt kryetari na mori shumicën e kohës te diskutimit dhe tash nuk kemi faj, pasi ishte informatë dhe tash po del sa pak e zgjerojmë dhe po e bëjmë si debat. Unë nëse nuk e falënderova drejtorin që e prezantoj projektin atëherë kërkoj falje, por natyrisht prezantimi edhe këtu ka qenë i shkurt por materiali që na keni servue ka qenë për çdo lëvdatë dhe i qartë por megjithatë nuk është plotësisht i qartë për ne edhe për mua si qytetar dhe si kuvendarë. Kështu që tani po e bëj një vërejtje kolegiale por mënyra e diskutimit nuk po me pëlqen forma se si ju qaset diskutimit dhe nuk është hera e parë dhe nuk ka nevojë ne që ti drejtohemi dikujt pasi ne atë mënyrë po krijohet një bindje se po dëshironi me na pengua neve ne diskutimin e lirë që ne duhet ta kemi. Kjo është informatë por ne kuvendaret duhet ta kemi te drejtë me debatua edhe për informatën për shkak se dhe kemi kërkuar e sidomos për gjëra që nuk i kemi te qartë dhe dëshirojmë me i qartësua, pasi ju e thatë edhe vet krejt ne fund se a ka parkingje, se çka do te ndodhë me parkingje pastaj me fushën e sportit. Kështu që unë pa a shume ne atë mënyre e diskutova këtë çështje, që ne si kuvendarë te i kemi te gjitha te dhënat sepse ne prezantimin e projektit nuk i kemi te gjitha të dhënat dhe ne kemi takime me qytetare dhe ata na pyesin, kështu edhe ne kemi te drejtë me than se ka diçka paqartësi e pastaj ku do shtrohet paqartësia ne kuvend apo do te shtrohet nder qytetarë, pra sigurisht që se pari duhet të jetë këtu ne kuvend dhe kemi te drejtë me kërkuar këtë dhe kemi te drejtë te informohemi nder te paret sepse jemi përfaqësues te tyre. Dhe tash a është deshtë me kalue kjo përmes kuvendit, unë pikërisht kam menduar se është deshtë me kalue përmes kuvendit për arsye se ne informohemi saktësisht deri ku ka shkuar çështja. Ju folët sikur unë e kam fyer jurinë profesionale ndërkombëtare dhe isha kundër, por unë vetëm bëra pyetje se a është deshtë me qenë konkursi ndërkombëtar apo ka mundur me qenë edhe kombëtar. Pastaj juria ishte ndërkombëtare por projekti është këtu, kështu që projekti nuk është as i ndërkombëtarëve e as i jurisë por është lokal kombëtarë pra është i qytetit dhe unë jetoj ne këtë qytet dhe dua me ditë hollësisht se çka është ai projekt dhe çka përmban ai projekt. Nuk janë te gjitha çështjet e zgjidhura pasi ke prona private aty që funksionojnë, pastaj çka me fushën e futbollit pastaj me parkingje dhe a jeni ne gjendje ju me na tregua se çka me ato dy parkingje dhe nëse jeni ne gjendje atëherë unë do te jem i kënaqur pasi nuk jam kundër asaj por vetëm  me qartësua se a do te ketë nesër edhe shesh edhe parkingje.

**Kryetari –** Ne njihemi edhe nuk kemi nevojë me i mbajte leksion njeri tjetrit se cili kemi te drejtë pasi këtë e dimë dhe elementare për te gjithë, kështu që nuk e shtrova asnjëherë çështjen kështu, pasi çështja është te procesi dhe ju e thatë që e përmend stadiumin  dhe fort mirë e dini se stadiumi do te ndërtohet tek Epopeja e UÇK-së dhe kontrata me gjasë është nënshkruar ne Ministri  pasi unë kam nënshkruar marrëveshje me Kujtim Gashin ish ministrin e Kulturës dhe prape është çështja se pse po vonohen gjërat pasi janë projekte që i ka ministria për një stadium te Epopeja e UÇK-së që për lokacionin prape ky kuvend ka vendos, një stadium

është ne Ratkoc dhe një palestër sportive që i kemi projekte m ministrinë e Kulturës. Pra stadiumi do të përdoret për nevoja te sheshit qendror . Po ashtu ju thatë se çka do te bëhet me prona te kontestueshme, unë mendoj se edhe për ato ka zgjidhje, po ashtu thatë qe mungojnë elementet, e sigurisht që mungojnë plot elemente pasi që është projekt ideor dhe sigurisht që do te ketë edhe parkingje pastaj a është menduar edhe për dy parkingjet ekzistuese. Pra te gjitha këto i kanë marr parasysh sepse ne detyre projektuese që u publikua, pastaj trajtimi i ujërave t zeza, te bardhe pastaj i ujerave që po e vërshojnë qytetin, pra ata që e kanë bërë përzgjedhjen e projektit krejt i kanë marr n konsideratë. Kështu që projekti është vendor por planifikimi përmes një procesi që janë përfshije një organizatë ndërkombëtare si UN-Habitati që është një organizatë e specializuar e OKB-së me qendër në Nairobi e që është e njohur n fushën e planifikimit. Pastaj a ka kuadro komuna e Rahovecit për me bo, unë mendoj që ndoshta ka por vlerësimi që duhet me ju nënshtrua një procesi ma ndryshe për shkak se është një zonë ma e madhe pastaj për shkak se duhet me u trajtua njëherë e përgjithmonë dhe nuk është qe nuk kemi pasur besim tek njerëzit vendor se për mua kjo nuk ekziston pasi edhe punët e shteteve tjera ju kisha dhënë që me punuar shqiptarët por tash është menduar që ky dizajnim te bëhet nga njerëzit që kanë ekspertizë dhe që kanë kredibilitet, kështu që vlerësimi i UN-Habitatit ka qenë që ma mirë me qenë konkurs ndërkombëtar i projektimit. Kështu që ka ndodhur, pasi informatat deri ne detaje nuk i kemi sepse ende jemi ne proces, pasi tash fillon hartimi i projektit kryesor duke reflektuar tërësisht sepse ne nuk mundemi me rrezikua sepse nuk guxojmë dhe nuk kemi te drejtë me rrezikua, kjo edhe ka shkuar përmes kuvendit te komunës sepse informata i sillet kuvendit te komunës. Për ndryshe çdo informacion që ka te bëj me projekte dhe me këtë fazë ku jemi te procesit po i vjen kuvendit të komunës, pasi pa kuvendin e komunës nuk është nisur kjo e as me u financua planifikimi dhe as me u bo një projekt pa e ditë ne cilin territor po shtrihet. Pra te gjitha janë marr me vendim te kuvendit te komunës edhe e keni votua bashke me anëtaret e tjerë të kuvendit te komunës Kështu që nuk keni votua për projektin por keni votua për kodin për shpalljen me interes te përgjithshëm te parcelave që janë ne interes te shtrirjes se sheshit qendror. Kështu që kjo është vendim i kuvendit te komunës se ka do te shtrihet sheshi për te gjitha parcelat dhe ju kujtohet mirë se kemi diskutuar gjatë edhe për hotel parkun që ka kontratë dhe shume te tjera, në këtë përbërje te kuvendit te komunës ne vitin 2019 është marrë vendim dhe mund ta gjej edhe me datë se kur është marr vendimi. Nuk po anashkalohet komuna por ne vlerësime dhe ne planifikime normalisht ka qenë më shumë në logjistike se sa vendimmarrëse aspak ne përzgjedhje.

**Kryesuesi –** Faleminderit kryetar për sqarimin, të nderuar kuvendarë kalojmë në pikën shtesë për shfuqizimin e vendimit Nr. 132/20 i datës 30.11.2020 për ndërrim destinim te tokës bujqësore ne tokë ndërtimore. Të nderuar kolegë kuvendarë jemi te detyruar pasi është kthyer nga MAPL-ja këtë vendim dhe jemi te obliguar për ta shfuqizuar. E qesim ne votim pikën shtesë. Konstatoj se unanimisht aprovohet shfuqizimi i vendimit. Të nderuar kolegë, ju kisha falënderuar për ditën e sodit për durimin që keni treguar, megjithatë ne jemi kuvendi dhe duhet te punojmë edhe nëpër këso sfida dhe gjithashtu një falënderim për kryetarin për punën dhe bashkëpunimin që kemi pasur gjate gjithë vitit. Gjithashtu shfrytëzoj rastin me ju urua edhe festën e vitit të ri te gjithëve dhe ti kthehemi normalitetit për vitin tjetër.

**Mbledhja përfundoj 13:00**

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi:** | **K R Y E S U E S I** |
| __________________ | |
| **Agim Hoti** | __________________ |
| | **Afrim Dina** |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

**01 Nr. 01/21**
**Rahovec, 21.01.2021**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më **29 janar 2021** (**e premte**) me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020;
4. Raporti vjetor financiar për vitin 2020;
5. Informatë rreth punës së KKSB-së për gjashtë (6) mbledhjet e vitit 2020;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P – 71510066 – 00386-1;
8. Raporti i punës i Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2020.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Afrim Dina**

KOMUNA RAHOVEC

# RAPORT VJETOR I PUNËS

**JANAR- DHJETOR 2020**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1631 Nr. i faq/Br.str/No.pg 164
Data/Datum/Date 31 / 12 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

# RAPORT VJETOR I PUNËS

## TABELA E PËRMBAJTJES


KRYETARI I KOMUNËS....3

Zyra Ligjore....9

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit....10

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura....11

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun....13

Zyra e Auditimit të Brendshëm....14

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim....15

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut....16

Zyra për Integrime Evropiane....16

Zyra për Barazi Gjinore....17

SEKTORI PËR LEKTORIM....17

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË....18

DREJTORIA PËR BUXHET dhe financa....21

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE....24

DREJTORIA PËR ARSIM....27

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM....33

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT....36

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE....39

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL....43

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË....53

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT....55

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE....61

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM....65

PËRFUNDIM....67

# RAPORT VJETOR I PUNËS

## KRYETARI I KOMUNËS

### FJALA HYRËSE

*Qytetarë të komunës së Rahovecit,*

*Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2020, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – dhjetor 2020.*

*Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.*

*Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të Komunës dhe ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale.*

*Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale. Raporti gjashtëmujor i punës është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, përkushtimit, angazhimit dhe vendosmërisë së treguar, në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Rahovecit.*

# RAPORT VJETOR I PUNËS

## SYNIMET POLITIKE NË QEVERISJE:

- Qeverisje të mirë, të përgjegjshme, të qëndrueshme, të hapur me qytetarët, demokratike dhe të suksesshme;
- Qeverisje me plane dhe shikim kah e ardhmja;
- Qeverisje që gjen zgjidhje, sado sfiduese dhe komplekse janë problemet;
- Qeverisje me plane të qarta dhe ambicioze;
- Qeverisje që përballet me guxim dhe kryen punë me dinamikë të lartë e nuk vonohet;
- Qeverisje që afirmon vlerat kombëtare, historike, të trashëgimisë, të kulturës dhe vlerat e tjera;
- Qeverisje energjike që mobilizon resurse dhe përfshin në veprime investuese e zhvillimore punën në partneritet;
- Qeverisje e cila vlerëson, motivon dhe mbështet talentin dhe të arriturat e qytetarëve tanë të të gjitha shtresave;
- Qeverisje ndërtuese që promovon gjithëpërfshirjen në vendimmarrje të forcave me ndikim në shoqëri, si: forcat politike, Kuvendin Komunal, bashkësitë fetare, shoqërinë civile, bizneset, individët, të rinjtë dhe grupet e ndryshme të interesit;
- Qeverisje që mobilizon qytetarët të marrin rolin që ju takon në të gjitha çështjet që janë në interesin e tyre;
- Qeverisje për të gjithë, pa dallim.

## PRIORITETET TONA KRYESORE PËR RAHOVECIN VAZHDOJNË TË JENË:

- Rahoveci një vend i dëshirueshëm për të jetuar, për të punuar dhe për të mbajtur familjen;
- Të përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve, në rritjen e nivelit të kënaqshmërisë së qytetarëve me ofrimin e shërbimeve dhe informim publik cilësor;
- Komunë me perfomancë të mirë dhe qeverisje demokratike;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne;
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë;
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit;
- Realizim i planit të të hyrave komunale;
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të rejat;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Rritja e rolit dhe shtimi i aktiviteteve të inspektoratit;
- Edukim dinjitoz i brezave të rinj duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;

- Ofrimi i mjediseve për rekreacion, ngjarjeve kulturore dhe programe për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve të të gjitha moshave, me theks të veçantë në mirëqenien e rinisë;
- Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit të sigurtë dhe efikas të qarkullimit në trafik;
- Shtimi dhe mirëmbajtja e parqeve, hapësirave publike, objekteve rekreative, rrugëve, ndërtesave dhe infrastrukturës tjetër me qëllim të arritjes së standardeve të larta të dukjes dhe gjendjes së tyre;
- Vizita sistematike shëndetësore nëpër të gjitha shkollat;
- Nxitje të investimeve dhe projekteve në turizëm;
- Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë e biciklistë;
- Rritje e përkrahjes për bujqësinë dhe rritje e përkrahjes direkte për fermerët;
- Projekte për kullimin e tokave bujqësore;
- Rritje e cilësisë dhe investime në arsim;
- Bursa për studentë;
- Investime në nyjat sanitare dhe meremetim të shkollave;
- Vazhdimi i Ndërtimit të shkollave dhe çerdheve të reja;
- Efiçienca e energjisë në objektet shkollore dhe në objektet e tjera publike;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm;

## PUNË KONKRETE PËR RAHOVECIN:

- Komuna e Rahovecit u rendit e para nga 38 komunat e Kosovës nga Instituti Demokratik i Kosovës KDI për transparencë dhe llogaridhënie komunale, në kuadër të Transparometrit komunal, i cili u zhvillua për vitin 2019 në të gjitha komunat e Kosovës.
- Hartimi i planit vjetor të prokurimit dhe aprovimi i tij, hartimi i planit vjetor të punës së Kryetarit dhe qeverisë komunale;
- Nxjerrje e urdhëresave, vendimeve dhe akteve të shumta në interes të komunës dhe të qytetarëve tanë;
- Pas rreshjeve të borës kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit menjëherë kanë dalur në terren për pastrim të rrugëve, falë reagimit të shpejtë të kompanive nuk ka pasur vështirësi dhe pengesa në qarkullim të lirë të automjeteve;
- Është bërë përurimi i objektit të ri të çerdhes "Tulipanët" në qytetin e Rahovecit, në proces të ndërtimit kemi 3 çerdhe të tjera, në Ratkoc, Krushë të Madhe dhe Xërxë. Punimet në këto çerdhe po vijojnë sipas dinamikës së zhvillimit të projektit dhe ato do të kryhen sipas afatit të paraparë.
- Është bërë ndërtimi QKMF-së dhe Emergjencës në Rahovec, një objekt tejet modern i cili është funksionalizuar në festat e nëntorit dhe kap vlerën prej: 863,350.26 euro;
- Ndërtuam QMF-në në Çiflak, objekti tashmë është funksional dhe kap vlerën prej: 91.102,38 euro;

- Janë duke vazhduar punimet në ndërtimn e QMF-së, në Opterushë vlera e kontratës 81.543,22 projekti pritet të perfundojë në muajin maj të vitit 2021;
- Kemi bërë analizimin e kontratave dhe përmbushjen e tyre në projektet si: trotuare, rrugë, rreth-rrotullime, hapësira publike, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, të martirëve, të civilëve, poashtu të shesheve, pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbëruara etj;
- Komuna e Rahovecit momentalisht është duke investuar në trajtimin e shtretërve të lumenjeve në Krushë të Madhe, i financuar nga Komuna. Në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogel dhe Nagac, financuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Trajtimi i përrenjve në fshatrat Opterushë, Pataqan i Poshtëm, Malësi e Vogël dhe Polluzhë, bashkëfinancim me grantin e performancës dhe Komunës së Rahovecit. Probleme me shtretër të përroskave kemi në fshatrat Dejnë, Ratkoc, Celinë, Sapniq, Gexhë, nje përroskë e vogël ne Brestoc, pjesën e poshtë te lumit Duhllo ne Rahovec e përroska tjera të vogla, të cilat do t'i trajtojmë me një kontratë tjetër.
- Kemi përmbyllur projektin e pompave të ujit në fshatin Pastasel, uji është testuar dhe ka ardhur deri në rezervuarin shpërndarës, i është dërguar kërkesa KRU "Gjakova" për pranimin e punëve dhe për mirëmbajtje, ku dhe kemi përuruar së bashku me zyrtarë të ujësjellësit ujin e pijshëm;
- Pasi kanë përfunduar të gjitha procedurat rreth projektit të "Përkrahjes së fermerëve me mekanizëm bujqësor", në muajin shtator ka filluar edhe shpëndarja e tyre. Paraprakisht kemi lidhur kontrata me operatorë të ndyshëm për furnizim me pajisje, poashtu janë ftuar fermerët që të lidhin kontratë me komunën dhe janë kryer edhe participimet e fermerëve, duke u bazuar në marrëveshjen me komunën. Nga 990 fermerë të cilët kanë aplikuar gjatë kësaj thirrje, në listën e përfituesve kanë qenë gjithsej 789 përfitues.
- Po ashtu gjatë muajit Shtator 2020 për herë të parë është hapur thirrja për Komore ftohëse dhe Laktofriz të cilat shërbejnë për ruajtjen e produkteve bujqësore, ku nga 16 aplikacione të cilët kanë aplikuar në këtë thirrje për Komore Ftohëse V=25$m^3$ si dhe Komore Ftohëse V=40$m^3$, të gjithë janë përfitues. Gjithashtu edhe nga 39 aplikacione të cilët kanë aplikuar për Laktofriz 300L si dhe Laktofriz 500L, të gjithë janë përfitues. Sektorët të cilët do të përkrahen përmes kësaj thirrjeje janë: Pemëtaria; Perimekultura; si dhe Blegtoria.
- Dixhitalizimi i Radiologjisë, është furnizuar QKMF-ja me pajisje moderne të EHO-s, për Radiologji, Gjineokologji, dhe Urologji, po ashtu deri në mars të vitit 2021 do të furnizohemi edhe me Mamograf për diagnostifikim të hershëm të kancerit të gjirit, dhe Ortopan për nevojat e stomatologjisë.
- Projektimi i Sheshit Qendror të Qytetit – është shpallë konkursi ndërkombëtar pas një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës me mbështetje teknike nga UN-Habitati. Konkursi është shpallur më 1 shtator dhe ka qenë i hapur deri më 16 nëntor 2020. Këtij konkursi i ka paraprirë një analizë e detajuar e zonës ku planifikohet të ndërtohet me të gjitha shpjegimet specifike të qytetit te Rahovecit. Konkursi është publikuar në shumë media të njohura botërore të specializuara të arkitekturës dhe është përshëndetë nga shumë shoqata të arkitektëve vendor dhe të huaj. kemi edhe punimin fitues në Konkursin Ndërkombëtar për Dizajnimin e Sheshit Qendror të Rahovecit. Arkitektët Thomas Boerendonk nga Holanda, Daniel Arce Chu nga Uruguaji dhe Nguyen Duy Minh

nga Vietnami, i kanë dhënë Rahovecit një dizajn ikonik dhe shumëfunksional ashtu siç e kërkuan qytetarët e komunës sonë.

- Sikurse vitin e kaluar, kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu leje e veçantë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra. E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces.
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, plan mjedisor që është hartuar për herë të parë në Komunën e Rahovecit, pasi është dalë në shqyrtim publik me lejen e Kuvendit të Komunës së Rahovecit është miratuar në seancën e marsit në Kuvendin Komunal Rahovec
- Kanë vazhduar aktivitetet dhe takimet me kompanitë konsulente për hartimin e Planit Zhvillimor dhe Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit. Plani Zhvillimor është në prag të finalizimit, jemi ne pritje te marrjes se pëlqimit nga Ministria Ekonomisë dhe Ambientit dhe të vazhdohet me procedurën e shqyrtimit publik dhe pastaj për aprovim në Kuvend, ndërkaq rreth hartimit të Hartës Zonale është pranuar drafti i parë i gjendjes ekzistuese dhe puna është duke vazhduar sipas planit të paraqitur në kontratë, një pjese e konsiderueshme e punës është përfunduar.
- Projekti i ndërtimit të tetë parqeve në Komunën e Rahovecit ka vazhduar edhe në këtë periudhë raportuese, Komuna e Rahovecit ka ndërtuar parqe në Gexhë, Malësi të Vogël, Pataqan të Poshtëm, Dobidol, Sapniq, Celinë, Zaqisht dhe Ratkoc. Do të ndërtohen edhe në shumë vendbanime të tjera në vitin 2021.
- Ka përfunduar projekti i Kompleksit të Dëshmorëve në Gradish/Xërxe, kushtuar dëshmorëve të komunës së Rahovecit.
- Ndërtimi i kullës prej guri per heronjtë Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi– Mici te vendi i rënies mbi fshatin Operushë, punimet janë afër përfundimit.
- Ka përfunduar ndërtimi i lapidarit "Altari i Lirisë", kushtuar martirëve të fshatit Guri i Kuq. Lapidari është zbuluar më 14 qershor, në ditën e Çlirimit të Rahovecit.
- Punët kanë vazhduar në projektin e renovimit të shkollave (Lot1), përkatësisht në renovimin nyjeve sanitare në shkollën "Rilindja" në Ciflak dhe ka filluar riparimi i nyjeve sanitare në objektin e shkollës në Gexhë. Kanë vazhduar punimet edhe në shkollën "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël/Brestoc, në shkollën "Haki Stërmilli" në Retijë e poashtu, po punohet edhe në ndërtimin e shkollës "Liria" në Fortesë.
- Kanë përfunduar punimet në projektin e renovimit të dy shkollave (Lot2), përkatësisht në renovimin e dyshemeve të klasave dhe nyjeve sanitare në objektin e shkollës "Gëzim Hamza-Piktori" dhe në shkollën "Isa Boletini". Ka përfunduar puna në instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e paraleles së ndarë të shkollës "Vëllezërit Frashëri" në Senoc.

- Është lidhur kontrata për mbjelljen e mbi 10 mijë drunjve ne komunën e Rahovecit. Deri më tani nga kjo kontratë janë mbjellë rreth 7000 drunj, sipas kontratës i kemi të parapara edhe 7000 të tjerë, po ashtu do të lidhim edhe një kontratë gjatë vitit 2021 për t'i mbjellë 20.000 drunj, ashtu siç ka qenë zotim elektoral. Drunjtë janë mbjellur në qytetin e Rahovecit, në hyrje-dalje të Rahovecit, në Drenoc, Polluzhë, Kramovik, Guri i Kuq, Mrasor, çiflak, Dejnë, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhë, Xërxe, Fortesë, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Brestoc, Opterushë dhe Zaqisht. Drunjtë do te mbillen në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Ata drunj që kanë dështuar do të zëvendësohen.
- Po vazhdon ndërtimi i shtëpisë për të moshuar për qëndrim ditor mbi qytetin e Rahovecit, tek "Epopeja e UÇK-së", ku Komuna e Rahovecit do t'i jep jetë si investitor me vlerë të kontratës: 89,979.00 euro. Në këtë qendër parashihet të ketë një sallë kolektive për qëndrim dhe aktivitete, dhoma për të pushuar si dhe teracë, projekti tashmë është në fazën përfundimtare;
- Janë përfunduar trotuaret në disa vendbanime të komunës sonë, Rahovec, Drenoc, Malësi e Vogël, Ratkoc, Opterushë, Celinë dhe Sapniq.
- Kemi përfunduar me krijimin e tri shtigjeve të ecjes në fshatrat Dejnë, Drenoc si dhe në pikën turistike Zhdrellë, punimet kanë përfunduar edhe në fshatin Krushë e Madhe për ndërtimin e projektit të Shtegut të Ecjes, "LULET E MARSIT". Gjatë vitit 2020 kemi filluar edhe me ndërtimin e shtegut të ecjes në Gradish ku është bërë hapja e trasesë, ky projekt pritet të përfundojë në fillim të vitit 2021.
- Janë duke vazhduar punimet në projektin: Renovimi i Stacionit të autobusëve dhe vendosja e kabinave inovative, është projekt që kap vlerën prej 176,710.50 euro, dhe tashmë stacioni ka marrë pamje të re, ndërkaq për trajtimin e pjesës së dytë prapa stacionit, punimet pritet të vazhdojnë në vitin 2021.
- Kemi bërë rregullimin dhe rrethimin e fushës së sportit në Ratkoc
- Riparimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Ratkoc
- Jemi në përfundim të ndërtimit të infrastrukturës për aktivitete kulturore në fshatin Dejnë
- "Investime në infrastrukturën kulturore dhe kënde të lojërave për fëmijë", në kuadër të këtij projekti në lagjen "Potok" të Rahovecit është përuruar një park i ri rekreativ për të gjitha grupmoshat
- Ka vazhduar ndërtimi i serave të pa përfunduara pas shpalljes së rezultateve nga komisioni, duke përmbushur kontratën aktive në kuadër të kësaj kontrate janë ndërtuar 15 serra 3 ari dhe 11 sera 5 ari.
- Në kuadër të investimeve kapitale në përmirësim të infrastrukturës bujqësore kryesisht është investuar ne ndërtimin e kanaleve të kullimit.
- Për herë të parë Komuna e Rahovecit ka filluar të i përkrah fermerët blegtor me ndërtimin e stallave. Gjatë vitit 2019 në thirrjen për aplikim ishin 10 përfitues të stallave për lopë qumështore si dhe 5 përfitues të shtallave për shpezëtari. Në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë, komuna e Rahovecit është duke ndërtuar 15 stalla për fermerët e komunës sonë.

# ZYRA LIGJORE

## FUSHËVEPRIMTARIA E ZYRËS LIGJORE

Zyra Ligjore ofron ndihmë juridike, shërbime dhe këshillime për drejtori, zyra dhe sektorë, institucionet dhe ndërmarrjet komunale, shqyrton të gjitha projekt-rregulloret që propozuesit ia dërgojnë për miratim komiteteve kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës, harton (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale dhe shqyrton propozimet e rregulloreve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit të Komunës për miratim, përgatit dhe harton rregulloret dhe urdhëresat administrative që i lëshon Kryetari i Komunës, merr pjesë në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara, merr pjesë në të gjitha seancat e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të formuara nga Kuvendi i Komunës, Zyra si strukturë organizative kryen edhe punë të tjera që i caktohen me ligj, Statutin e Komunës dhe rregulloret e tjera në fuqi.

Objektivat e arritura: janar- dhjetor 2020

| | |
|---|---|
| Rregullore | 3 |
| Plotësim dhe Ndryshim i Rregulloreve | 0 |
| Vendime për Kryetarin | 562 |
| Vendime për Kuvend | 71 |
| Urdhëresa | 71 |
| Autorizime | 13 |
| Kërkesa | 16 |
| Opinione Ligjore | 1 |
| Marrëveshje | 6 |
| Propozime për Kuvend | 24 |
| Akte përcjellëse | 69 |
| Kontrata | 12 |
| Konsultime | permanente |
| Përgjigje në kërkesë | 57 |
| Njoftime | 4 |
| Deklarata | 2 |
| Puna në Komisione | 19 |
| Totali i akteve të hartuara për periudhën Janar-Dhjetor 2020 nga Sektori Ligjor është: | 930 |

# ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE - NJËSIA E PERSONELIT

**Rekrutimet**

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 2 konkurse, për angazhim të stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, janë pranuar në punë 28 punëtor me MVSH, për kohëzgjatje më pak se 6 muaj.

**Pushimet vjetore**

Një pjesë e punonjësve të Administratës Komunale në Rahovec nuk kanë pasur mundësi të shfrytëzojnë pushimin vjetor për vitin 2020, si pasojë e pandemisë COVID-19.

**Lëshimi i akteve administrative**

Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 28 Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për punëtorët e rinj, poashtu, janë lëshuar 65 shkresa të ndryshme administrative.

**Tabelat statistikore**

Të dhënat statistikore të personelit, Njësia e personeliti i procedon drejtpërdrejtë në programin elektronik SIMBNJ, sipas kërkesës së MAP/DASHC-së, që bëhet rregullisht. Njësia e personelit të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

**Komisioni Disiplinor**

Në Komisionin Disciplinor nuk ka pasur asnjë lëndë disiplinore.

**Vijueshmëria e punëtorëve në punë**

Funksionon Sistemi i Mbikëqyrjes së Vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP, u janë dërguar drejtorive raportet e vijueshmërisë së punëtorëve për çdo muaj: janar,shkurt dhe mars 2020.

**Plani individual i personelit**

Njësia e personelit ka hartuar Planin Individual të Personelit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit SIMBNJ.

**Administrimi i programeve elektronike**

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si në vijim:

- Menaxhon me programin elektronik SIMBNJ që dmth. Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punë të punëtorëve, pra, programin SMVP.
- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED që në nivel shtetëror është kompetent ASHI- Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP

# ZYRA PËR PËRFAQËSIM LIGJOR - AVOKATURA

Zyra për Përfaqësime Ligjore (ZPL) e Komunës së Rahovecit kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikës së Avokaturës Publike Komunale dhe Ligjit për Avokaturën Shtetërore.
Pasqyra tabelare (si më poshtë) për të gjithë regjistrat, paraqet lëndë në punë, të pranuara, të kryera, të pakryera dhe lëndë të mbetura si dhe pasqyra për aktivitetet e ndërmarra.

**LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2020:**

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

| | Sipas regjistrave të ZPL | Civile | Përmbarimore | Proc.Administrativ e konflikt i Administrativ | CN Ndryshme | Proc.At_hezionit | Gjobat Mandatore | Avokatura | Gjithsej punë të kryera: |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lëndë të pa zgjidhura-të bartura | 846 | 82 | 5 | 30 | 14 | 0 | 19 | 996 |
| 2 | Lëndë të pranuara | 15 | 4 | 4 | 1 | 0 | 0 | 5 | 29 |
| 3 | Të gjitha lëndë në punë | 861 | 86 | 9 | 31 | 14 | 0 | 24 | 1025 |
| 4 | Lëndë të zgjidhura | 8 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 17 | 28 |
| 5 | Lëndë të mbetura | 835 | 83 | 9 | 31 | 14 | 0 | 7 | 979 |

**PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE:**

| Sipas regjistrave të ZPL | Civile | Përmbarimore | Konfliktet Administrativ | Civile të ndryshme | Penale at-hezionit | Ndryshme Avokatura | Gjithsej: |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TË PRANUARA: | | | | | | | |
| Vendimet e shk.I-rë | 24 | 1 | 0 | 0 | 0 | | 25 |
| Vendimet e shk.II-të | 1 | 1 | 0 | 1 | 0 | 1 | 2 |
| Vendimet e shk.III-të | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 2 |
| Aktgjykim+Aktvendim DHPGJS | 3 | | | | | | 3 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Urdhër Përmbarimor | | 2 | | | | | 2 |
| Aktvendim për 180 ditë | 12 | | | | | | 12 |
| Padi me prova | 13 | | 0 | 0 | | | 13 |
| Aktvendim për përgjigje në padi | 8 | | 0 | 0 | | | 8 |
| Përgjigje në ankesë civile | 2 | | 0 | 1 | | | 3 |
| Përgjigje në ankesë përmbarimore | | 0 | | | | | 0 |
| Përgjigje në prapësim | | 0 | | | | | 0 |
| Përgjigje në revizion | 0 | | | | | | 0 |
| Precizimi i padisë të paditësit | 3 | | | | | | 3 |
| Ankesë civile e paditësit | 1 | | 1 | | | | 1 |
| Ankesë përmbarimore e paditësit | | 1 | | | | | 1 |
| Ekspertizat | 1 | | | | | | 1 |
| Parashtresat tjera të pranuara | 4 | 0 | | | | | 4 |
| Gjithsej shkresat e pranuara | 75 | 6 | 1 | 2 | 0 | 1 | 80 |
| TË DËRGUARA: | | | | | | | |
| Ankesat | 6 | 1 | 0 | 1 | | | 8 |
| Përgjigje në ankesë | 0 | | 0 | | | | 0 |
| Përgjigje në Padi | 4 | | 0 | | | | 4 |
| Mbrojtje në Padi DHP GJS | 0 | | | | | | 0 |
| Revizion | 0 | | | | | | 0 |
| Përgjigje në revizion | 0 | | 0 | | | | 0 |
| Propozim për Mbrojtjen e Ligjshmërisë | 0 | | 0 | | | | 0 |
| Përgjigje në mbrojtje të Ligjshmërisë | 0 | | | | | | 0 |
| Prapësimet | | 2 | | | | | 2 |
| Ushtrimi i padisë | 0 | | 0 | | | | 0 |
| Ushtrimi i propozimit për përmbarim | | 8 | | | | | 8 |
| Parashtresat tjera të dërguara | 0 | 0 | 0 | | | 8 | 9 |
| Parashtresat dërguar drejtorive | 8 | 5 | 1 | | | | 14 |
| Gjithsej shkresat e dërguara | 15 | 16 | 1 | 1 | 0 | 8 | 41 |

Të gjitha shkresat e pranuara janë sistemuar nëpër lëndë përkatëse dhe është vepruar në interes të Komunës varësisht nga rasti. Vendimet e pranuara gjyqësore të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë pas analizimit të tyre, ato të cilat kanë qenë në dëm të Komunës janë kontestuar në shkallë tjetër gjyqësore.

<u>**Seancat e caktuara nga kontestet civile, përmbarimore, etj. nga gjykatat për periudhën raportuese.**</u>

Për të gjitha lëndët aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

| Seancat gjyqësore gjatë vitit 2019 | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr.i seancave të mbajtura | 14 | 16 | 11 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 41 |
| Sipas kontesteve | | | | | | | | | | | | | |
| Civile | 40 | | | | | | | | | | | | |
| Përmbarimore | 0 | | | | | | | | | | | | |
| Konflikte Administrative | 0 | | | | | | | | | | | | |
| Civile Ndryshme | 1 | | | | | | | | | | | | |
| Proc.At_hezionit | 0 | | | | | | | | | | | | |
| | 41 | | | | | | | | | | | | |

## ZYRA PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në Komunën e Rahovecit, është angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.
Lajmet, njoftimet dhe dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me Zyrën e Kryetarit, Kryesuesit dhe drejtorive komunale, janë publikuar në ueb-faqe dhe të njëjtat janë dërguar për publikim në portalet locale, gjithashtu edhe në ato nacionale, është përgatitur plani për dokumentet komunale që do të kalojnë procedurat e debateve dhe konsultimeve publike, i njëjti është publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës, poashtu është përgatitur regjistri për evidencën e kërkesave të pranuara dhe përgjigjeve të dhëna për Qasje në Dokumentet Publike të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në ligin për QDP Nr. 06L-081. Janë përgatitur 291 lajme, 111 njoftime, 2 ftesa dhe 14 thirrje.
Poashtu, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun ka përcjellur të gjitha seancat e Kuvendit Komunal, për të cilat me kohë janë njoftuar edhe gazetarët, gjithashtu, ka përcjellur edhe të gjitha mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë publikuar vendimet e nënshkruara të kryetarit në uebfaqe zyrtare. Në vazhdimësi vendimet e nënshkruara nga Kryetari janë dërguar te zyrtari përgjegjës për pranimin e vendimeve në MAPL.

# RAPORT VJETOR I PUNËS

Gjatë kësaj periudhe raportuese është përgatitur plani për dokumentet komunale që do të kalojnë procedurat e debateve dhe konsultimeve publike, i njëjti është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës.
Është përgatitur regjistri për evidence e kërkesave të pranuara dhe përgjigjeve të dhëna për Qasje në Dokumentet Publike të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në ligin për QDP Nr. 06L-081, në fund të vitit apo nëse kërkohet nga institucionet që na monitorojnë, publikimi i këtij regjistri me të gjitha detajet do të publikohet në uebfaqe e komunës, por që ky dokument sigurisht që do të publikohet në fund të vitit 2020, një dokument i tillë është duke u bërë për herë të parë, pasi që në të kaluarën është publikuar raporti vjetor për QDP me informata të shkurtëra.
Gjatë muajve janar- dhjetor 2020 janë publikuar: aktivitete-dokumente, detajet mund t'i shihni në tabelën e mëposhtme:

| Muajt | Lajme | Njoftime | Ftesa | Thirrje | Konkurse | Vendime | Ankande | Debate | QDP | Nr.i aktivitetve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 24 | 10 | 0 | 1 | 1 | 19 | 0 | 1 | 2 | 58 |
| Shkurt | 17 | 5 | 0 | 0 | 6 | 21 | 0 | 1 | 0 | 50 |
| Mars | 44 | 21 | 0 | 1 | 0 | 9 | 0 | 0 | 1 | 76 |
| Prill | 50 | 17 | 0 | 0 | 16 | 1 | 0 | 0 | 0 | 84 |
| Maj | 24 | 5 | 0 | 2 | 49 | 1 | 0 | 1 | 1 | 83 |
| Qershor | 9 | 4 | 1 | 2 | 39 | 0 | 0 | 1 | 0 | 56 |
| Korrik | 29 | 13 | 0 | 1 | 42 | 0 | 1 | 16 | 0 | 102 |
| Gusht | 9 | 4 | 2 | 1 | 42 | 5 | 2 | 0 | 2 | 62 |
| Shtator | 15 | 4 | 0 | 1 | 66 | 3 | 1 | 0 | 3 | 93 |
| Tetor | 16 | 6 | 1 | 4 | 75 | 1 | 0 | 0 | 1 | 103 |
| Nëntor | 30 | 5 | 1 | 0 | 96 | 5 | 0 | 0 | 2 | 139 |
| Dhjetor | 19 | 7 | 0 | 0 | 36 | 2 | 0 | 4 | 2 | 70 |
| TOTAL | | | | | | | | | | 1087 |

## ZYRA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në kuadër të kësaj periudhe raportuese, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të Punës për vitin 2020, i cili ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit. Ndërsa, bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën 01.01.20 deri më datë: 24.12. 2020, ka arritur ti kryej 9 (nëntë) auditime, auditimi i 10 (dhjetë) është ende në proces, që përfundon më datë: 30.12.2020.

Aktivitetet në periudhën: janar- dhjetor

- Në muajin janar, angazhimet tona kryesisht kanë qenë në verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm të dhëna në auditimet e kaluara, si dhe përgatitja e raportit të gjashtëmujorit të dytë dhe raportin vjetor të NJAB-së për vitin 2019.
- Në muajin shkurt është bërë verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në vitin 2019.
- Raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2019 i janë dorëzuar Njësisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komisionit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Si aktivitete të tjera mund të ceken edhe ofrimi i ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha drejtoritë komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në implementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke e krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuara, ashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e inplementimit të rekomandimeve.

***Vlerësimi përmbyllës: Në këtë periudhë (janar-dhjetor), NJAB-ja ka arritur objektivat e planifikuara në bazë të Planit Vjetor.***

# ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

**Aktivitetet në periudhën: janar-dhjetor**

- Në kuadër të koordinimit dhe implementimit të aktiviteteve në bazë të planit vjetor të ZKKK-së, janë realizuar 24 takime të rregullta me stafin e ZKK-së;
- Me qëllim të verifikimit të kërkesave për kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur jashtë territorit të Kosovës dhe Komunës së Rahvoecit, ZKKK-ja në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe IOM ka realizuar vizitë zyrtare në Serbi, në kuadër të vizitës "SHIKO-VEZHGO";
- Janë shqyrtuar mbi 12 kërkesa për kthim të familjeve nga Serbia, 8 prej tyre janë aprovuar unanimisht dhe 4 të tjera janë shtyer për ri-shqyrtim në mungesë të kompletimit të të gjitha dokumentacioneve, në bazë të rregullores në fuqi;
- Në kuadër të projektit "PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË KOMUNËN E RAHOVECIT" kanë përfunduar punimet e rrugës në fshatin Xërxë dhe fshatin Çifllak, në kubëzimin e venbanimeve të komuniteteve;
- ZKKK në bashkëpunim me Organizatën IOM, ka nënshkruar vazhdimin e projekteve për mbështetjen e komuniteteve, për projektet kapitale dhe mbështetjen me grante (pajisje) për start-up biznese dhe zgjerim të tyre ndaj komuniteteve jo-shumicë
- Ndërtimi i dy shtëpive në kuadër te projektit RRK V –IOM

- Është bërë shpërndarja e materialevee didaktike për 70 fëmijë të komuniteteve: Rom. Ashkali dhe Egjiptian
- Nënshkrimi i Memorandumit për mbështetjen e Qendrës së Arsimit për Komunitete në Ratkoc (nga DKA & OJQ-VORAE).

# NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Duke u bazuar në objektivat që i ka të planifikuara për realizim të aktiviteteve gjatë gjithë vitit, NJKDNJ në tremujorin e parë të këtij viti për zbatim, monitorim dhe raportim mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi promovimin dhe përhapjen e vlerave në fushën e të drejtave të njeriut, e në veçanti të gruas si dhe fuqizimi, integrimi i saj në jetën shoqërore, ka realizuar një sërë aktivitetesh.

**Aktivitetet në periudhën: janar- dhjetor**

- Me projektin e Ri-Atdhesimit kanë përfunduar tri (3) shtëpitë që ishin duke u ndërtuar gjatë vitit 2019, poashtu, është bërë edhe mobilimi i tërësishëm i këtyre shtëpive;
- Janë mbajtur dy takime të rregullta në kuadër të ditës së hapur me qytetarë me këshilltarin e lartë juridik të Avokatit të Popullit;
- Pas trajnimit për Platformën për të Drejtat e Njeriut – me kërkesen e MAPL-së, kemi aritur të hapim linkun ne ueb-faqen zyrtare të Komunës, i cili do të shërbejë për lehtësimin e punës për të gjithë punonjësit e Administratës Komunale;
- Pas një pune të gjatë që kemi bërë me disa nga gra të dhunuara gjatë luftës, duke ju ndihmuar në aplikacione për komision, Komisioni Qendror na ka njoftuar se 4 prej tyre ju është njohur statusi dhe tani do te jenë të kompenzuar nga 230€ në muaj, nga muaji prill.

# ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

Zyra për Integrime Evropiane ka kryer funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011, për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integrime evropiane, në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integrime Evropiane.

**Aktivitetet:**

Mbikëqyrja e aktiviteteve të drejtorive që burojnë nga PKZMSA-ja, si dhe dokumentet e tjera strategjike të MAPL-së dhe Qeverisë së Kosovës;
Obligimet e komunave që dalin nga Agjenda Evropiane, duke u bazuar në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit;

**Procesi i ri- Integrimit për personat e riatdhesuar:**

Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të përbashkëta, banimi përmes qirasë, regjistrimi civil dhe pajisja me dokumente personale, përfshirja e të riatdhesuarve në përfitimet nga skemat sociale sipas legjislacionit në fuqi, verifikimin e rasteve në terren në bashkëpunim me koordinatorin regjional dhe futja e të dhënave në SMR-në.

# ZYRA PËR BARAZI GJINORE

**Aktivitetet:**

Edhe pse në komunën tonë sfidë në vetvete mbetet implementimi i Ligjit për Barazi Gjinore dhe arritja e barazisë gjinore, falë mbështetjes komunale, organizatave te ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si dhe angazhimit të përbashkët i të gjithë aktereve, si dhe i ZBGj, kemi arritur të realizojmë një pjesë bukur të madhe të aktiviteteve të parapara për këtë periudhë raportuese njëherit të bazuara në Planin Vjetor të Punës për arritjen e barazisë gjinore.
Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me grupin joformal të grave, kemi shënuar aktivitete të ndryshme si: shënimi i festës së Gruas, 8 Marsit, dorëzime të statistikave gjinore në Komunën e Rahovecit ku është mbajtur evidencë rreth statistikave gjinore, si në: administratën komunale, shëndetësi, arsim dhe për banorët e Komunës, në baza etnie dhe gjinore. Janë realizuar disa aktivitete që kanë patur për qëllim promovimin e trashëgimisë dhe pronës së gruas me gra, vajza dhe me nxënëse ë shkollës së mesme këtu në Rahovec në bashkëpunim me OSCE.

# SEKTORI PËR LEKTORIM

**Aktivitetet: janar- dhjetor 2020**

Gjatë këtij 1- vjeçari, zyrtarja për lektorim, ka lektoruar dokumentet e nxjerra nga Kryetari i Komunës, që ka lëshuar Zyra Ligjore, të tjera që kanë ardhur nga drejtoritë, nga Kuvendi Komunal dhe nga komitetet e Kuvendit (procesverbale dhe vendime), si dhe dokumente të tjera të adresuara.

| | |
|---|---|
| Vendime | 562 |
| Urdhëresa | 71 |
| Kërkesa | 56 |
| Përgjigje në kërkesa | 57 |
| Njoftim | 4 |

| | |
|---|---|
| Propozim | 24 |
| Rregullore | 1 |
| Marrëveshje | 6 |
| Raporte | 3 |
| Zyra e Personelit | 2 |
| Drejtoria e Financave | 4 |
| Drejtoria e Bujqësisë | 1 |
| Letërkonfirmim | 1 |
| KKSB ( Raport i punës) | 1 |
| KPF (procesverbal) | 12 |
| Kuvendi (procesverbal) | 11 |
| Kuvendi Komunal ( vendime) | 71 |
| KKSB ( procesverbal) | 4 |
| Komiteti për Komunitete (procesverbal) | 2 |
| Shkresa përcjellëse | 3 |
| Arsyetim | 2 |
| Autorizime | 13 |
| Rekomandime | 6 |
| Gjithsej: | 917 |

## DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Raporti i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në vazhdim pasqyron punën e kësaj drejtorie për periudhën: janar – dhjetor 2020, punë kjo e realizuar në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet në fuqi. Si një segment i rëndësishëm i Komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal po thuaj se çdo ditë, Administrata Komunale gjatë kësaj periudhe raportuese edhe përkundër shfaqjes së pandemisë COVID-19, dhe stafit të reduktuar, DA, ka bërë përpjekje që të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, duke ju ofruar qytetarëve të saj, si në aspektin kohor dhe atë cilësor realizim të të drejtave të tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës, me kohë maksimale të pritjes 5 minuta, për të gjitha shërbimet që i ofron administrata.

<u>Sektori i Gjendjes Civile</u>

Sektori për Gjendje Civile gjatë vitit 2020 ka realizuar punët bazuar në ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative mbi dokumentet dhe lëshimin e dokumenteve zyrtare. Ky sektor ka kryer veprime të shërbimit të gjendjes civile siç janë: plotësimi, përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative,

mbajtja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile si dhe veprimeve të tjera juridike administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi.

| DOKUMENTET E LËSHUARA NGA SISTEMI I GJENDJES CIVILE | | | |
|---|---|---|---|
| Komuna | | Data prej: | Data deri: |
| Rahovec | | 01.01.2020 | 24.12.2020 |
| Lloji i dokumentit : | | | |
| Certifikatë lindje | | 20.409 | |
| Certifikatë martese | | 3113 | |
| Certifikatë vdekje | | 613 | |
| Certifikatë vendbanimi | | 865 | |
| Certifikatë të bashkësisë familjare | | 1,991 | |
| Certifikatë të gjendje martesore | | 1299 | |
| Certifikatë shtetësie | | 173 | |
| Lëshimi i vërtetimeve nga arkivi | | 968 | |

*Vërejtje:* në këtë pjesë të raportit, përpos lëshimit të dokumenteve të gjendjes civile, numerikisht evidentohen – hyjnë në sistemin elektronik edhe verifikimet e dokumenteve të ndryshme personale sipas kërkesave të qytetarëve – palëve. Siç shihet nga ky raport, sektori i gjendjes civile ka qenë mjaft efikas dhe funksional në lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile dhe zhvillimin e procedurave administrative për rregullimin e çështjeve të gjendjes civile sipas kërkesave të palëve.

**Sektori i Teknologjisë Informative**

Sektori i Teknologjisë Informative ka vazhduar me zbatimin e planifikimit vjetor të punëve si dhe punëve të përditshme siç janë: monitorimi i rrjetit, sistemeve, përkrahja e zyrtarëve etj.

- Gjatë kësaj periudhe raportuese sektori i teknologjisë informative ka bërë testimin e kabllove prej burimit të pikave ndërlidhëse deri te kompjuterët, printerët dhe pajisjet e tjera, poashtu, është bërë pastrimi i rregullt i serverëve, bartja e incizimeve nga kompjuteri i sallës së kuvendit në NAS;
- Është bërë instalimi sistemit operativ ëindoës 10 në ato kompjutera ku kemi patur mundësi dhe paketën e office;
- Gjatë kësaj periudhe kemi bërë dorëzimin e printerëve të operatorit "RIKON" dhe kemi filluar pranimin e pajisjeve nga operatori tjetër "Arthouse" ku kemi filluar shpërndarjen e tyre dhe konfigurimin dhe instalimin;
- Ka pasur mjaft kërkesa për përkrahje Ad-Hoc, të cilave iu jemi përgjigjur (intervenim në kompjutera, përkrahja në krijimin e dokumenteve të ndryshme etj);

- Në vazhdimësi jemi duke u marrë me sistemin e intranetit dhe ku ka nevojë e bëjmë edhe përkrahjen te stafi që ka nevojë për shfrytëzimin e këtij sistemi, në intranet me kërkesë të drejtorëve janë bërë ndryshimet në kodet ekonomike dhe shenjave të klasifikimit.
- Gjatë kësaj periudhe kemi krijuar edhe disa llogari në active directory për zyrtar që janë pranuar me kontratë mbi vepër, këto janë kryer me kërkesë të drejtorëve të drejtorive që i kanë pranuar këta zyrtarë.
- Planifikimi për mbajtjen e trajnimeve me stafin e komunës në lidhje me përdorimin e aplikacioneve dhe sistemeve elktronike nuk është realizuar për shkak të pandemisë.

Sektori për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve

- Ndërmarrje e të gjitha masave të nevojshme për organizimin më të mirë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, përgatitja e materialeve të nevojshme, dërgimi i ftesave dhe çështje të tjera rreth organizimit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës (10 mbledhje) të Kuvendit Komunal;
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Dërgimi i të gjitha akteve në MAPL, sipas kërkesës së tyre;
- Përpilimi dhe lektorimi profesional të materialeve literare në gjuhët zyrtare në Komunën e Rahovecit.

Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve

- Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve, brenda kompetencave ka kryer punët rutinore pa ndonjë specifikë, ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbrim etj).
- Kemi menaxhuar me racionalitet të plotë dhe të domosdoshëm me fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësore e të cilave është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar në permanencë mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servisimin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate etj.

Qendra për Shërbime me Qytetarë

Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, për këtë periudhë raportuese është arritur ngritja e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve, brenda afateve ligjore.
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë – Sektorit Pritës – Protokoll, ka qenë mjaft efikase dhe funksionale në realizimin e lëndëve si të përfunduara – vendosura lëndët sipas kërkesave të qytetarëve me kohë dhe brenda afateve ligjore, d.m.th. të gjitha lëndët janë përfunduar sipas Ligjit të Procedurës Administrative, me çka mund të thuhet se shërbimi ndaj qytetarëve ka qenë në nivelin shumë të kënaqshëm. Gjithashtu, nivel i kënaqshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve ka qenë edhe në drejtoritë e tjera të Administratës Komunale që me kohë kanë përfunduar – vendosur lëndët sipas kërkesave/parashtresave të qytetarëve, edhe përkundër shfaqjes së pandemisë COVID-19.

Përmes Qendrës për Shërbime me qytetarë arrihet edhe komunikimi i drejtpërdrejtë, korrekt dhe transparent me qytetarët dhe bizneset, dhënia e ndihmës profesionale për paraqitjen e kërkesave dhe parashtresave, njohja e qytetarëve me informacionet e nevojshme lidhur me kushtet, procedurat administrative , ligjore , afatet kohore të paraqitjes dhe trajtimit të kërkesave dhe parashtresave si në formën klasike ashtu edhe përmes formës elektronike /intranetit , përgatitja dhe vënia në dispozicion të broshurave dhe fletëpalosjeve informative për qytetarët, mbajtja e dosjeve , statistikave të parashtresave dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët, shtypjen e librit të protokollit për kërkesat/parashtresat, vëzhgimi i reagimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron qendra etj.

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Financa dhe Buxhet ka përgatitur raportin e punës për periudhën: (janar- dhjetor 2020), i cili është një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të cilat janë kryer gjatë kësaj periudhe raportuese, bazuar në : Ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret të cilat e rregullojnë fushën të cilën e mbulon DPF, bazuar edhe në programin e punës së Kryetarit të Komunës, planin e punës së drejtorisë, bazuar në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit komunal, inkasimit të të hyrave vetanake, mbajtjen e lidhjeve dhe korrespodencave me ministritë e linjës e në veçanti me Ministrinë e Financave.

***Më poshtë po paraqesim në vija të shkurtëra disa nga punët dhe aktivitetet më kryesore në sektorë të drejtorisë:***

**Sektori për Buxhet dhe Financa**

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë, ne si drejtori kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.
Në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, kemi arritur që detyrat dhe obligimet që dalin para kësaj drejtorie të kryhen në afate ligjore duke evidentuar dhe regjistruar të gjitha të hyrat sipas kategorive të tyre, si dhe shpenzimin e buxhetit të të gjitha kategorive. Gjate kësaj periudhe raportuese kemi mbajtur takime të ndryshme me MF-në, Asociacionin e Komunave të Kosovës, organizata të ndryshme apo donator, takime këto në të cilat kryesisht janë trajtuar çështjet financiare. Te shpenzimet operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime, kryesisht Mallra dhe Shërbime, pa e dëmtuar Buxhetin në kategori të tjera, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga kapitalet e realisht kanë qenë Mallra dhe Shërbime, siç janë: mirëmbajtja e ndërtesave dhe rrugëve, pastrimi i rrugëve, rrënimi i objekteve pa leje, sinjalizimi i rrugëve etj.
Në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, janë realizuar detyrat kryesore duke respektuar edhe afate ligjore të rregulluara me ligjet që rregullojnë financat publike.
***Komuna e Rahovecit për vitin 2020 ka operuar me një Buxhet prej: 14,735,820.00 euro, të përbërë nga Grandi Qeveritar dhe të Hyrat Vetanake:***

| | | |
|---|---|---|
| Grandi i qeveritar | | 13,578,979.00 € |
| Të hyrat vetanake | | 1,156,841.00 € |
| Gjithsej | | 14,735,820.00 € |

Shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike në vitin 2020 është siç vijon:

| | | |
|---|---|---|
| Paga e mëditje | | 8,644,820.00 € |
| Mallra dhe shërbime | | 1,594,330.00 € |
| Shpenzime komunale | | 280,500.00 € |
| Subvencione | | 311,001.00 € |
| Investime kapitale | | 3,905,770.00€ |

**Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi realizuar këto detyra:**

- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtorë;
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujore 2020 për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës;
- Raportimi i obligimeve financiare në baza mujore në Ministrinë e Financave;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore(shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në Ëeb faqen e Komunës;
- Përgatitja e KAB-it 2021-2023 për Kuvend.Përgatitja e dokumentacionit për bartjen e mjeteve nga viti 2019 për Kuvendin Komunal dhe Ministrinë e Finanave, përgatitja e shkresave, kërkesave të ndryshme gjatë kësaj periudhe.

**JANAR-DHJETOR BUXHET,ALOKIM,SHPENZIM**

| Përshkrimi | Lëndët e kryera | Buxheti fillestar | Buxheti final | Alokimet | Shpenzimet | Shpenzim Buxhet fillestar % | Shpenzim Buxheti final % | Shpenzim Alokim % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Paga dhe Mëdtije | 49 | 7,556,821 | 7,728,604 | 7,024,410 | 7,002,484 | 93 | 91 | 100 |
| Mallra dhe Shërbime | 2943 | 1,594,330 | 1,746,798 | 1,746,798 | 1,593,843 | 100 | 91 | 91 |
| Shpenzime Komunale | 571 | 280,500 | 280,500 | 280,500 | 260,577 | 93 | 93 | 93 |
| Subvencione dhe Transfere | 169 | 311,000 | 321,000 | 321,000 | 320,032 | 103 | 100 | 100 |
| Investime Kapitale | 369 | 3,905,770 | 5,388,818 | 5,388,818 | 5,142,211 | 132 | 95 | 95 |
| Rezervat (për zbatimin e ligjit të pagave) | - | 1,087,399 | | 0 | | 0 | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Totali | | 14,735,820 | 15,465,720 | 14,761,527 | 14,319,147 | 520 | #DIV/0! | #DIV/0! |

**Sqarim:** Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për shkak të bartjes së mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2019, alokimi i huamarrjes ,poashtu edhe mjetet e alokuara nga Grandi i MAPL për menaxhimin e situtatës nga pandemia në shumë prej 212,885,78 euro.

**PARAQITJA GRAFIKE:**




**Të hyrat vetanake**

- Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2020 janë 1,156,841,00 euro, për ketë periudhë janë realizuar në shumë prej: 1,259,407,74 apo 108,86 % të planifikimit vjetor

**Sektori i Tatimit në Pronë**

- Objekte të reja të regjistruara: 252 objekte ose 46.746 $m^2$;
- Verifikim i pronave ekzistuese: 3000 , ose 541.921$m^2$.
- Të hyrat e realizuara: gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra prej 416.929.31 euro apo 77.04 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 541,173,00)
- Perqindja e realizimit të Tatimit në Pronë, në raport me vitin 2019, të njëjtës periudhë është (28.923.17) apo (93.51%)

***Vërejtje: Të gjitha të dhënat që janë të paraqitura janë përgatitur në bazë të raporteve deri më 17.12.2020***

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë kësaj periudhe raportuese ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.
Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2020. Ky raport përfshin në mënyrë gjithpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

<u>Tremujori i parë: janar, shkurt, mars 2020</u>

DSHMS qysh në fillim të vitit 2020 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësive të përshkruara, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planifikuara, janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit - shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësore me dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, poashtu, në fshatrat Dejnë dhe Ratkoc është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut, dhurimi vullnetar i gjakut ka vazhduar edhe në fshatrat e tjera të komunës sonë.
Muaji mars, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh dhe masa të ndërmarra nga Komuna e Rahovecit, si drejtori në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës dhe menaxhimit të situatës nga përhapja e Covid-19, kemi ngritur në nivel të lartë gatishmërinë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi, duke ndërmarr masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga Virusi Korona (COVID-19).
Në mënyrë që të ofrojmë shërbime profesionale dhe të sigurta për qytetarët, tashmë kemi marrë vendim që në të dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, edhe ditën e shtunë të punohet me orar të rregullt.

<u>Tremujori i dytë: prill, maj, qershor</u>

Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal, është miratuar propozim-vendimi i Kryetarit, z. Smajl Latifi për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000 euro, për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19. Më anë të këtij vendimi kemi vënë në dispozicion 10.000 (dhjetëmijë) euro, mjete këto që do të shfrytëzohen për mbulimin e kërkesave dhe nevojave të Shtabit të Posaçëm Emergjent, më saktësisht për menaxhimin e situatës së krijuar nga ky virus, duke përfshirë këtu furnizimin me barna ose përkrahjen për rastet sociale.

Kemi bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve dhe institucioneve publike, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit, si: objektet shëndetësore (QKMF, QMF-të, AMF-të), objektet e Administratës Komunale, objektet fetare: ( Xhamitë dhe Teqetë), Stacioni i Autobusëve, Stacioni Policor, objekte kulturore dhe sportive etj. Vlen të theksohet se objektet shëndetësore dezinfektohen çdo vikend, ndërsa reparti i mjekësisë familjare dhe kujdestaria dezinfektohen dy herë në javë për shkak se janë reparte më të frekuentuara nga qytetarët tanë.

# RAPORT VJETOR I PUNËS

Pas situatës së krijuar nga rreziku i infeksionit COVID-19, të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, individë e biznese, po vazhdojnë, traditën, humanizmin dhe solidaritetin, në mbështetje të qytetarëve, duke dhuruar kështu donacione të ndryshme si: pako ushiqmore dhe higjienike, destilat, dezinefkutes për duar, ndihmë në vlerë monetare etj.
Shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike është bërë në përputhje me listat e përpiluara në bashkëpunim me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit, Qendrën për Punë Sociale në Rahovec dhe Kryqin e Kuq.

<u>Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator</u>

Periudhën e tretë të vitit 2020 e ka karakterizuar furnizimi me vaksinat kundër gripit sezonal për të moshuarit, përcjellja e projekteve të investimeve kapitale si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë e subvencioneve për ndihma momentale. Kemi subvencionuar në vazhdimësi OJQ-të, që merren me veprimtari sociale, si shoqatat: Harea, Hendikos, dhe shumë shoqata tjera, po ashtu kemi liruar nga obligimet e shërbimeve komunali.

Ekipi i veçantë mjekësor edhe në këtë periudhë ka vazhduar me kontrollat mjekësore të të prekurve me Covid-19, në inspektimet të rregullta nga inspektoriati i MSH-së, kemi marrë vlerësimet maksimale për zbatim të rregullave të dala nga IKSHP, për parandalim të përhapjes së Covid-19.

Sa i përket furnizimit me barna esenciale, komuna e Rahovecit, furnizohet rregullisht nga Ministria e Shëndetësisë, po ashtu kemi të lidhur edhe një kontratë për barnat emergjente, ndërkaq furnizimi me reagenca është i kënaqshëm dhe mund të kryhen të gjitha shërbimet laboratorike sipas udhëzimeve administrative që kryhen në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor;

<u>Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor</u>

Në bashkëpunim me AQH-në, kemi vazhduar zbatimin e Master Planit për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Rahovecit, për periudhën 2020 /2024, Master Plani për Kujdesin Parësor Shëndetësor, është miratuar edhe në Kuvendin Komunal të Rahovecit.
Me kohë QKMF, QMF, dhe AMF-të, janë furnizuar me lëndët djegëse për ngrohje për sezonën e dimrit.
Fokus i periudhës së fundit të vitit ka qenë përcjellja e punimeve në investime kapitale, sigurisht se prioritet kryesor ishte realizimi i buxhetit, jemi kujdesur që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikmëri.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë edhe shpërndarja e mëtejme e shërbimeve, duke punësuar mjekë të përgjithshëm stomatologë dhe një fizioterapeut duke ofruar shërime të fiziatrisë në QMF në Krushë të Madhe, poashtu, tani kemi stomatologë permanent në dy QMF-të, në Drenoc, dhe Fortesë, presim shumë shpejtë të angazhojmë stomatologë edhe në dy QMF të tjera, në Opterushë dhe Çifilak;
Përmes ndihmave momentale edhe në vitin 2020, kemi mbështetur 188 familje në nevojë të komunës së Rahovecit;

Kemi pajisur me EHO QKMF-në, për Radiologji, Gjinekologi, Urologji, ndërsa në mujajin mars do të pajiset edhe me Mamograf, poashtu jemi në proces të furnizmzimit me karrige stomatologjike për 5 QMF, në komunën tonë, poashtu së shpejti pritet të pajisen me karrige stomatologjike edhe dy QMF-të e mbetura në fshatrat Çiflak dhe Opterushë, pas funksionalizimit të tërësishëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore;
Në vazhdimësi jemi përkujdesur që të bëjmë përpjekjet e nevojshme për funksionalizimin e Repartit të Hemodializës në Rahovec, por , presim veprimet e spitalit regjional ne Prizren për rekrutim te stafit shëndetësor, pasi që hemodializa nuk hyn në kuadër te Kujdesit Parësor Shëndetësor është kompetencë e kujdesit dytësor;

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Është bërë ndërtimi QKMF-së dhe Emergjencës në Rahovec, një objekt tejet modern i cili është funksionalizuar në festat e nëntorit dhe kap vlerën prej: 863,350.26 euro;
- Ndërtuam QMF-në në Çiflak, objekti tashmë është funksional dhe kap vlerën prej: 91.102,38 euro;
- Janë duke vazhduar punimet në ndërtimn e QMF-së, në Opterushë vlera e kontratës 81.543,22 projekti pritet të perfundojë në muajin prill të vitit 2021;
- Dixhitalizimi i Radiologjisë, është furnizuar QKMF-ja me pajisje moderne të EHO-s, për Radiologji, GjinEokologji, dhe Urologji, po ashtu deri ne mars të vitit 2021 do të furnizohemi edhe me Mamograf per diagnostifikim të hershëm të kancerit të gjirit, dhe Ortopan për nevojat e stomatologjisë.

Mirëqenia Sociale:

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushëveprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendorë dhe të huaj, poashtu, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare. Pra, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia.

Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

# RAPORT VJETOR I PUNËS

## DREJTORIA PËR ARSIM

Në këtë raport të Drejtorisë Komunale për Arsim janë pasqyruar aktivitetet dhe punët që janë kryer në 12 muajt e vitit 2020. Këto aktivitete janë zhvilluar sipas planifikimeve të bëra të planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë tërë vitit.

<u>Synimet kryesore e DKA-së për vitin 2020 ishin:</u>

- Funksionalizimi i Ekipit Profesional Vlerësues në kuadër të DKA-së;
- Funksionalizimi i plotë i Ekipeve Profesionale Vlerësuese në secilën shkollë;
- Zgjerimi i stafit të DKA-së me kuadrin e nevojshëm të pedagogëve dhe psikologëve;
- Riparimet dhe investimet në efiçiencë të energjisë në objektet shkollore;
- Vazhdimi i investimeve në projektet për ndërtimin e 3 çerdheve për fëmijë;
- Vazhdimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018;
- Ndërtimi i shkollave të reja;
- Vazhdimi i investimeve në projektet e instalimit të ngrohjes qendrore në shkolla, të cilat nuk kanë.
- Vazhdimi i investimeve në riparimin e nyjeve sanitare nëpër objektet shkollore.
- Furnizimi i shkollave me libra, pako pedagogjike, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike dhe teknologji informative.

<u>Qëllime kryesore kishim:</u>

- Ngritjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimor në shkollat e të gjitha niveleve;
- Përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të institucioneve edukativo arsimore;
- Zhvillimin e aktiviteteve të shumta kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Funksionimin sa më të mirë të organeve drejtuese të shkollave;
- Ngritjen dhe zhvillimin profesional të kuadrit arsimor.

<u>Objektivat tona të përhershme, që karakterizuan edhe këtë vit, janë:</u>

- Përmirësimi i nivelit të mësimdhënies dhe të nxënit e nxënësve në të gjitha shkollat;
- Zvogëlimi deri në minimum i mungesave të pa arsyeshme të nxënësve dhe mësimdhënësve;
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe objekteve parashkollore (çerdheve);
- Riparimet e objekteve shkollore;
- Rregullimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollës;
- Zhvillimi i aktiviteteve të shumta jashtë kurrikulare në nivel shkolle dhe komune;
- Futja në procesin e implementimit të KB dhe KKK për të gjitha shkollat e komunës;
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe me OJQ-të, aksionet vullnetare;

- Integrimi në procesin edukativo-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim;

Mirëpo, gjatë kësaj periudhe u krijua një situatë e pa parashikur, si rezultat i shfaqjes së pandemisë COVID-19. Si rrjedhojë e gjendjes së re të krijuar, ne kemi bërë edhe punë të pa parashikuara në planin vjetor. Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të përmbledhura në 4 etapa me nga 3 muaj, siç vijon:

<u>Aktivitetet në periudhën janar – mars</u>

- Në fillim të janarit u realizua procesi i trajnimit të Ekipeve të Vlerësimit të Brendshëm të të gjitha shkollave, trajnim ky i cili u zhvillua gjatë pushimit dimëror. Në këtë trajnim u përfshinë të gjitha ekipet e secilës shkollë, me gjithsej 190 pjesëmarrës.
- Pranuam një donacion nga KFORI Italian, të cilin e dedikuam për nxënësit e Shfmu "Gëzim Hamza-Piktori". Ky donacion u dhurua si rezultat i bashkëpunimit të DKA-së me Kforin Italian dhe përmban mjete konkretizimi dhe pajisje laboratorike për lëndën e fizikës.
- U mbajtën garat shkollore të Fizikanëve të Rinjë, ndërsa më 18 Janar u mbajt Gara Komunale e Fizikanëve të Rinjë me nxënënësit fitues të klasave 9,10, 11 dhe 12. Poashtu, nëpër shkolla kanë janë mbajtur garat shkollore për Olimpiadën e Matematikës, gara komunale e së cilës u zhvillua më 25 janar.
- Realizuam një takim me Caritas-in e Zvicrës ku u konsultuam për fillimin e realizimit të projektit "Shpresë", përmes të cilit 6 klasa parafillore do të pajisen me inventar dhe do të bëhet trajnimi i të gjitha edukatoreve.
- Është mbajtur takimi i dytë i Ekipit për Parandalimin e Braktisjes dhe Reagimit ndaj Mosregjistrimit të nxënësve.
- Kemi mbajtur takime me përfaqësues të operatorëve që kanë kontratë në ndërtimin e shkollave dhe çerdheve, në të cilat kemi biseduar për rifillimin e punimeve në realizimin e projekteve. Nëpër të gjitha shkollat ka vazhduar themelimi i Ekipeve Shkollore për Parandalimin e Braktisjes dhe Reagimit ndaj Mosregjistrimit (EPBRM) të nxënësve.
- Filluam të përgatisim paramasat për projektin "Riparime në Shkolla", përkatësisht për riparimin e nyjeve sanitare dhe dyshemeve të shkollave dhe paramasën për ngrohje qendrore për shkollën "Dëshmorët e Lirisë" dhe për shkollën "Vëllezërit Frashëri" – paralelja e ndarë në Senoc.
- Në Shkollën e Mesme Profesionale kemi përuruar 3 kabinete: kabinetin e makinerisë, kabinetin e teknologjisë informative dhe kabinetin e shkencave juridike. Nëpër shkolla janë mbajtur programe festive për nder të 17 Shkurtit-Ditës së Pavarësisë së Kosovës, ndërkaq në bashkëpunim me DKRS kemi organizuar dhe mbajtur një tryezë diskutimi me historianë.
- Vazhdoi trajnimi me drejtorët e shkollave në kuadër të projektit "Shkollat e shek. 21", i mbështetur nga Këshilli Britanik, Masht dhe DKA. Kanë rifilluar punimet në ndërtimin e objektit të shkollës në Kaznik dhe në Fortesë. Kemi përgatitur kërkesat për mbështetje financiare të projekteve drejtuar MASHTI-t, dhe kemi marrë pjesë në Konferencën për Edukimin të organizuar nga Qendra për Arsim e Kosovës dhe nga Organizata "Teach for Kosova".

- Drejtori i DKA-së, më 9 Mars, ka marrë pjesë në takimin e thirrur nga MASH për të shqyrtuar situatën e krijuar nga përhapja e Virusit Corona dhe për masat parandaluese që duhet ndërmarrë në çerdhe e shkolla. Pas këtij takimi, DKA ka themeluar një ekip koordinues për të ndërmarrë masat adekuate.
- Procesi mësimor në të gjitha nivelet e sistemit arsimor është ndërprerë, sipas vendimit të qeverisë dhe janë marrë masa në rritjen e higjienës në çerdhe e shkolla.

<u>Aktivitetet në periudhën prill – qershor</u>

- Në këtë periudhë vizituam punishtet ku po punohet në realizimin e projekteve, si punishtet në ndërtimin e çerdhes në Xërxë, punimet në ndërtimin e objektit të shkollës në Fortesë dhe punimet në instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e ri të shkollës në Hoçë të Vogël/Brestoc.
- Nisëm procedurat e prokurimit për projektin e renovimit në 10 shkolla dhe po ashtu projektin për instalimin e ngrohjes qendrore në shkollën "Dëshmorët e Lirisë" në Pataqan të Ulët dhe në paralelen e ndarë të shkollës "Vëllezërit Frashëri" në Senoc.
- Vazhduam me përcjelljen e procesit të mësimit në distancë duke zbatuar rekomandimet e MASHTIT-t për të gjitha nivelet e sistemit arsimor.
- Morëm njoftimin e rëndësishëm nga kompaia Consult-Eng – Prishtinë, e cila ka lidhur kontratë me MZHE-në, se do të fillojë së zbatuari projekti i zbatimit të masave të efiçiencës së energjisë në objektin e shkollës "Nesimi Elshani" në fshatin Nagavc.
- Nga ELKOS-Group dhe përmes MASH kemi pranuar një donacion të vogël prej 11 laptopë të vegjël, të cilat i kemi shpërndarë tek nxënësit që nuk kanë pasur fare.
- Kemi pranuar raporte të rregullta nga drejtorët e shkollave për ecurinë e zhvillimit të mësimit nga distanca, me ç'rast kemi mbajtur edhe takime online me drejtorët e shkollave.
- Vazhdoi procesi i aplikimit të studentëve në konkursin për bursa komunale.
- Nisëm hartimin e paramasave për riparimin e tualeteve dhe nyjeve sanitare për 4 shkolla, të cilat pasi i përgatitëm, i kemi dërguar në Departamentin e Infrastrukturës në Ministrinë e Arsimit.
- Kemi pëgatitur një raport detal të ecurisë së mësimit në distancë gjatë kësaj periudhe dhe këtë raport e kemi prezantuar në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal.
- Realizuam planifikimin për regjistrimin e nxënësve në klasat e 10-ta në 3 SHML-të dhe në SHMLP.
- Nga MASH morëm njoftimin se testi i arritshmërisë do të mbahet më 23 qershor dhe ai i maturës më 4 korrik. Po ashtu, nga MASHTI kemi marrë njoftimin se do të fillohet me mësim plotësues me nxënësit e klasave të nënta dhe të 12-a. Për këtë arsye mbajtëm një mbledhje me të gjithë drejtorët e shkollave fillore të mesme të ulëta për t'i bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme. Nga data 3 qershor rifilloi puna në objektin e vjetër të çerdhes së fëmijëve, pasi bëmë dezinfektimin dhe punët tjera përgatitore.
- Për mbajtjen e Testit të Arritshmërisë përcaktuam 5 qendra (objekte shkollore), të cilat u përgatitën për t'i pritur numrin e nxënësve deri në 200 nxënës, me masa mbrojtëse sipas rekomandimeve të Mashti-t.

- Në objektin e ri të çerdhes Tulipanët ka vazhduar pajisja me inventarin e nevojshëm, proces ky i cili po vazhdon, por ende nuk ka përfunduar.
- Në objektin e shkollës "Nesimi Elshani" në Nagavc ka filluar projekti i efiçiencës së energjisë, ku fillimisht ka filluar puna në instalimin e ndriçimit efiçient e pastaj do të vazhdohet me instalimin e ngrohjes qendrore dhe punëve të tjera të parapara sipas projektit.
- Kemi përgatitur 6 kërkesa drejtuar MASHTI-t për mbështetje financiare të projekteve në vazhdim, ndërkohë që në bashkëpunim me DKRS kemi filluar përgatitjet për garën sportive virtuale me nxënës të lindur në vitin 2008, organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

<u>Aktivitetet në periudhën korrik – shtator</u>

- Në këtë periudhë kemi vazhduar furnizimin me lëndë djegëse(dru) për ngrohje gjatë dimrit.
- Pasi u lidh kontrata, menjëherë kanë filluar punët në instalimin e ngrohjes qendrore në dy objekte shkollore, në objektin e shkollës "Dëshmorët e Lirisë" në Pataqan të Poshtëm dhe në objektin e paraleles së ndarë të shkollës "Vëllezërit Frashëri" në Senoc. Punët kanë filluar edhe në projektin e renovimit të shkollave (Lot2), përkatësisht në renovimin e dyshemeve të klasave dhe nyjeve sanitare në objektin e shkollës "Gëzim Hamza-Piktori". Poashtu, këto riparime kanë filluar edhe në objektin e vjetër të shkollës "Isa Boletin".
- Ka vazhduar procesi i regjistrimit të fëmijëve në klasat parafillore dhe në klasat e para në të gjitha shkollat dhe kemi filluar me grumbullimin e të dhënave për numrin e nxënësve nga klasa e parë deri në klasat e nënta për t'u pajisur me tekste falas nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
- Kemi vazhduar procesin e grumbullimit të të dhënave për të bërë planifikimin e kuadrit mësimor dhe numrit të orëve për vitin e ri shkollor 2020/2021 dhe kemi evidencuar të gjithë numrin e nxënësve në të gjitha nivelet, të cilëve u mungon teknologjia informative. Këto të dhëna i kemi dërguar në MASH.
- U mbajt dhe përfundoi edhe cikli i parë i trajnimeve të edukatoreve dhe mësimdhënësve të niveleve parafillor dhe fillor për zbatimin praktik të kurrikulës, trajnim të cilin e realizuam në Qendrën për Ngritje Profesionale në shkollën "Isa Boletini". U trajnuan 15 edukatore dhe mësues/e klase.
- Kemi bërë vizitë punimeve në instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e shkollës "Dëshmorët e Lirisë" në Pataqan të Poshtëm, ku ky proces vazhdoi pastaj edhe në objektin e paraleles së ndarë të shkollës "Vëllezërit Frashëri" në Senoc.
- Së bashku me inxhinierët e komunës kemi qenë në oborrin e shkollës "Nesimi Elshani", ku kemi bërë matjet e nevojshme për hartimin e paramasës për rrethojën e oborrit të shkollës. Kemi filluar përgatitjen edhe të paramasës për nyjet sanitare në objektin e shkollës "Rilindja" në Çifllak.
- Është përfunduar realizimi i projektit të efiçiencës së energjisë në shkollën "Nesimi Elshani" në Nagavc, ndërkohë që punët kanë vazhduar edhe në ndërtimin e cerdheve në Xërxë dhe Ratkoc, të cilat i vizituam.
- Kemi pranuar një donacion prej 120 bankave dhe 240 karrigeve për nxënës nga Kolegji "Biznesi", të cilat gjatë i shpërndamë në 5 shkolla, të cilat kishin nevojë.
- Nga MASH është nxjerrë vendimi që të anulohet mbajtja e testit të arritshmërisë, ndërsa regjistrimi i nxënësve në klasat e 10-a u zhvillua nga data 17 gusht e deri më 21 gusht.

- Nëpër shkollat fillore të mesme të ulëta është bërë shpërndarja e dëftesave për nxënësit e klasave të nënta dhe kemi hapur konkursin për regjistrimin e tyre në klasat e dhjeta të shkollave të mesme të larta. Regjistrimi u zhvillua gjatë periudhës 17 – 21 gusht, 2020.
- Pasi kemi përfunduar procesin e grumbullimit të të dhënave për të bërë planifikimin e kuadrit mësimor për vitin e ri shkollor 2020/2021 kemi hapur konkurs për plotësimin e vendeve të punës me kuadër adekuat, në disa pozita.
- Kemi filluar përgatitjet për mbajtjen e Testit të Maturës, i cili u mbajt më 29 gusht. 2020.
- Janë realizuar vizita pa paralajmërim në disa shkolla të komunës sonë për të përcjelluar procesin edukativo arsimor dhe kemi bërë një vizitë punimeve në çerdhen e qytetit.
- Është mbajtur një takim konsultues për hapat e zbatimit të projektit ALLED 2 në Shkollën e Mesme Profesionale, ndërkohë që, në objektin e ri të çerdhes është bërë montimi i kuzhinës.
- Kemi bërë përgatitjet e nevojshme për pranimin dhe shpërndarjen e librave nga klasat patafillore deri në klasat e nënta, të cilat i shpërndamë nëpër shkolla.
- Në funksion të sigurimit të masave mbrojtëse ndaj pandemisë, me ndihmën e Drejtorisë së Shëndetësisë është bërë dezinfektimi i 5 objekteve shkollore, në të cilat u mbajt me sukses Provimi i Maturës Shtetërore. Në Provimin Shtetëror të Maturës morën pjesë 583 maturantë.
- Kemi bërë pranimin dhe kemi filluar shpërndarjen e librave nga klasat parafillore deri në klasat e nënta, nëpër të gjitha shkollat.
- Kemi mbajtur një takim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, nga i cili kemi pranuar Master Planin e hartuar nga MASH, I cili do të fillojë të zbatohet për fillimin e vitit të ri shkollor.
- Kanë përfunduar punimet në projektin e renovimit të dy shkollave (Lot2), përkatësisht në renovimin e dyshemeve të klasave dhe nyjeve sanitare në objektin e shkollës "Gëzim Hamza-Piktori" dhe në shkollën "Isa Boletini". Ka përfunduar puna në instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e paraleles së ndarë të shkollës "Vëllezërit Frashëri" në Senoc.
- Kemi pranuar të gjitha dokumentet e nevojshme të aplikantëve fitues të bursave studentore dhe kemi pranuar rezultatet e Testit të Maturës, i cili është mbajtur më 29 gusht. 2020.
- Kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor, me ç'rast shkollat janë dezinfektuar dhe i kemi furnizuar me maska, dezinfektues dhe pajisje higjienike.
- Më 14 shtator filloi pjesërisht viti i ri shkollor sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit dhe Task Forcës Komunale në Nivel të DKA-së. Sipas këtij vendimi, shkollat e mëdha filluan mësimin me klasat 0, 1, 2, 3, 6. Shkollat me numër mesatar të nxënësve filluan mësimin me klasat 0 deri 6 dhe shkollat e vogla përnga numri I nxënësve filluan mësimin me klasat 0 deri 9. Shkollat e Mesme të Larta filluan mësimin vetëm me klasat e 10-a.
- Kanë vazhduar punimet në shkollën "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël-Brestoc, ku pas mbarimit të lyerjes (suvatimit) të mureve të brendshme punët kanë vazhduar në instalimin e gypave të ngrohjes qendrore.
- Më 21 shtator, procesi mësimor filloi në të gjitha klasat, nga klasat 0 deri në të 12-at, me kohëzgjatje të orëve të mësimit me nga 30 minuta dhe pa pushime të gjata. Klasat me numër të madh të nxënësve u ndanë në

grupe dhe u koordinua orari mësimor në përputhje me hapësirën kohore të ndërrimeve dhe numrit të nxënësve.

- Realizuam një takim me divizionin e infrastrukturës në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me ç'rast morëm konfirmimin se janë pranuar dy projekte nga katër sosh që i kemi kërkuar, për riparimin e nyjeve sanitare në 2 shkolla të komunës sonë.
- Janë ekzekutuar mjetet financiare për bursat e 154 studentëve përfitues pasi dërguam të gjitha shënimet e nevojshme në Ministrinë e Financave.
- Është lidhur kontrata për zbatimin e projektit "Riparime në shkolla (LOT1) dhe kemi bërë Planin për Menaxhimin e Kontratës. Operatori ka filluar punën.

<u>Aktivitetet në periudhën tetor – dhjetor</u>

- Procesi mësimor edhe gjatë kësaj periudhe në të gjitha shkollat e komunës sonë u zhvillua normalisht sipas planifikimit të Task Forcës Komunale në nivel të DKA-së. Klasat me numër të madh të nxënësve vazhduan punën të ndara në grupe dhe u koordinua orari mësimor në përputhje me hapësirën kohore të ndërrimeve dhe numrit të nxënësve.
- Pasi është lidhur kontrata për zbatimin e projektit "Riparime në shkolla (LOT1), operatori ka filluar punën, me ç'rast u zhvilluan punime në riparimin e nyjeve sanitare në objektin e shkollës "4 Dëshmorët" në Ratkoc dhe në shkolla të tjera.
- U mbajt Provimi Shtetëror i Maturës – Afati i Dytë, i cili u zhvillua normalisht në 4 qendra. Në Testim morën pjesë 184 maturantë, të cilën nuk kishin arritur të kalonin pragun e kalueshmërisë prej 40%. Kemi pranuar edhe rezultatet e afatit të dytë të provimit të maturës, ku sipas rezultateve 74% e maturantëve në këtë afat kanë arritur pragun e kalueshmërisë me mbi 40%
- Në bashkëpunim me OJQ "Autizmi Ballkan" dhe me njohës të fushës së psikologjisë, kemi organizuar dhe mbajtur një sesion informues për autizmin, në të cilin kanë marrë pjesë mësues/e të programit fillor, edukatorë/e dhe psikologë/pedagogë të komunës sonë.
- Kemi shpërndarë pajisjet higjienike dhe dezinfektues në të gjitha shkollat dhe u bë dezinfektimi i sërishëm i objekteve shkollore.
- Vazhdoi dhe përfundoi me sukses trajnimi me mësimdhënësit e rinjë të programit fillor.
- Punët kanë vazhduar në projektin e renovimit të shkollave (Lot1), përkatësisht në renovimin nyjeve sanitare në shkollën "Rilindja" në Ciflak dhe ka filluar riparimi i nyjeve sanitare në objektin e shkollës në Gexhë. Kanë vazhduar punimet edhe në shkollën "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël/Brestoc, në shkollën "Haki Stërmilli" në Retijë e poashtu, po punohet edhe në ndërtimin e shkollës "Liria" në Fortesë.
- Në çerdhen e re për fëmijë në qytet është lidhur orëmatësi i rrymës dhe është bërë testimi i ngrohjes qendrore. Kemi bërë të gjitha përgatitjet dhe më 1 dhjetor është bërë përurimi i objektit të ri të çerdhes "Tulipanët".
- Është bërë përurimi i vënies së gurthemelit për ndërtimin e objektit të ri të shkollës "Tre Dëshmorët" në Vrajakë - Bratotin.

- Është kryer riparimi i ngrohjes qendrore në shkollën " Gëzim Hamza - Piktori" dhe në shkollën "Hamëz Thaçi" dhe kanë filluar punimet në riparimin e tualeteve dhe nyjeve sanitare në SHML "Xhelal Hajda-Toni".
- Secilën ditë të kësaj periudhe kemi përcjellur gjendjen me numrin e të infektuarve dhe në secilin rast që na është paraqitur kemi vepruar në përputhje me rekomandimet e IKSHPK-së, MSH-së dhe MASH-it. Këto veprime i kemi bërë deri në përfundim të periudhës së parë të vitit mësimor 2020/2021, e cila me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës u mbyll më 18 dhjetor, 2020.

PËRFUNDIM

Drejtoria Komunale për Arsim gjatë gjithë vitit 2020, ka qenë e përkushtuar në realizimin e planit vjetor të punës, në përcjelljen dhe realizimin e projekteve dhe gjithashtu edhe në përcjelljen e mbarëvajtjes së procesit edukativo – arsimor në të gjitha nivelet. Ky vit ishte tepër i vështirë edhe për procesin edukativo arsimor për shkak të pandemisë COVID-19. Përkushtimi ynë do të vazhdojë edhe në gjysmën e dytë të vitit shkollor, gjithnjë në përputhje të plotë me planin vjetor të punës të DKA-së për vitin 2021.

## DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planin e punës për vitin 2020. Në kuadër të drejtorisë së DEZHT-së, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar një mori aktivitetesh.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars 2020

Gjatë kësaj periudhe raportuese të vitit 2020 është bërë regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2019 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2020, poashtu, gjatë fillimit të vitit 2020 është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2020 në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2020.
Në tremujorin e parë të vitit 2020 është bërë shtypja e aktvendimeve për të gjithë bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale ku në bazë të kësaj ne kemi arritur të kemi një rritje të konsiderueshme të të hyrave në taksa afariste komunale.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Pas situatës së krijuar së fundmi nga pandemia e shfaqur COVID-19, Kuvendi Komunal Rahovec, me qëllim të krijimit të lehtësirave për bizneset e komunës sonë ka marrë këtë VENDIM: Të gjitha bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit, e që gjithsej janë 31, të cilët kanë kontratë për shfrytëzimin e objekteve komunale, lirohen nga pagesa e qirasë mujore për periudhën: (mars-maj 2020); Lirohen nga taksa komunale të gjitha bizneset që veprimtarinë e tyre

e ushtrojnë në komunën e Rahovecit, të cilët aktualisht janë të ngarkuar me rregulloren aktuale për taksa komunale, (mars-maj 2020).

Nga ana e Kryetarit, z. Smajl Latifi janë nënshkruar dy marrëveshje të mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Sipas këtyre marrëveshjeve, MZHR bashkë me Komunën e Rahovecit do të financojnë dy projekte, konkretisht: projektin: "Renovimi i Stacionit të autobusëve dhe kabinave inovative "në vlerën: 100.000 euro, si dhe projektin: "Ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht ", në vlerën: 30.000 euro. Infrastruktura në përgjithësi dhe ajo rrugore në veçanti vazhdon të mbetet si njëri nga prioritetet tona investive. Me të tilla projekte e në bashkëpunim e bashkëfinancim me ministritë, vazhdojmë të punojmë për të mirën dhe zhvillimin e Rahovecit.

Nga ana e Kryetarit, z. Smajl Latifi, është formuar komisoni në përbërje prej 3 anëtarësh, komision ky i cili ka bërë vlerësimin e dëmeve në amvisëri, pas reshjeve që kapluan komunën e Rahovecit, komisioni pas përfundimit të punëve në terren, ka hartuar edhe një raport të detajuar lidhur me vlerën e dëmeve që janë shkaktuar në ekonomitë familjare.
Në bazë të një hulumtimi dhe anketimi që ju është bërë bizneseve në Kosovë nga INDEKSI I KONKURRUESHMERISË SË KOMUNAVE, ky indeks e rendit Rahovecin me zyrën e Regjistrimit të bizneseve (ARBK-në), të katërtën për shërbime të shpejta dhe efikase.

<u>Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator</u>

Ofrimi i mbështetjes për bizneset fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme, vazhdon të mbetet prioritet i yni me rëndësi, andaj gjatë kësaj periudhe janë vizituar shumë biznese të komunës së Rahovecit për të parë nga afër mbarëvajtjen e procesit të punës, nevojat dhe kërkesat e tyre drejt realizimit në të bërit biznes dhe mundësinë e të ofruarit ndihmë për zhvillimin e këtyre bizneseve me të gjitha kapacitetet që ne i posedojmë.

Aktualisht komuna jonë ka rreth 2350 biznese afariste, që operojnë në territorin tonë, prej tyre në periudhën 2020, në total biznese të reja të regjistruara në zyrën e ARBK-së janë 93 gjithsej.

<u>PËRKRAHJA E BIZNESEVE 2020</u>

| 2020 | 2020 |
|---|---|
| 7 biznese të përkrahura, prodhues të verës | 2 pika grumbulluese të qumështit të përkrahura |
| TOTAL PËRKRAHJE: | Vlera: 40,000.00€ |

Gjatë vitit 2020, kemi bërë përpjekje të vazhdueshme, për realizimin e shlyerjes së obligimit të taksave afariste, ku kemi proceduar për tek përmbaruesi 23 biznese të cilat nuk kanë përfunduar me kohë obligimet karshi komunës së Rahovecit.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Periudhën e fundit të vitit 2019 ka vazhduar ta karakterizojë mbikëqyrja dhe inkasimi i të hyrave në qira si dhe në taksa afariste komunale si dhe mbikëqyrja e objekteve afariste komunale, lidhja e kontratave të reja etj.

| Nr | Përshkrimi | Vlera në € |
|---|---|---|
| 1 | Të hyrat nga qiraja për periudhën janar-dhjetor 2020 | 71,106.31 € |
| 2 | Saldo e qirasë për periudhën janar-dhjetor 2020 | 5,539.53 € |

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Pëlqime pune për biznese për periudhën janar - dhjetor 2020 | 40 |

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Po vazhdon ndërtimi i shtëpisë për të moshuar për qëndrim ditor mbi qytetin e Rahovecit, tek "Epopeja e UÇK-së", ku Komuna e Rahovecit do t'i jep jetë si investitor me vlerë të kontratës: 89,979.00 euro. Në këtë qendër parashihet të ketë një sallë kolektive për qëndrim dhe aktivitete, dhoma për të pushuar si dhe teracë, projekti tashmë është në fazën përfundimtare;
- Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në Komunën e Rahovecit – Ky projekt është duke vazhduar, kemi përfunduar me krijimin e tri shtigjeve të ecjes në fshatrat Dejnë, Drenoc si dhe në pikën turistike Zhdrellë, punimet kanë përfunduar edhe në fshatin Krushë e Madhe për ndërtimin e projektit të Shtegut të Ecjes, "LULET E MARSIT". Gjatë vitit 2020 kemi filluar edhe me ndërtimin e shtegut të ecjes në Gradish ku është bërë hapja e trasesë, ky projekt pritet të përfundojë në fillim të vitit 2021.
- Investime në infrastrukturë, në Zonën ekonomike – Është themeluar me vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovë Zona Ekonomike-Parku Industrial në fshatin Opterushë në sipërfaqe pre 34,89/ha më datë 22.06.2018 ndërsa është licencuar më datë 27.01.2020 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Rrethimi Zonës Ekonomike është projekt i përfunduar në vlerë prej 65.944.00 euro
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht ky projekt është në bashkëfinancim me MZHR-në, është thuajse në përfundim dhe kap vlerën prej 47,813.17 euro.
- Renovimi i Tregut Ditor në Rahovec, projekt tashmë ky i përfunduar
- Renovimi i Stacionit të autobusëve dhe vendosja e kabinave inovative, është projekt që kap vlerën prej 176,710.50 euro, dhe tashmë stacioni ka marrë pamje të re, ndërkaq për trajtimin e pjesës së dytë prapa stacionit, punimet pritet të vazhdojnë në vitin 2021.
- Është lidhur kontrata për Hartimin e Planit Zhvillimor Ekonomik Lokal.

# DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Në fillim të vitit 2020, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka publikuar planin vjetor të punës, në të cilën është bazuar edhe në punën e bërë për të cilën do të raportohet në këtë raport pune për muajt; janar – dhjetor të vitit 2020.

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Pas miratimit të buxhetit për vitin 2020 nga Kuvendi Komunal i Rahovecit, Drejtoria për Urbanizëm ka përgatitur materialin për shpalljen e procedurave të tenderimit publik për hartimin e projekteve të ndryshme të Komunës së Rahovecit, procedura momentalisht është në fazën e përfundimtare të lidhjes së kontratës.
Poashtu, janë pranuar detyra projektuese për projekte të reja në komunën e Rahovecit, siç janë: Qendra e Mjekësisë Familjare në Opterushë, Mbulimi i pllatosë ku zhvillohet festivali "Anadrinia Jehon", shtigje të ecjes, renovimi i stacionit te autobusëve, rregullimi i shtretërve te përrenjve e projekte tjera me interes për qytetaret e komunës e Rahovecit.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, plan mjedisor që është hartuar për herë të parë në Komunën e Rahovecit, pasi është dalë në shqyrtim publik me lejen e Kuvendit të Komunës së Rahovecit është miratuar në seancën e marsit të Kuvendit Komunal Rahovec.

Të gjitha kërkesat për Leje Mjedisore Komunale janë shqyrtuar në afatin e paraparë ligjor. Nga 32 kërkesa, 31 janë të miratuara dhe 1 e refuzuar për vitin 2020.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Gjatë kësaj periudhe raportuese dhe tërë vitit 2020 mbikëqyrja e projekteve kapitale është bërë me kujdes nga kompania e kontraktuar. Operatori që ka për detyrë mbikëqyrjen e projekteve kapitale, vazhdimisht ka përpiluar raporte mbi punët e kryera si dhe raporte për Drejtorinë e Urbanizmit, si menaxhere e kësaj kontrate të rëndësishme për rritjen e cilësisë të punëve dhe zbatimit të kontratave për projektet kapitale të financuara nga Komuna e Rahovecit.

Kanë vazhduar aktivitetet dhe takimet me kompanitë konsulente për hartimin e Planit Zhvillimor dhe Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit. Plani Zhvillimor është në prag të finalizimit, jemi ne pritje te marrjes se pëlqimit nga Ministria Ekonomisë dhe Ambientit dhe të vazhdohet me procedurën e shqyrtimit publik dhe pastaj për aprovim në Kuvend, ndërkaq rreth hartimit të Hartës Zonale është pranuar drafti i parë i gjendjes ekzistuese dhe puna është duke vazhduar sipas planit të paraqitur në kontratë, një pjese e konsiderueshme e punës është përfunduar.

Bashkë me UN-Habitatin kemi vazhduar procesin e planifikimit dhe shpalljes së konkursit ndërkombëtar për hartimin e projektit ideor të sheshit qendror të qytetit ne Rahovec. Sipas marrëveshjes që kemi lidhur me këtë organizatë të specializuar të Kombeve të Bashkuara, planifikuesit urban janë vendosur në zyrat e Drejtorisë së Urbanizimit dhe në bashkëpunim me ta kemi përfunduar një pjesë të konsiderueshme të punëve të parapara, janë përfunduar matjet gjeodezike, është formuar ekipi komunal për planifikim, me vendim të Kryetarit, janë mbledhur të dhëna të pjesës ku planifikohet të ndërtohet sheshi, janë marrë informata gjeodezike dhe kadastrale, janë shpallur disa pjesë me vendim te Kuvendit Komunal, në interes publik për ndërtimin e sheshit, është bërë plani për mbajtjen e diskutimeve publike në fund të marsit, mirëpo për shkak të masave të Qeverisë së Kosovës për mbrojtjen nga Virusi Corona, janë shtyrë në një afat të papërcaktuar diskutimet me qytetarë dhe si formë alternative për të marrë mendimet e qytetareve, ne muajin qershor kemi publikuar nje pyetësor online, ne te cilën qytetaret kane mundësi te japin mendimet dhe idetë e tyre rreth vizionimit te konkursit ndërkombëtar per dizajnimin e sheshit qendror te qytetit te Rahovecit.

Janë shënuar me aktivitete simbolike ditët ndërkombëtare mjedisore, dita e ujit, dita e tokës dhe dita botërore e mjedisit. Ne ditën botërore te mjedisit, me 5 qershor, janë shpallur fituesit e konkursit për oborrin më të rregulluar, rrugën më të pastër etj.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

Projektimi i Sheshit Qendror të Qytetit – është shpallë konkursi ndërkombëtar pas një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës me mbështetje teknike nga UN-Habitati,. Konkursi është shpallur më 1 shtator dhe ka qenë i hapur deri më 16 nëntor 2020. Këtij konkursi i ka paraprirë një analizë e detajuar e zonës ku planifikohet të ndërtohet me të gjitha shpjegimet specifike të qytetit te Rahovecit. Konkursi është publikuar në shumë media të njohura botërore të specializuara të arkitekturës dhe është përshëndetë nga shumë shoqata të arkitektëve vendor dhe të huaj.

Procesi i trajtimit të objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit është duke vazhduar, janë pranuar kërkesa të shumta nga qytetarët për t'i legalizuar objektet e tyre, lëndët po shqyrtohen me kujdes, disa prej kërkesave janë futur në listën e pritjes për legalizim, pasi kështu është përcaktuar me ligjin për trajtimin e objekteve pa leje, pasi këto objekte janë të ndërtuara në tokë jo-ndërtimore apo për arsye tjera që përcaktojnë futjen në listën e pritjes, ndërkaq janë legalizuar objektet që i kanë plotësuar dhe i kanë përmbushur të gjitha kriteret për legalizim.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

Fokus i periudhës së fundit të vitit ka qenë përcjellja e punimeve në investime kapitale, sigurisht se prioritet kryesor ishte realizimi i buxhetit, jemi kujdesur që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikmëri.

Po në këtë periudhë raportuese kemi edhe punimin fitues në Konkursin Ndërkombëtar për Dizajnimin e Sheshit Qendror të Rahovecit. Arkitektët Thomas Boerendonk nga Holanda, Daniel Arce Chu nga Uruguaji dhe Nguyen Duy

Minh nga Vietnami, i kanë dhënë Rahovecit një dizajn ikonik dhe shumëfunksional ashtu siç e kërkuan qytetarët e komunës sonë.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Projekti i ndërtimit të tetë parqeve në Komunën e Rahovecit ka vazhduar edhe në këtë periudhë raportuese, Komuna e Rahovecit ka ndërtuar parqe në Gexhë, Malësi të Vogël, Pataqan të Poshtëm, Dobidol, Sapniq, Celinë, Zaqisht dhe Ratkoc. Do të ndërtohen edhe në shumë vendbanime të tjera në vitin 2021.
- Ka përfunduar projekti i Kompleksit të Dëshmorëve në Gradish/Xërxe, kushtuar dëshmorëve të komunës së Rahovecit.
- Ndërtimi i kullës prej guri per heronjtë Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi– Mici te vendi i rënies mbi fshatin Operushë, punimet janë afër përfundimit.
- Ka përfunduar ndërtimi i lapidarit "Altari i Lirisë", kushtuar martirëve të fshatit Guri i Kuq. Lapidari është zbuluar më 14 qershor, në ditën e Çlirimit të Rahovecit.
- Është lidhur kontrata për mbjelljen e mbi 10 mijë drunjve ne komunën e Rahovecit. Deri më tani nga kjo kontratë janë mbjellë rreth 7000 drunj, sipas kontratës i kemi të parapara edhe 7000 të tjerë, po ashtu do të lidhim edhe një kontratë gjatë vitit 2021 për t'i mbjellë 20.000 drunj, ashtu siç ka qenë zotim elektoral. Drunjtë janë mbjellur në qytetin e Rahovecit, në hyrje-dalje të Rahovecit, në Drenoc, Polluzhë, Kramovik, Guri i Kuq, Mrasor, çifllak, Dejnë, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhë, Xërxe, Fortesë, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Brestoc, Opterushë dhe Zaqisht. Drunjtë do te mbillen në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Ata drunj që kanë dështuar do të zëvendësohen.
- Komuna e Rahovecit momentalisht është duke investuar në trajtimin e shtretërve të lumenjeve në Krushë të Madhe, i financuar nga Komuna. Në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogel dhe Nagac, financuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Trajtimi i përrenjve në fshatrat Opterushë, Pataqan i Poshtëm, Malësi e Vogël dhe Polluzhë, bashkëfinancim me grantin e performancës dhe Komunës së Rahovecit. Probleme me shtretër të përroskave kemi në fshatrat Dejnë, Ratkoc, Celinë, Sapniq, Gexhë, nje përroskë e vogël ne Brestoc, pjesën e poshtë te lumit Duhllo ne Rahovec e përroska tjera të vogla, të cilat do t'i trajtojmë me një kontratë tjetër.
- Po trajtohen të gjitha lapidaret, vendrëniet e dëshmorëve, pllakat përkujtimore, platore të shtatoreve të heronjëve dhe busteve të dëshmorëve dhe dy shtëpitë muze, e Bedrush e Feim Gashit në Drenoc dhe Skënder Rexhepit në Mrasor, financuar nga Komuna e Rahovecit.
- Po rinovohen komplet varrezat e martirëve ne Celinë, financuar nga Komuna e Rahovecit.
- Këtë vit do të përfundojnë punimet në projektin e rregullimit të rrugëve me gurë ne pjesën e vjetër te qytetit. Përveç rrugëve ka ndriçim dhe trajtim të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferik.
- Projekti i Ndërtesës së Përbashkët për Banim Social ne Rahovec, pritet të përfundojë së shpejti. Mjetet janë të planifikuara. Vonesa është shkaktuar nga trashëgimi i borxhit të madh në atë projekt.

# DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2020, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktivitetesh përgjatë kësaj periudhe një- vjeçare. Në vazhdim DSHP ka raportuar për aktivitetet kryesore që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

<u>Tremujori i parë: janar, shkurt, mars</u>

- Gjatë sezonës dimërore, janë angazhuar dy kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit që vazhdimisht ishim në dispozicion të plotë në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve.
- Pas sezonës dimërore kemi filluar me këto projekte;

1. Projektin për furnizim me gypa nga PVC dhe,
2. Projektin për intervenime emergjente,
3. Projektin për investime dhe mirëmbajtje të hapësirave publike.
   - Është nënshkruar marrëveshje me UNDP për vazhdimin e projektit të rrjetit të kanalizimit në Kramavik, ky projekt tashmë është i përfunduar.
   - Gjatë vitit 2020 kemi pasur aktivitete infrastrukturore në rrjetin e kanalizimit në lagje të qytetit dhe në fshtarat e komunës sonë, përfundimi i kanalizimit të ujërave fekal në fshatin Potoqan i Epërm, kanalizimi i ujërave fekal në rrugën "Agim Qelaj".
   - Në bashkëpunim me zyrën komunale të komuniteteve kemi përfunduar kubëzimin e rrugëve në Xërxë, Çiflak dhe në Hoçë të Madhe.
   - Në projektin e rrugës 4 korsi, ka pasur aktivitete në teren, në të tri Lotot ka pasur gërmime, mbushje me zhavor, si dhe zgjerimet e segmenteve rrugore sipas projektit.
   - Në muajin janar kanë vazhduar punimet në rrugën Xërxë-Sapniq-Ratkoc, duke u bërë përgatitja e nënbazës me zhavor dhe elementeve tjera përcjellëse ndërsa në nëntor ka filluar asfaltimi.
   - Në shumicën e vendbanimeve kemi pasur aktivitete në ndërtim të trotuareve, të cilat janë përfunduar.
   - Gjatë janarit janë mbajtur takime me Operator Ekonomik që kanë kontratë me komunën tonë, të filloj puna e secilit në terren. Po ashtu është mbajtur një takim i bordit të ndërmarrjes publike lokale në stacion të autobusëve lidhur me regjistrimin e ri të ndërmarrjes dhe hapat se si duhet të lirohet një pozitë e një anëtarit të bordit për shkak të procedurave.
   - Është mbajtur një takim me përfaqësues të UNMIK-ut, lidhur me mbështetjen e projektit të kamerave në qytet, ky grand tashmë ka qenë i fituar dhe është bërë matja dhe piketimi i kamerave në qytet, nga UNOPS dhe UNMIKU, mirëpo për shkak të situatës pandemike ky projekt është shtyer që të bëhet implementimi vitin tjetër.

- Zyrtarisht është lëshuar uji i pijshëm për fshatin Pastasel, punët nga ana e komunës janë përfunduar dhe mbetet tek KRU Gjakova mirëmbajtja dhe furnizimi i rregullt.
- Gjatë muajit Mars kanë vazhduar punimet në segmentin e rrugës Rahovec-Potoqan i Poshtëm,
- Janë përfunduar trotuaret në disa vendbanime të komunës sonë, Rahovec, Drenoc, Malësi e Vogël, Ratkoc, Opterushë dhe Sapniq.
- Pas situatës së krijuar me virusin korona, gjatës muajit mars kemi angazhuar masa shtesë kundër virusit COVID-19, pas kësaj situate janë marruar disa masa në drejtim të pastrimit të qytetit dhe fshatrave, në larjen e rrugëve si dhe në heqjen e mbeturinave inerte.

**Tremujori i dytë: prill, maj, qershor**

Janë përfunduar punimet në projektet infrastrukturore, projekti i rrjetit të kanalizimit në:

- Fshatin Dabidol;
- 2 Segmente në fshatin Krushë e Madhe;
- 2 Segmente në Opterushë;
- 2 Segmente në Fortesë.

- Kanë vazhduar punimet në rrugën Xërxë-Sapniq-Ratkoc, është duke u bërë përgatitja e nën bazës me zhavorr dhe elementeve tjera përcjellëse, si dhe parapërgaditja për asfaltim.
- Punimet në ndërtimin e rrugës Rahovec-Hamoc-Fortesë, kanë vazhduar është asflatuar segmenti i parë prej 960 metrave brenda qytetit.
- Janë përfunduar punimet në projektet infrastrukturore, po vazhdon shtrirja e rrjetit te ri te kanalizimit në fshatin Xërxë në lagjen "Kryeziu" dhe në lagjen "Hamza" në Rahovec.
- Vazhdojnë punimet në ndërtimin e rrugës 4 korsi Rahovec-Xërxë, Loto 1 dhe Loto 3, vazhdimisht kemi probleme të instalimeve nëntokësore, për shkak të neglizhencës që kanë operatorët privat për të larguar instalimet e tyre ne brezin e fundit të rrugës, sidomos me operatorët Vala dhe Ipko, kemi vazhdimisht telashe.
- Kemi filluar me mirëmbajtjen e hapësirave publike në fshat dhe qytet, është dhënë rekomandim që deri me 23 maj të përfundon faza e parë e pastrimit të të gjithë hapësirave publike.
- Po vazhdon vendosja e ndriçimit publik, kemi filluar me Rahovec, me tre segmente në Krushë të Madhe, me 5 segmente në Malësi të Vogël, Dabidol, Çifllak, Reti, Mrasor, Hoçë e Vogël, Nagac, Drenoc dhe ende jemi ne proces dhe po ashtu do të vazhdojmë sipas planit të hartuar nga DSHP.
- Janë duke vazhduar punimet në projektet infrastrukturore, po vazhdon shtrirja e rrjetit të ri të kanalizimit në fshatin Bratatin dhe në fshatin Ratkoc.
- Kan vazhduar punimet në projektet infrastrukturore, projekti i rrjetit të kanalizimit ka përfunduar në fshatin Dabidol, është përfunduar në fshatin Krushë e Madhe dy segmente, dy segmente janë përfunduar në Opterushë, po vazhdon në Fortesë e kështu me radhë.
- Kanë vazhduar punimet në rrugën Xërxë-Sapniq-Ratkoc, duke u bërë përgatitja e nën bazës me zhavorr dhe elementeve tjera përcjellëse.

- Është bërë rehabilitimi i rrugëve në qytet, janë asfaltuar disa segmente rrugore në qytet.
- Ka vazhduar puna në shpërndarjen e gypave nga PVC sipas kontratës.
- Sa i përket kërkesave të shumta që kanë ardhur në Drejtorinë e Sherbimeve Publike, nga 1 janari 2020 deri më 20 qershor 2020, në DSHP janë adresuar 203 kërkesa të ndryshme që kanë të bëjnë me; çështje publike komunale, objektet e përkohshme dhe shfrytëzim i hapësirës publike si dhe kërkesa tjera nga qytetarët. Prej gjithsej 203 kërkesave 146 janë miratuar, 18 janë refuzuar, 34 janë në proces si dhe 4 janë pranuar si të ceduara nga drejtoritë.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Ka pasur aktivitete në terRen në rregullimin e infrastrukturës përmes intervenimeve emergjente, hapja e rrugës në fshatin Pataqan i Epërm, furnizim me gypa nga PVC, rregullimin e dy mureve mbrojtëse në lagjen e epërme në Rahovec, etj..
- Ka vazhduar ndërtimi i dy segmenteve rrugore në fshatin Drenoc.
- Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e trotuarit në rrugën Xërxë-Sapniq-Ratkoc.
- Kemi pasur vazhdimisht kërkesa në disa zona, poashtu përmes intervenimeve emergjente në komunën tone, kemi arrit disa pozicione të rregullohen.
- Janë zhvilluar takime me O.E që kanë kontratë me komunën e Rahovecit, lidhur me pastrimin e ambientit si dhe hapësirave tjera publike.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Punimet në ndërtimin e rrugës 4 korsi Rahovec-Xërxë, në loto 1 vazhdojnë punimet, është duke vazhduar pjesa e stabilizimit te rrugës në njërin segment, parapërgatitje për asfaltim.
- Po vazhdon ndriçimi publik, kompania për shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik, ka bërë instalimin e ndriçimit publik sipas prioriteteve, ka përfunduar ndërtimi në instalimet nëntokësore në rrugën "Bekim Isma", po ashtu është përfunduar puna në dy rrugë në qytet, si dhe kanë përfunduar punimet në fshati Reti dhe Mrasor, ku ka mbetur vetëm vendosja e orës nga ana e KEDS-it, janë duke vazhduar punimet në fshatin Çiflakë, si dhe në fshatin Drenoc
- Vazhdojnë punimet në projektin e ndërtimit të kanalit atmosferik në qytet.
- Semaforët e rinjtë në qytet kanë filluar të ndërtohen kornizat, afati për vendosjene semaforëve të rinjtë në qytet pritet të jetë 15 nëntor sipas kompanisë që ka sjellë planin dinamik të punës.
- Po ashtu pas lidhjeve të kontratave për ndërtimin e rrugëve ne 3 loto, ka filluar puna në qytet, Krushë të Madhe si dhe në Vrajakë.
- Janë rikthyer punimet në rrjetin e kanalizimit të dy kompanitë, punimet po vazhdojnë në disa vendbanime, sipas prioriteteve, Rahovec, Ratkoc.
- Kanë rifilluar punimet në asfaltimin e rrugës Fortesë – Celinë si dhe riparimet e disa gropave në qytet.
- Janë përfunduar punimet në murin mbrojtës në Brestoc, vazhdojnë në Rahovec në rrugën Vëllezërit Frashëri.
- Vazhdon punimet e rrugës Xërxë-Sapniq-Ratkoc, si dhe segmenti Sapniq-Nashpall.

- Vazhdojnë punimet në projektin e ndërtimit të kanalit atmosferik në qytet.
- Ka filluar puna në ndërtimin e semaforëve të rinjtë në qytet.
- Vazhdon ndërtimi i rrugëve ne 3 loto, janë duke vazhduar punimet në qytetin e Rahovecit në Krushë të Madhe si dhe në Vrajakë.
- Kemi pasur vazhdimisht kërkesa në disa zona, ku përmes intervenimeve emergjente në komunën ton\ë, kemi arrit disa pozicione të trajtohen me kujdes, sidomos në ujëmbledhëset e shiut në qytet, janë duke u trajtuar.
- filluar puna në ndërtimin e semaforëve të rinjtë në qytet, janë vendosur portalet për vendosjen e semaforëve të rinjë, janë bërë instalimet në udhëkryqin e dytë të rrugës.
- Kemi pasur vazhdimisht kërkesa në disa zona, ku përmes intervenimeve emergjente në komunën tonë, kemi arrit disa pozicione të trajtohen me kujdes, sidomos në ujëmbledhëset e shiut në qytet, janë duke u trajtuar.
- Suksesi më i madh i DSHP-së për vitin 2020 ka qenë vazhdimi i projektit "Ndërtimi i rrugës 4 shiritore (korsi) nga Rahoveci në Xërxë", kanali atmosferik në qytet si dhe 3 udhëkryqet me semaforë të rinjë, që njihet projekti më i madh deri më tani në komunën tonë.
- Tashmë Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në Rahovec, ju kemi ofruar shërbimet me kontratë me kompaninë për autobartje të veturave.

**<u>Sfidat e DSHP-së:</u>**

- Të adresuara në vazhdimësi ka kërkesa për rrjete të reja të kanalizimit, sfidë mbetet trajtimi iujërave fekale përmes impianteve apo gropave septike, ndërtimit të rrugëve lokale, kërkesa për rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara:
- Kërkesa për mirëmbajtjen e përrenjve dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane;
- Kërkesa të vazhdueshme për ndriçim publik në të gjitha vendbanimet, projekt tashmë i implementuar në shumë vendbanime dhe lagje të qytetit;
- Kërkesa të vazhdueshme për ndërtim të trotuarëve, në shumë vendbanime të Komunës sonë;
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka përcjellur gjatë vitit 2020 janë mbeturinat e amvisërisë që fatkeqësisht hidhen kudo, vend e pa vend, ku krijohen deponi ilegale;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë (Mrasor, Kaznik dhe Zatriq);

# DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

## HYRJE

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2019, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vehte aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.

### Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitetesh. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuara sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranim i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 për fermerët blegtor ( MBPZHR hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë kjo thirrje ka qenë e hapur nga: 15 janar deri më 15 shkurt).
- DBPZHR ka ndërmarr masat dhe është përgatitur me kohë për hapjen e thirrjeve nga MBPZHR për pagesa direkte (jemi kujdesur që të furnizohemi me material administrativ për të përballuar fluksin e madh të fermerëve),
- Sikurse vitin e kaluar, kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë e Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu leje e veçantë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra. E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces.
- Poashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 7 zyrtarë të rinjë me kontratë për punë specifike të cilët janë trajnuar dhe aftësuar për përdorim të programit të Ministrisë gjatë procesit të aplikimit dhe digjitalizimi i parcelave),
- Si vazhdimësi e projektit për përkrahje të fermerëve me mekanizëm bujqësor, në muajt janar dhe shkurt janë shpërndarë pajisje për fermerët përfitues me të cilet kemi lidhur kontratë. Poashtu është bërë verifikimi i

mekanizmave bujqësor të shprëndarë nga komuna jonë, duke u bazuar në vendimin AD-HOCK të Kryetarit të Komunës.

- Komisioni i caktuar nga kryetari për përzgjedhje të fermerëve përfitues të serrave për vitin 2019, publikimi i raportit me emra të fermerëve përfitues si dhe fillimi i ndërtimit të serrave duke lidhur kontratat me fermerë dhe duke pranuar participimin prej 20% të vlerës.
- Gjatë muajit shkurt si pasojë e erërave të forta janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në serra. Komisioni ka dal në terren për evidentimin e dëmeve të shkaktuar duke u bazuar në kërkesat e fermerëve, ka përpiluar procesverbal për secilin fermer dhe ka hartuar raport përfundimtar të cilin e kemi dërguar në Ministrinë e BPZHR-së së bashku me kërkesën për dëmshpërblim të fermerëve.

Tabela 1. Vlera e dëmeve të shkaktuara në serra nga erërat e fuqishme

| Nr. | Kultura | Sipërfaqe e dëmtuar | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Serra me sipërfaqe të ndryshme | 2,89 ha | 71,863.89 € |

Ne baze te aplikacioneve te pranuara nga fermerët tanë ne kuadër te Drejtorisë se bujqësisë per fazën e pagesave direkte-subvencioneve, ku kane aplikuar 3,117 fermer dhe kalukilmeve te bëra del qe komuna jone për vitin 2020 arrin të përfitoj rreth 9 milionë Euro.

| Sektori I Lavertarise | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Lloji I kulturës | Sip ne ha | Vlera ne Ha | Vlera e € |
| 1 | Grurë | 1,929.14 | 150.00 € | 289,371.00 € |
| 2 | Misër | 1,602.70 | 150.00 € | 240,405.00 € |
| 3 | Elb | 2.61 | 150.00 € | 391.50 € |
| 4 | Tersher | 48.93 | 150.00 € | 7,339.50 € |
| 5 | Theker | 2.62 | 150.00 € | 393.00 € |
| Gjithsej | | 3,586.00 | | 537,900.00 € |
| Sektori I Vreshtarise | | | | |
| Nr. | Lloji I kulturës | Sip ne ha | Vlera ne Ha | Vlera e € |
| 1 | Rrush | 2406.61 | 1,000.00 € | 2,406,610.00 € |
| 10 | Fidane të hardhisë | 148000 | 0.10 € | 14,800.00 € |
| Sektori I Vertarise | | | | |
| Nr. | Lloji I kulturës | Sasia ne Liter | Cmimi per Liter | Vlera e € |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Vere | 5,577,789.96 | 0.04 € | 223,111.60 € |
| Sektori I Perimkultures | | | | |
| 1 | Speca | 830.46 | 300.00 € | 249,138.00 € |
| 2 | Domate | 19.07 | 300.00 € | 5,721.00 € |
| 3 | Qepë | 188.90 | 300.00 € | 56,670.00 € |
| 4 | Hudhër | 33.47 | 300.00 € | 10,041.00 € |
| 5 | Patate | 227.87 | 300.00 € | 68,361.00 € |
| 6 | Tranguj | 10.43 | 300.00 € | 3,129.00 € |
| 7 | Karota | 11.50 | 300.00 € | 3,450.00 € |
| 8 | Rrepkë | 0.50 | 300.00 € | 150.00 € |
| 9 | Brokuli | 0.00 | 300.00 € | 0.00 € |
| 10 | Fasule | 1.55 | 300.00 € | 465.00 € |
| 11 | Pangjar | 0.00 | 300.00 € | 0.00 € |
| 12 | Lakër | 99.43 | 300.00 € | 29,829.00 € |
| 13 | Lulelakër | 9.77 | 300.00 € | 2,931.00 € |
| 14 | Presh | 4.21 | 300.00 € | 1,263.00 € |
| 15 | Spinaq | 0.22 | 300.00 € | 66.00 € |
| 16 | Marule | 1.26 | 300.00 € | 378.00 € |
| Gjithsej | | 1438.64 | Ha | 431,592.00 € |
| Kungullore | | | | |
| 1 | Shalqinj | 205.36 | 300.00 € | 61,608.00 € |
| 2 | Pjepër | 57.61 | 300.00 € | 17,283.00 € |
| 3 | Kunguj | 18.07 | 300.00 € | 5,421.00 € |
| 4 | kungull i Gjelbert | 319.46 | 300.00 € | 95,838.00 € |
| Gjithsej | | 600.50 | Ha | 180,150.00 € |
| Sektori i Pemtarisë | | | | |
| 1 | Dardhë | 6.58 | 400.00 € | 2,632.00 € |
| 2 | Dredhëz | 0.66 | 400.00 € | 264.00 € |
| 3 | Kumbull | 40.65 | 400.00 € | 16,260.00 € |
| 4 | Mollë | 10.01 | 400.00 € | 4,004.00 € |
| 5 | Arra | 30.08 | 400.00 € | 12,032.00 € |
| 6 | Lajthi | 4.94 | 400.00 € | 1,976.00 € |
| 7 | Ftoj | 0.92 | 400.00 € | 368.00 € |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Mjeder | | 1.01 | 400.00 € | 404.00 € |
| 9 | Pjeshkë | | 1.07 | 400.00 € | 428.00 € |
| Gjithsej | | | 95.92 | Ha | 38,368.00 € |
| Sektori I Blegtorisë dhe shpezetarise | | | | | |
| 1 | Bletë | | 6,802.00 | 15.00 € | 102,030.00 € |
| 2 | Lopë | | 2,598.00 | 90.00 € | 233,820.00 € |
| 3 | Dhi | | 834.00 | 20.00 € | 16,680.00 € |
| 4 | Dele | | 8,886.00 | 20.00 € | 177,720.00 € |
| 5 | Pula vojëse | | 74,300.00 | 0.50 € | 37,150.00 € |
| | | Gjithsej | | | 567,400.00 € |
| Bujqesia Organike | | | | | |
| Nr. | Lloji I kulturës | Sip ne ha | | Vlera ne Ha | Vlera e € |
| BMA | | | 14.84 | 500.00 € | 7,420.00 € |
| | | | | | |
| | | | | TOTAL | 4,407,351.60 € |

<u>Tremujori i dytë: prill, maj, qershor</u>

- Fermerët tanë në fund të marsit dhe fillim të prillit janë ballafaquar me temperatuar të ulëta dhe ngrica, ku si pasojë e kësaj janë dëmtuar shumë kultura perimtare me theks të veçantë në patate dhe kunguj. Komisioni i formuar me vendim të kryetarit ka dalur në terren dhe ka bërë vlerësimin e dëmit të përmbledhur në raport detal për secilin fermer.

<u>Tabela 2. Vlera e dëmeve të shkaktuara nga ngricat pranverore</u>

| Nr. | Kultura | Sipërfaqe e dëmtuar | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Patate | 117.18 ha | 197,741.41 € |
| 2 | Kunguj | 2.37 ha | 4,740.00 € |
| Gjithsej | | 119,55 ha | 202,481.41 € |

- Në bashkëpunim me shoqatën e bletarëve është mbajtur trajnimi për fermerë bletarë të komunës sonë, në këtë trajnim bletarët e komunës sonë u njohën për së afërmi për zgjidhjen e problemeve që shkaktohen te bletët.

- Poashtu në bashkëpunim me kompaninë ALMAKO-QFPB është organizuar trajnim për blegtorët e komunës së Rahovecit me ekspert nga Austria të kësaj fushe. Temë e trajnimit ishte "Menaxhimi i Silazhit dhe standardet e BE-së për ndërtimin e stalave të gjedhit"
- Në bashkëpunim me organizatën IADK me të cilën kemi të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të projektit për të Ri-atdhesuarve kemi bashkëfinancuar 6 fermerë përfitues në mekanizëm bujqësor.
- Kemi zhvilluar procedurat në bashkëpunim me zyrën e prokurimit për shpallje të tenderit për: Konsulencë dhe Hartim i projekteve për fermer, është lidhur kontrata dhe jemi në pritje të hapjes së thirrjes për grante nga MBPZHR.
- Në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës Nr.712//72, 713/72, 714/72 dhe 715/72 Komisoni për vlerësimin e dëmeve në bujqësi të shkaktuara nga breshëri dhe shirat e rrëmbyeshëm me datë 19 dhe 20 Maj 2020. Komisioni ka bërë mbledhjen e të dhënave në terren dhe ka përgatitur raport detal i cili është dorëzuar në MBPZHR së bashku me kërkesën për dëmshpërblim për fermerët.

Tabela 3. *Vlera e dëmeve të shkaktuara si dhe sipërfaqet e dëmtuara.*

| Nr. | Kultura | Sipërfaqe e dëmtuar | Rendiment i dëmtuar në kg | Vlera në € |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Perimekulturë | 233.55 | 6,483,100 | 1,636,989.00 € |
| 2 | Lavërtari | 150.08 | 444,512 | 102,346.08 € |
| 3 | Vreshtari | 368.84 | 2,767,124 | 890,454.00 € |
| 4 | Pemëtari | 4.20 | 28,772 | 11,311.80 € |
| TOTAL | | 756.67 | | 2,641,100.88 € |

- Zyrtarët e DBPZHR-së gjatë kohës së pandemisë kanë qenë vazhdimisht në terren duke vizituar fermerët dhe duke kërkuar nga ata që ti respektojnë rekomandimet e IKSHPK-së. Përveç kësaj janë grumbulluar të dhëna mbi humbjet që iu janë krijuar fermerëve si shkak i mungesës së tregut në kohën e pandemisë për shitjen e produkteve të gatshme.
- Duke pasur parasysh nevojën për shitjen e produkteve të gatshme të prodhuara nga fermerët tanë, kemi bërë kërkesë të vazhdueshme për hapjen dhe funksionalizimin e tregut të gjelbërt, ku kemi dërguar kërkesë zyrtare në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Poashtu kemi hartuar planin operativ për mbarëvajtjen e shitjes së produkteve duke iu përmbajtur në përpikshmëri rekomandimeve të IKSHPK-së.
- Për humbjet që iu janë shkaktuar fermerëve tanë si pasojë e pandemisë COVID-19, kemi adresuar kërkesë zyrtare Qeverisë së Republikës së Kosovës për përfshrije të fermerëve në Pakon Emergjente Fiskale
- Janë inicuar procedurat e prokurimit për shpallje të tenderit për projektin " Ndërtimi i serrave me participim 80%-20%'

**Tremujori I tretë: korrik, gusht, shtator**

Tremujori i tretë ka filluar me përgatitjet rreth fushatës së korrje- shirjeve. Jemi përgatitur me kohë dhe është formuar shtabi i cili ka monitoruar dhe ka mbajtur evidenca, duke e përmbyllur me raport përfundimtar detal lidhur me rendimentin dhe cilësinë e grurit. Pasi kanë përfunduar të gjitha procedurat rreth projektit të "Përkrahjes së fermerëve me mekanizëm bujqësor", në muajin shtator ka filluar edhe shpëndarja e tyre. Paraprakisht kemi lidhur kontrata me operatorë të ndyshëm për furnizim me pajisje, poashtu janë ftuar fermerët që të lidhin kontratë me komunën dhe janë kryer edhe participimet e fermerëve, duke u bazuar në marrëveshjen me komunën. Nga 990 fermerë të cilët kanë aplikuar gjatë kësaj thirrje, në listën e përfituesve kanë qenë gjithsej 789 përfitues.

| Mekanizma | Sasia e përfituar |
|---|---|
| Motokultivator | 441 Copë |
| Frezë(1.8m) | 91 Copë |
| Plugjë dy Krahësh | 55 Copë |
| Mulqera per Hardhi | 15 Copë |
| Spërkatëse 500L | 96 Copë |
| Makinë Mjelëse | 5 Copë |
| Kultivator | 46 Copë |
| Frezë(1.6m) | 32 Copë |
| Shpërndarëse Plehu | 7 Copë |
| Pompë për Ujitje | 1 Copë |
| TOTALI | 789 Copë |

Po ashtu gjatë muajit Shtator 2020 për herë të parë është hapur thirrja për Komore ftohëse dhe Laktofriz të cilat shërbejnë për ruajtjen e produkteve bujqësore, ku nga 16 aplikacione të cilët kanë aplikuar në këtë thirrje për Komore Ftohëse V=25$m^3$ si dhe Komore Ftohëse V=40$m^3$, të gjithë janë përfitues.
Gjithashtu edhe nga 39 aplikacione të cilët kanë aplikuar për Laktofriz 300L si dhe Laktofriz 500L, të gjithë janë përfitues.
Sektorët të cilët do të përkrahen përmes kësaj thirrje janë: Pemëtaria; Perimekultura; si dhe Blegtoria.

| Komore Ftohëse | Sasia e përfituar |
|---|---|
| Komore Ftohëse V=25 $m^3$ | 11 |
| Komore Ftohëse V=40 $m^3$ | 5 |
| TOTALI | 16 |

| Laktofriz | Sasia e përfituar |
|---|---|
| Laktofriz 300L | 26 |
| Laktofriz 500L | 13 |
| TOTALI | 39 |

Përkrahje fermerëve për përpunuesit e pemëve dhe perimeve

Ndërkaq gjatë muajit Shtator 2020 është hapur thirrja për aplikim për të gjithë përpunuesit e pemëve dhe perimeve si dhe ordinancave veterinare për të përfituar nga skema e mbështetjes e cila eshte orfruar përmes subvencioneve me mjete financiare.
Qëllimi i kësaj thirrje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për përpunuesit e pemëve dhe perimeve, që bëjnë përgatitjen, ruajtjen dhe konservimin e tyre duke nxjerrë nënproduktet, sikurse janë: Pekmezi, reqelnat, turshit, ajvari etj

Tremujori i katër: tetor, nëntor, dhjetor

Gjatë kësaj periudhe, kryesisht aktivitetet ishin rreth shpërndarjes së pajisjeve bujqësore për fermerë dhe theks i veçantë kishte përcjelljen e investimeve kapitale.

Pranimi dhe përgjigjet ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët si dhe shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: vërtetim për fermerë, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë etj.
Pikërisht në këtë periudhë kohore kemi qenë në komunikim të vazhdueshëm me zyrtarët në AZHB ku sipas kërkesave të tyre kemi plotësuar dokumentacion për fermer për fazën e pagesave direkte me të vetmin qëllim që mos të ndëshkohen fermerët punëtor të komunës sonë.

Projektet e investimeve kapitale

Qysh në fillim të vitit kanë rifilluar punimet në projektet ku kemi kontratë me Operatorët Ekonomik.

- Ka vazhduar ndërtimi i serave të pa përfunduara pas shpalljes së rezultateve nga komisioni, duke përmbushur kontratën aktive në kuadër të kësaj kontrate janë ndërtuar 15 serra 3 ari dhe 11 sera 5 ari.

Ne kuadër të investimeve kapitale në përmirësim të infrastrukturës bujqësore kryesisht është investuar ne ndërtimin e kanaleve te kullimit.

**Kanali i Kullimit – Xërxë**

Vlera e Kontratës: 148.325.14€. Ky projekt është në përfundim, tani është duke u punuar në krahun 3. Implementimi i këtij projekti eliminon vërshimin e tokave bujqësore në këtë vendbanim.

**Kanali i Kullimit Ratkoc – Gexhë, Malësi e Vogël**

Kontrata është lidhur në vitin 2013, por për shkak të disa vështirësive të hasura gjatë punimeve ka pasur ngecje, dhe si pasojë punimet e zotuara nuk janë realizuar sipas kontratës në kohën optimale.
Vlera e Kontratës: 497.981.79€. Ky projekt është tani në përfundim sipas kushteve të parapara në kontratë. Implementimi i këtij projekti ndihmon në eliminimin e vërshimeve të tokave bujqësore që kalon nëpër këto vendbanime.

**Ulja e Niveletës së përroit në Fshatin Celinë**

Ky projekt tashmë vetëm ka përfunduar sipas kushteve të parapara në kontratë. Implementimi i këtij projekti të realizuar ka ndikuar që në këtë vit të shmangim vërshimet e mundshme duke ruajtur mbi 200 ha të tokës bujqësore.

**Tregu i Rrushit**

Projekt i bashkëfinancuar me MBPZHR-në "Ndërtimi i infrastrukturës për festivalin dhe tregun e rrushit" ka përfunduar me shumë sukses duke ju përmbajtur kontratës së nënshkruar me OE. Në bazë të këtij projekti i cili ka filluar nga qeverisja e kaluar, janë zhvilluar punimet e kanalizimit atmosferik, punimet sipërfaqësore në parter si dhe është bërë ndërtimi i 32 tezgave të drurit të cilat shërbejnë për promovimin dhe shitjen e produkteve bujqësore.

**Rrugët fushore**

Gjatë mandatit tonë, ne si drejtori e BPZhR-së duke parë si vështirësi qasjen e fermerëve nëpër fermat e tyre, e kemi parë të arsyeshme dhe të domosdoshme që tu gjendemi pranë me rregullimin e rrugëve fushore që tu mundësohet qasja më e lehtë në aktivitetet e tyre nëpër ferma.
Segmentet e punuara të rrugëve fushore në komunën e Rahovecit si dhe fshatrat:

| Nr. | Vendbanimi | Rruge Fushore "Meter" |
|---|---|---|
| 1 | Rahovec | 13,375 |
| 2 | Bellacerkë | 3,703 |
| 3 | Xërxe | 2,454 |
| 4 | Celine | 3,400 |
| 5 | Krushe e Madhe | - |
| 6 | Hoqe e Vogel | 2,460 |
| 7 | Nagavc | 1,600 |

| | | |
|---|---|---|
| 8 | Brestoc | 2,200 |
| 9 | Hoqe e Madhe | - |
| 10 | Zoqishte | 1,860 |
| 11 | Opterushe | 3,680 |
| 12 | Retije | 1,150 |
| 13 | Retije e Ulet | - |
| 14 | Sapniq | 1,800 |
| 15 | Pataqan Ulet | 777 |
| 16 | Pataqan I Eperm | 1,320 |
| 17 | Naushpall | 960 |
| 18 | Drenoc | 2,189 |
| 19 | Senoc | 2,833 |
| 20 | Pastaselle | 2,667 |
| 21 | Polluzhe | 2,083 |
| 22 | Kaznik | 1,400 |
| 23 | Çiflak | 3,012 |
| 24 | Kramovik | 1,047 |
| 25 | Petkiviq | 637 |
| 26 | Mrasor | - |
| 27 | Dobidol | 1,694 |
| 28 | Dejnë | 3,011 |
| 29 | Ratkoc | 5,624 |
| 30 | Bratotin | 1,580 |
| 31 | Vrajakë | 1,710 |
| 32 | Radoste | 3,195 |
| 33 | Gexhë | 3,924 |
| 34 | Zatriq | 2,600 |
| | TOTALI | 79,945 |

**Sektori i Pylltarisë**

Edhe sektori i pylltarisë kishte aktivitetet e planifikuara gjatë kësaj periudhe raportuese. Qysh në fillim është hartuar plani operativ për pyllëzimin e sipërfaqeve të reja. Ky plan parasheh të mbillen 20 ha me pyje të reja të llojeve: Pishë e Zezë, Bung dhe Dushk.

Sikurse sektorët e tjerë edhe ky sektor e pësoi nga pandemia COVID-19. Pikërisht në kohën e ndalesave qytetarët vërshuan malet për të kaluar kohën ku kanë ndezur zjarre dhe nga pakujdesia e tyre janë përfshirë shumë sipërfaqe me zjarr në pyje, duke shkaktuar dëme të konsiderushme dhe duke djegur mbi 250 ha me pyje të ulëta.

Në këtë periudhë rojet e pyjeve ishin mjaft aktiv në mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve, duke kryer detyrën ndaj keqbërësve dhe prerësve ilegal të drunjëve ku në bazë të kësaj janë lëshuar 12 fletëparaqitje në gjykatë dhe janë realizuar 8 raste gjygjësore.

**PËRFUNDIM**

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Duke u bazuar në planin e punës kemi devijim nga ajo çka ne kemi planifikuar pasi që periudha e parë që përfshinë muajt janar, shkurt dhe mars kemi paraparë që të zhvillohet procesi i aplikimit për pagesa direkte-subvencione në kuadër të MBPZHR-se, dihet që akoma nuk është hapur thirrja dhe për këtë arsye kemi mospërmbushje të planit të punës me raportin për këtë periudhë. Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm.

Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermer në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre. Poashtu nga fermerët kemi marr informata për pajisjet që iu nevoiten atyre, ku ne do të i përfshijm në thirrjet për aplikim që do te hapen në gjashtëmujorin e dytë. Përveç fermerëve individual kemi vizituar dhe takuar edhe përpunuesit e rrushit – Bodrumet. Kemi pare nga afër dhe kemi ndikuar qe procesi i pranim-dorëzimit te rrushit te kryhet pa pengesa. Edhe këtë vit nuk janë shfaqur probleme ne grumbullim te rrushit. Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe të pandemisë stafi i DBPZHR ishte i reduktuar, mirëpo kjo nuk ka ndikuar që fermerët tanë të ngecin në marrjen e shërbimeve të nevojshme në drejtorinë tonë.

Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionist të fushave, me theks të veçant inxhinier të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.

# DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

**Aktivitetet në periudhën: janar- dhjetor**

Fillimi i vitit të ri është karakterizuar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Qysh në fillim të vitit 2020 i jemi qasur punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për vitin 2020. Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

| Sektori: | Lëndët: | Shuma € |
|---|---|---|
| Kadastër dhe Pronë | 630 | 15,115 |
| Gjeodezi | 3,400 | 10,870 |
| Referenti | 3,200+102 L.Z. | 14,650.52 |
| Totali | 7,230+102 L.Z. | 40,635.52 |

**Synimet kryesore të KGJP-së për vitin 2020 ishin:**

- Themelimi dhe funksionalizimi i plotë i Komisionit për Komosacion.
- Zgjerimi i stafit të DGJKP-së-së me kuadrin e nevojshëm, të zyrtarit për pranimin e lëndëve.
- Vazhdimi i skenimit masiv të materialit të paskenuar.
- Vazhdimi i migrimit të zonave të pamigruara në ZK Rahovec.
- Ofrimi i shërbimve tona edhe në dy pika lokale në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc gjatë aplikimeve të subvencioneve.

**Qëllime kryesore kishim:**

- Ngritjen e profesionalizmit të gjeodetëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve sa më profesionale.
- Mirëmbajtjen e Kadastrit sipas detyrës zyrtare.
- Zhvillimin e aktiviteteve të shumta kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Funksionimin sa më të mirë të sektorëve të Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës.
- Ofrimin e produkteve- shërbimeve në kohë reale.

**Objektivat tona të përhershme, që karakterizuan edhe këtë vit, janë:**

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve- produkteve sa më profesionale gjeodezike dhe konformë akteve nënligjore të Agjensionit Kadastral të Kosovës.
- Zvogëlimi në kohë të arsyeshme të zgjidhjes së lëndëve të Gjeodetëve.
- Bashkëpunimi me operator privat të licencuar të gjeodetëve.
- Integrimi i zonave të pa migruara në sistem.

**AKTIVITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONË GJATË VITIT 2020**

- Kemi përgatitur material të nevojshëm për mbledhjen e Kuvendit Komunal, i cili është mbajtur me datën 26 Janar 2020 në të cilën kemi shpallur interes të përgjithshëm në Z.K. Rahovec dhe në Z.K. Xërxë për hapje të rrugës publike.
- Me kërkesë zyrtare të inspektoratit kemi dalë në terren dhe kemi inqizuar gjendjen në Z.K. Cifllak, me të cilën është konstatuar uzurpim i pronës publike, janë nxjerr vendime dhe është kërkuar nga uzurpatori që ta lirojë pronën publike, me kërkesë të drejtorisë për Ekonomi kemi nxjerr historiatin e parcelës për Zonën Ekonomike dhe e njejta i është dërguar ministrisë përkatëse për kompletimin e lëndës.
- Avokati i komunës me kërkesë zyrtare ka aplikuar për ekzekutimin e vendimit të Kuvendit të Komunës në lidhje me këmbimin e pronës ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Agjensionit pyjor të Kosovës në sipëraqe prej 60 ari në Z.K. Apterushë për ndërtimin e Kullës së Gurit në vend rrënjën e Herojve të Kosovës "Toni e Mici" me bashkëluftëtarë.
- Është mbajtur trajnimi i punëtorëve nga AKK në Prishtinë në lidhje me pranimin e lëndëve nga drejtoria e Urbanizmit në lidhje me legalizimin e objekteve pa leje dhe rregjistrimi i tyre në librat kadastral, ky proces ka përfunduar dhe tashmë lëndë po pranohen dhe po regjistrohen.
- Përgjigje me shkrim në lidhje me kërkesat e avokatit të Komunës në lidhje me lënde që janë në proces në gjykatë.
- Me kërkesë zyrtare të drejtorisë së bujqësisë kemi përfunduar nxjerrjen e koordinatave për rrugë fushore për disa Zona Kadastrale në nivel Komune.
- Takim me planer në drejtori të Urbanizmit në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me drejtorin tonë në lidhje me materialin që lidhet me projektimin e Sheshit Qëndror të Qytetit.
- Me kërkesë zyrtare të Inspektoratit kemi dalë në terren në lidhje me vërtetimin e pretendimeve për uzurpim të pronës publike në tre zona kadastrale në Apterushë, Brestoc dhe në Krushë të Madhe.
- Takim pune në lidhje me harmonizimin e Rregullorës Komunale dhe Udhëzimeve Administrative të AKK-së që lidhen direkt me shërbime- produkte që ofron drejtoria jonë.
- Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së palëve në lidhje me faljen e pronës private për hapje të rrugës dhe përkthimi në pronë publike në Z.K. Rahovec.
- Trajnimi dhe rilicencimi i punëtorve nga AKK-ja në lidhje me ofrimin e shërbimeve edhe në dy zona kadastrale në Ratkoc dhe në Krushë të Madhe në kohën e aplikimeve për subvencione bujqësore.
- Nxjerja e aktvendimeve për uzurpim të pronës publike.
- Me kërkesë zyrtare të Këshillit të fshatit Malësi e Vogël kemi dal në terren, kemi kufizuar parcelën, e cila po destinohet për interes të përgjithshëm publik për nevojat e fshatit.
- Inqizimi i rrugës publike nga rrethi në hyrje te qytetit në drejtim të rrugës tranzite Rahovec-Malishevë në anën e djatht të rrugës, ku është planifikuar të zgjerohet edhe me një shirit, dhe inqizimi i rrugës Rahovec-Xërxë të dy anë të rrugës sipas projektit të rrugës për katër korsi, ku sipas inqizimit ka rezultuar me uzurpim të pronës publike në zonën kadastrale në Bërnjak dhe në Fortesë. Me kërkesë zyrtare të drejtorisë së arsimit kemi përfunduar dokumentacionin e kërkuar për 7 zona kadastrale në lidhje me situacionin e terrenit, çertifikatat e pronës dhe kopje plani për shkolla dhe çerdhet publike.

- Kemi themeluar me vendim të kryetarit te komunës z. Smajl Latifi Komisionin për identifikimin dhe lirimin e pronave të uzurpuara komunale.
- Me kërkesë të AKK-së kemi vendosur që të dërgojmë pesë zona kadastrale për rindërtim në nivel komune. Përgjigje në kërkesat e parashtruara nga Avokati i Komunës. Pas inqizimit të gjendjes faktike në terren në katër zona kadastrale Rahovec, Bërnjak, Fortesë dhe Xërxë përgjatë rrugës Rahovec- Xërxë janë evidentuar uzurpime të pronës publike dhe janë nxjerr Aktvendime për uzurpim dhe i janë dorëzuar palëve sipas ligjeve në fuqi. Me kërkesë zyrtare nga drejtoria e shërbimeve publike kemi nxjerr koordinata dhe kemi kufizuar shtatë parcela në rrugën që është në ndërtim e sipër Rahovec, Hamoc dhe Fortesë. Me punëtorë të IT-së i kemi funksionalizuar edhe dy zyret mobile në dy zona kadastrale në ZK Krushë e Madhe dhe Ratkoc për aplikimin e subvencioneve bujqësore. Me kërkesë zyrtare nga inspektorati kemi dal në terren në disa zona kadastrale për vërtetim të pronës publike. Me kërkesë nga kryetari i fshatit Celinë kemi pregatitur situacion terreni, kopje plani dhe certifikatën e pronësisë në lidhje me varrezat e martirëve.
3. Kurse si pikë e tretë është diskutuar edhe vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, ku sipas kryetari tët komunës gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, gjithmonë flas duke u bazuar në bazë të informatave të cilat më vinë nga stacioni policor në Rahovec. Nuk kemi ndonjë rast për të ju informuar me diçka e cila do ja vlente dhe do hynte në atë që ne e quajmë prishje të gjendjes së sigurisë në komunën tonë.
Kurse Komandanti i policisë z. Fazli Morina raportoi në pika të shkurtra sa i përket sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu edhe në këto ditë të muajve raportues Maj – Qershor dhe deri më sot në muajin korrik gjendja vazhdon të mbetet e qetë dhe stabile. Do i referohem në pika të shkurta për disa nga ngjarjet që kanë ndodhur: Në muajin qershor janë shqiptuar nga ana e policisë rreth 13 gjoba për prishje të rendit dhe qetësisë publike, sepse sipas ligjit tani deri shumen prej 500 € ka drejtë policia të i gjobit pa shkuar rasti në gjykatë. Sa i përket lëmosh kërkueseve njësiti ynë përkatës merret me ta, por për fat të mirë këta lëmoshë kërkues nuk janë nga komuna jonë, shumica janë nga komunat e tjera. Kurse sa i përket organizimit të dasmave, tani me vendimin e fundit deri në 50 persona lejohet mbajtja e ahengjeve, prandaj ne deri më tani nuk kemi marrë ndonjë masë në familjet të cilët kanë organizuar dasma. Siguria në trafik deri në një masë është mirë, ne e kemi planin operative për sigurinë në trafik të cilin a zbatojmë. Kurse sa i përket zbatimit të vendimit për mbylljen e kafiterive nga ora 21:00 për shkak të pandemisë, lirishtë mundem të them se ky vendim nuk është duke u zbatuar, ne dakorduar me kryetarin e komunës që ti paralajmërojmë pronarët e kafiterive, por ata nuk janë duke kuptuar si duket. Prandaj mendoj se duhet të shkohet me masën e ndëshkimit ashtu siç është e paraparë me vendim të cilin e ka mare qeveria e Republikës së Kosovës.
**Përfaqësuesi i FSK-së** diskutoi sa i përket problemit të lëmosh kërkuesve, ku e ceku se lëmosh kërkuesit këtë e kanë bërë si profesion ose punë, prandaj është mirë që mos të përkrahen ata me mjete financiare sepse nëse ne i japim atyre atëherë jemi duke i përkrahur në veprimin e tyre. Kishte me qenë mirë që të bëhet vetëdijesimi i tyre me anë të ndonjë ligjërata si nëpër bashkësi fetare, shkolla etj. Kurse sa i përket zjarrfikësve ne si FSK kemi mundësi që të organizojmë një trajnim me Policin e Kosovës, zjarrfikësit dhe me nga një përfaqësues të lagjeve dhe fshatrave, ku do të bëjmë një trajnim se si bëhet fikja e zjarrit ose shpëtimi nga zjarri deri sa të vinë zjarrfikësit.
**Shahip Saha** e ceku se në Komunën e Rahovecit nuk ka pasur asnjëherë lëmosh kërkues, i kam 70 vite dhe nuk kamë hasur, ndoshta kjo ndodhë edhe për shkak të mentalitetit që e kanë njerëzit e komunës sonë. Por kjo dukuri në kohët e fundit si duket pak ka ndryshuar sepse ka disa prindër të papërgjegjshëm që i lëshojnë fëmijët e tyre për të kërkuar, prandaj kishte me qenë mirë që policia në planin tyre operativ të i identifikojnë këta prindër dhe të ju tërhiqet vërejtje.
**Kryeimami i Bashkësisë** Islame në Rahovec z. Nysret Abazibra potencoi se institucionet i bashkësisë fetare, me këtë dukuri janë duke u ballafaquar çdo ditë dhe më së shumti, po ashtu janë duke mbajtur fjalime sa i përket lëmosh kërkuesve, këta persona janë duke na penguar çdo ditë që ti kryejmë ritet fetare. Nuk janë vetëm fëmijët por prindër së bashku me fëmijë, si institucion i bashkësisë fetare disa herë këtyre personave i kemi dalë në ndihmë me gjëra ushqimore, por ata

përsëri vazhdojnë që të vinë dhe të na pengojnë, po ashtu ne jemi ne gjendje edhe në të ardhmen që ti ndihmojmë me gjëra ushqimor. Prandaj kishte me qenë mirë që me këtë kategori të ndermirët diçka ma serioze e jo vetëm këshilla sepse këshilla jemi duke dhënë shumë herë.

**Drejtori i Emergjencës** në Rahovec z. Hasan Përboqi e ka paraqitur Raportin për Planin Operativ për Sezonin Veror korrik – gushtë. Ku e ceku se Njësia e zjarrfikësve në këtë vit është shumë më e kompletuar se sa në vitin e kaluar, jemi pajisur me disa kamion të rijnë për zjarrfikës, dhe me disa vegla të nevojshme për zjarrfikësit. Po ashtu komuna e Rahovecit ka investuar rreth 12,000.00 € për zjarrfikës ku i ka ndërtuar disa garazhe për kamion në mënyrë që të mos ekspozohen jashtë. Ne në periudhën 6 mujore të vitit 2020 kemi pasur rreth 98 zjarre, por për fat të mirë asnjëri nuk ka pasur dëme në njerëz por vetëm dëme materiale. Po ashtu ne si drejtori për çdo vit gjatë fillimit të sezonit të verës i njoftojmë qytetarët e komunë sonë me disa fletushke se si të mbrohen nga zjarret deri sa të vije ekipi i zjarrfikësve, këto fletushke shpërndahen në të gjithë komunitetin e komunës sonë.

4. Si pik e katërt e rendit të ditës është diskutuar: Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar. Me këtë rast kryetari i komunës z. Smajl Latifi para anëtarëve të KKSB tha: Kjo është një pikë e cila na ka ardhur edhe këtë vit si propozim nga OSBE-ja, ne vitin e kaluar i kemi mbajtur disa aktivitetet si KKSB në bashkëpunim me OSBE-në, ku janë organizuar lojëra të ndryshme sportive. Por siç e dini të gjithë këtë vit nuk kemi mundësi të bëjmë diçka të tillë sepse shkaku është pandemia, por shpresoj se me kalimin e kësaj pandemi do të organizohet diçka e tillë në mes komuniteteve që jetojnë në komunën e Rahovecit. Ne si komunë për fat të mirë nuk kemi ndonjë problem ndër etnik deri më tani dhe besoj se kjo frymë e mirë e bashkëpunimit do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Unë si kryetar i komunës do të shkoj së shpejti të e vizitoj Hoçën e Madhe ku jeton komuniteti serb, ku do të shohë mos kanë ndonjë kërkesë nga ne si komunë.

**<u>Konkluzion nga Kryetari i Komunës për mbledhjen e datës 09.07.2020</u>**

1. *Policia dhe inspektorati të vihen në lëvizje dhe të zbatojnë ligjin ndaj atyre të cilët e shkelin ligjin dhe vendimet e komunës, ne si komunë dhe si KKSB duhet të i japim mbështetje në mënyrë që të respektohet në përpikëri ligji.*
2. *Konkluzioni i dytë është që jemi pro propozimit të përfaqësuesit të FSK-së që të bëhet një trajnim sa i përket aftësimit të komunitetit për fikje të zjarrit, ne si komunë do ju mbështesim.*
3. *Mërgimtarët në komunën tonë e kanë sportelin e veçantë për kryerje të shërbimeve si çdo vit edhe këtë vit, po ashtu mërgimtarëve do ju lejohet që të parkojnë makinat e tyre në oborrin e komunës pa pagesë.*
4. *Dasmat munden të organizohen ashtu siç është marrë vendimi në qeveria e Republikës së Kosovës deri në 50 persona, por gjithnjë kjo duhet të respektohet, në të kundërtën policia duhet të veprojë menjëherë.*
5. *Lokalet e natës ne si komunë dhe si KKSB e kemi marrë një vendim që ato pas orës 23:00 e kanë të ndaluar punën, prandaj lusë inspektoratin dhe policin që të veprojnë nëse këto lokale të natës vazhdojnë punën pas orës 23:00, pra duhet të respektohen vendimet e komunës.*
6. *Zhurma nga muzika dhe motoçiklistët pas orëve të vona, policia e ka gjitha kompetencat dhe mbështetjen e komunës që këta persona të i gjobitë, nuk duhet lejuar që disa persona të prishin qetësin publike të qytetarëve të komunës sonë.*
7. *Sa i përket mallrave të ekspozuara në trotuare, kërkoj nga policia në bashkëpunim me inspektoratin që këto mallra të i largojë menjëherë, pra të i konfiskojë në mënyrë që qytetarët e komunës sonë të mundin të lëvizin lirshëm.*
8. *Lëmosh kërkuesit duhet të hiqen nga rrugët e qytetit sepse vetëm aty kemi më shumë, kërkoj nga polica që të i identifikoj prindërit e tyre ose organizatorët e tyre që i lëshojnë fëmijët në rrugë dhe të merren masa ndaj tyre*

## Pikat e rendit të ditës nga Mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 14.09.2020

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**2. Informatë rreth menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid – 19 nga Komuna e Rahovecit;**

**3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;**

- Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm
- Mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë,
- Vetëdijesimi nga minat dhe mjetet tjera të pa shpërthyera nga lufta,
- Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta,
- Siguria në trafik.
- Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje
- Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit.

**4. Informatë rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2020 -2021;**

**5. Të ndryshme.**

1. Pika e parë është aprovuar pa asnjë vërejtje nga ana e anëtarëve të KKSB-së.
2. Diskutimi ka vazhduar për pikën së dytë rreth menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid – 19 nga Komuna e Rahovecit, Kryetari z: Smajl Latifi e paraqiti një informatë rreth gjendjes së pandemisë me Covid -19 në komunën e Rahovecit, ku ceku se: Ne si komunë i kemi të gjitha të dhënat që nga fillimi i kësaj pandemi, por nuk do ju ngarkoj me ato sepse edhe në mbledhjen e kaluar ju kam dhënë një informatë të tillë. po ashtu i keni edhe në veb faqen e komunës së Rahovecit, në pika shkurta do ju japë edhe për këtë dy muaj një informatë sa i përket Covid – 19. Deri më tani në Komunën e Rahovecit kemi 126 të shëruar nga virusi Covid – 19, raste aktive deri më tani kemi 44, kurse të vdekur nga virusi Covid në Komunën e Rahovecit janë gjithsej 47. Vazhdojmë të bëjmë dezinfektimin e objekteve të institucioneve të komunës, po ashtu tani kemi bërë edhe dezinfektimin e shkollave, çerdheve dhe hapësirat e rëndësishme publike. Ne si komunë kemi material të bollshëm si masë parandaluese të përhapjes së virusit Corona – 19, për faktin që sot edhe ashtu ka filluar mësimi në shkollat tona.
3. Në pikën e tretë është diskutuar sa i përket i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, po ashtu edhe këtu kryetari i komunës z. Smajl Latifi ceku se gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën tonë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, gjithmonë flas duke u bazuar në bazë të informatave të cilat më vinë nga stacioni policor në Rahovec. Nuk kemi ndonjë rast për të ju informuar me diçka e cika do ja vlente dhe do hynte në atë që ne e quajmë prishje të gjendjes së sigurisë në komunën tonë.

Kurse komandanti i stacionit policor në Rahovec z. Fazli Morina, e ka paraqitur një raport para anëtarëve të KKSB –së, sa i përket gjendjes së sigurisë ku potencoi se: Gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit konstatoj se ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu edhe në këto ditë të muajve raportues korrik– deri me 10 shtator, menaxhimi i situatës së krijuar nga Covid – 19, në zonën tonë të përgjegjësisë, të gjitha njësit e stacionit të policisë në Rahovec kanë qenë të angazhuar në drejtim të implementimit të planit operativ për gatishmëri dhe reagim për Covid – 19. Gjatë periudhës raportuese korrik – 10 shtator janë regjistruar 88 raste në përgjithësi, nga këto 85 janë vepra penale dhe 3 incidente të ndryshme, 5 janë vjedhje të lehta, vjedhje të rëndë 6, mbajtja e paautorizuar e armëve kemi vetëm 1 rast, kurse dhuna në familje është në rritje ku kemi pasur 9 raste. Njësitë përkatës të stacionit policor në Rahovec kanë marrë të gjitha veprimet e nevojshme, të gjitha këto raste janë duke u hetuar.

Kurse sa i përket situatës së sigurisë në trafik, ne si polici jemi në vazhdimësi duke ndërmarrë masa të nevojshme të sigurisë për ti mundësuar të gjithëve kategorive pjesëmarrësve në komunikacion një lëvizje të sigurt. Po ashtu lirishtë mundemi të themi se qyteti është i pastruar nga parkimi vend e pa vend i makinave, mundet të ketë edhe në ndonjë vend por aksioni do të vazhdoj, ne nuk do të tolerojmë asnjë parking në trotuare.

Siguria në shkolla, policia vazhdimisht është duke u përkushtuar për sigurinë në shkolla, kurse gjatë periudhës raportuese plani operativ i policisë për sigurinë në shkolla nuk është implementuar për arse se të gjitha këto plane janë pezulluar nga drejtoria rajonale, por kjo nuk do të thotë se nuk do të vazhdojnë më, ne jemi duke pritur vendimin tjetër.
**Lulzim Krasniqi** diskutoi sa i përket identifikimit të hapësirave publike për qasje sa më të lehtë të personave me nevoja të veçanta, ku propozoi që në bashkëveprim me Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe policin e trafikut, të dalin së bashku në teren dhe ta bëjnë identifikimin e të gjitha hapësirave dhe objekteve që nuk kanë qasje për persona me nevoja të veçanta. Në fund të bëhet një plan i përbashkët ku do ti mundësohet një qasja sa më e mirë.
4. Si pikë e katërt është diskutuar përgatitja për fillimin e vitit të ri shkollor 2020 -2021, drejtori i DKA-së z. Avni Morina e dhe një informatë: Me vendim të MASHT-it dhe në koordinim me MSH-së dhe të gjitha institucioneve relevante, ishte marrë vendim që viti shkollor të shtyhet për 14 shtator 2020, Secila komunë para se të fillojë viti shkollor ka themeluar task forcën komunale ku i prinë Kryetari i Komunës dhe kjo task forcë është në koordinim të plotë me task forcat e shkollave. Fillimisht është bërë përgatitja e duhur për fillimin e vitit shkollor , janë furnizuar shkollat me tekste mësimore nga klasat 0-9, është bërë dezinfektimi i shkollave, janë pajisur të gjithë nxënësit e shkollave me maska. Pra për fillim të këtij viti të ri shkollor janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, po ashtu në mbledhjen e mbajtur nga task forca e cila është mbajtur 2 ditë para se të ja fillojë mësimi, ka dalë me një plan konkret: Sipas këtij plani shkollat e mëdha kanë filluar me mësime me nivelin e klasave 0,1,2,3,6, kurse shkollat që kanë numrin e nxënësve mesatar nga 200-500 nxënës, klasat që kanë filluar mësimin janë nga niveli 0-6, kurse shkollat që kanë pak nxënës kanë filluar të punojnë me të gjithë klasat pra nga klasa 0-9.

**Konkluzion nga Kryetari i Komunës për mbledhjen e datës 14.09.2020**

1. *Kërkoj nga Inspektorati komunës dhe policia të bëjë largimin e mallrave të ekspozuara në trotuare.*
2. *Sa i përket atyre që nuk i respektojnë vendimet kundra përhapjes së pandemisë Covid – 19, kërkoj nga drejtoria e shëndetësisë, inspektorati i komunës dhe policia të veprojnë sipas ligjit dhe të ndërmarrin masa ndaj këtyre personave të papërgjegjshëm.*
3. *Të vazhdohet me lirim të trotuareve nga makinat e parkuara, sepse ende ka hapësirë për punë.*
4. *Sa i përket Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta, ne si komunë kemi një plan të veprimit, ka filluar edhe identifikimi edhe shenjëzimi i hapësirave dhe rekomandoj që kjo të vazhdohet dhe të kryhet sa më parë.*
5. *Tek lëmosh kërkuesit, rekomandojmë që të i bëhet apele kryefamiljarëve që të punojnë sa më shumë me fëmijët e tyre, sepse ne jemi duke parë që ka shumë fëmijë që kërkojnë lëmosh. Policia të merret seriozisht me ato raste që nuk janë nga komuna jonë.*
6. *Sa i përket qenve endacak unë e kem ngritë këtë problem në emrin tuaj dehe qytetarëve të komunës edhe me kryeministrin edhe me ministrat përkatës, ju kemi drejtuar edhe me shkresa zyrtare sepse ne nuk e dimë këta qen që lëvizin rrugës a janë të trajtuar. Ne si komunë nuk jemi kompetent, kompetent është AVUKU, prandaj si rekomandim i KKSB-së do të jetë që puna qenve endacak të merret me seriozitet, unë si kryesues i KKSB-së do i dërgoj përsëri emal organeve kompetente me rekomandimin e KKSB-së.*
   *Siguria në trafik – Rekomandim, të kihet më shumë kujdes në trafik nga vozitësit e makinave, kurse komuna si komunë do të kryej detyrat e veta do ti shenjëzoj të gjitha rrugët lokale, kurse ngasësit duhet që ti respektojnë ato.*

## Pikat e rendit të ditës nga Mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 09.12.2020

**R E N D  D I T E**

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
3. **Informatë për periudhën tetor – nëntor, rreth menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid – 19;**
4. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;**
   - Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike,
   - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit
për siguri në shkolla,
   - Mungesa e parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik;
5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2021;**
6. **Të ndryshme.**

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
Sa i përket pikës së parë të rednit të ditës është aprovuar pa asnjë vërejte.
2. **Informatë për periudhën tetor – nëntor, rreth menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid – 19.**
**Kryetari** – Ka cekur se sa i përket menaxhimit të situatës me Covid – 19, ne si komunë i kemi të gjitha të dhënat që nga fillimi i kësaj pandemi e deri në ditën e stome, IKSGP-ja sapo më lajmëroi sot komuna jonë nuk ka asnjë rast dhe ky është një lajm i mirë. Do ju japë disa informata ose disa shifra: Komuna e Rahovecit për momentin i ka 287 të shëruar, 110 raste aktive dhe 45 vdekje, pra gjithsej janë 442 raste, këto janë të dhëna që nga fillimi e deri dje. Vazhdon dezinfektimi i objekteve të institucioneve dhe mjediset publike ku janë më të frekuentuara. Ne si komunë deri diku jemi duke e përballuar mirë situatën edhe pse i kemi dikur rreth 14 mjek të prekur me Covid-19, po ashtu edhe gjendja në arsim është e mirë, ka qenë një nxënës dhe disa mësimdhënës të prekur me Covid – 19, por gjithçka ka shkuar mirë. Mjetet për mbrojtje nga Covid -19 kemi të mjaftueshme, shkollat janë të pajisura me maska dhe dezinfektues, si përfundim shpresojmë se gjendja me Covid -19 të përmirësohet dhe ne do i kthehemi normalitetit sepse shumë biznese janë dëmtuar.
**Nysret Abazibra** - Kurse Imami i Këshillit të Bashkësisë Islame në Rahovec potencoi se nëse e krahasojmë vitin e kaluar me këtë vit, ne si institucion i Bashkësisë Islame në Rahovec konsiderojmë që është një dallim shumë i madh nëse e krahasojmë me vitet e kaluara, ajo që dua të them është se rastet e konstatuara në formë zyrtare ndoshta nuk janë të sakta në krahasim me realitetin. Ne në vitin 2019 kemi pasur 315 raste të vdekjes, kurse në vitin 2020 deri me datën e sodit kemi 471 raste, ndërsa vetëm në muajin që jemi tani dhjetor për 9 ditë kemi 22 raste. Në muaji nëntor kemi pasur 65 raste që kur më parë nuk ka pasur kaq shumë raste. Kjo tregon se gjendja me Covid – 19 është shumë më serioze se sa ne e evidentojmë.
**Fazli Morina** – Të nderuar qoftë varrimet të konfirmuara me Covid – 19, qoftë vdekjet natyrale masat duhet të ndërmerren si për të dyja rastet, ne si patrullë e policisë gjithmonë jemi aty kur ka varrime, por është një pozitë e keqe sepse është vdekje ka dhimbje dhe nuk kemi si të ndërhymë, por nuk është ashtu siç e shkruajnë se është varrosur në prezencën e 20 familjarëve sepse shumë më shumë njerëz marrin pjesë deri në 300. Prandaj ju lusë të gjithëve që jeni sot këtu pjesëmarrës në këtë mbledhje të diskutoni me të afërmit e juaj dhe aty ku mundeni që të i njoftoni me vendimet dhe procedurat të cilat janë anti Covid – 19, në mënyrë që mos të kemi më shumë raste, ne si polici në ato raste jo që nuk mundemi të reagojmë por moralisht nuk po mundemi të marrim masa gjata varrimit të një të afërmi.
3. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.**
**Kryetari** – Ceku se gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile, po e përsërisë se nuk kemi ndonjë rast i cili do e shqetësoj komunën tonë, pra vazhdon që komuna jonë të jetë e qetë, unë si kryetar komune

pranoj çdo ditë raporte nga polica e Rahovecit, po ashtu kemi kontakte të vazhdueshme dhe për këtë e falënderoj edhe policin e Kosovës stacioni në Rahovec. Jo që ja vlen ndoshta të ceket është se jemi duke vazhduar që të sfidohemi nga hajnat, kemi pasur disa vjedhje dhe plaçkitje në disa lokalitete dhe në qytet, por për këtë na informon më mirë komandanti i policisë. Kurse sa i përket nënpikave, mendoj se parkingje në Rahovec ka mjaftueshëm por sa janë duke u shfrytëzuar ajo është diçka tjetër, kurse sa i përket ndriçimit publik, me lejoni që të ju them se ndriçimi publik është duke vazhduar të ritet çdo ditë, ne kemi kontratë dhe jemi duke vazhduar nga fshati në fshat, ju siguroj se asnjë fshat dhe asnjë lagje nuk do të jetë pa ndriçim publik. Sa i përket monitorimit të arsimit të gjithë e dini se si zhvillohet mësimi tani në komunën tonë por edhe në gjithë Kosovën, ne e kemi pranuar një udhëzues se si duhet të i zhvillojmë mësimet, poashtu e kemi edhe task forcën e DKA-së dhe task forcat e shkollave. Vlerësimet në shkolla janë në baza ditore, neve na informojë se si shkon situata nëpër shkolla. kurse sa i përket vetëdijesimit të qytetarëve për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike, ne duhet të përgatitemi sepse viti ri po vije, fishekzjarrët vetëm sa kanë filluar të hedhen, e mira kishte me qenë që të ndërprehet në burim këto gjera, por kjo nuk varet nga ne, mirë kishte me qenë që të ndalen së paku ato që janë më të rrezikshme.
**Fazli Morina -** Poashtu ceku se sa i përket situatës së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, policia e Kosovës me përkushtim dhe profesionalizëm garanton rend publik, qetësi dhe siguri për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit. Kurse sa i përket menaxhimit të situatës së pandemisë Covid – 19, në zonën tonë të përgjegjësisë gjatë periudhës raportuese, të gjitha njësitë e kanë qenë të angazhuara në drejtim të implementimit të Planit operativ të DRP-së Gjakovë, për gatishmëri dhe reagim për Corona virus Covid – 19, si dhe kanë vepruar në përputhje me zhvillimet aktuale dhe zbatimin e vendimeve të qeverisë së Kosovës. Komandanti i policisë poashtu i njoftoi anëtarët e KKSB- së me shqiptimin e disa gjobave si të trafikut, ashtu atyre anti Covid – 19, pastaj arrestimet që janë bërë nga policia e Rahovecit etj.
**4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2021.**
**Kryetari** - Potencoi se ky plan ka qenë në diskutim publik në web faqe të Komunës, ku të gjithë të interesuarit kanë pasur të drejtë që të japim propozimet dhe mendimet e tyre sa i përket planit të punës së KKSB-së për vitin 2021, por sipas z. Skender Hamza, udhëheqëse për Punë të Kuvendit dhe koordinator i KKSB-së, deri më tani nuk ka ardhur asnjë email në adrës të tij sa i përket këtij plani. Prandaj nga ju kërkohet që ky plan të aprovohet ku pastaj do të aprovohet edhe në mbledhje të kuvendit. Plani është aprovuar në mënyrë unanime nga anëtarët e KKSB-së.

**<u>Konkluzion nga Kryetari i Komunës për mbledhjen e datës 14.09.2020</u>**

1. Kërkoj nga Inspektorati komunës dhe policia të bëjë largimin e mallrave të ekspozuara në trotuare.
2. Sa i përket atyre që nuk i respektojnë vendimet kundra përhapjes së pandemisë Covid – 19, kërkoj nga drejtoria e shëndetësisë, inspektorati i komunës dhe policia të veprojnë sipas ligjit dhe të ndërmarrin masa ndaj këtyre personave të papërgjegjshëm.
3. Të vazhdohet me lirim të trotuareve nga makinat e parkuara, sepse ende ka hapësirë për punë.
4. Sa i përket Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta, ne si komunë kemi një plan të veprimit, ka filluar edhe identifikimi edhe shenjëzimi i hapësirave dhe rekomandoj që kjo të vazhdohet dhe të kryhet sa më parë.
5. Tek lëmosh kërkuesit, rekomandojmë që të i bëhet apele kryefamiljarëve që të punojnë sa më shumë me fëmijët e tyre, sepse ne jemi duke parë që ka shumë fëmijë që kërkojnë lëmosh. Policia të merret seriozisht me ato raste që nuk janë nga komuna jonë.
6. Sa i përket qenve endacak unë e kem ngritë këtë problem në emrin tuaj dehe qytetarëve të komunës edhe me kryeministrin edhe me ministrat përkatës, ju kemi drejtuar edhe me shkresa zyrtare sepse ne nuk e dimë këta qen që lëvizin rrugës a janë të trajtuar. Ne si komunë nuk jemi kompetent, kompetent është AVUKU, prandaj si rekomandim i KKSB-së do të jetë që puna

qenve endacak të merret me seriozitet, unë is kryesues i KKSB-së do i dërgoj përsëri emal organeve kompetente me rekomandimin e KKSB-së.
7. Siguria në trafik - Rekomandim, të kihet më shumë kujdes në trafik nga vozitësit e makinave, kurse komuna si komunë do të kryej detyrat e veta do ti shenjëzoj të gjitha rrugët lokale, kurse ngasësit duhet që ti respektojnë ato.

*Skender Hamza* | *Smajl Latifi*

*Kordinatori i KKSB-së* | *Kryetari i Komunës*

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

# DRAFT RREGULLORE NR. 02/2020
# PËR
# PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Nëntor 2020

**RREGULLORE PËR PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS**

**Kuvendi i Komunës së Rahovecit**

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12 paragrafi 2 pika c), nenit 17 pika (k) dhe nenit 40 paragrafi 2 pika a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, të nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.9 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005 i dates 29.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më datë........................... Kuvendi i Komunës së Rahovecit, miraton:

**RREGULLOREN 00/2020 PËR PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS**

## KAPITULLI I
## DISPOZITA TË PËRGJTHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, në zbatim të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe kompetencave vetanake të Komunës së Rahovecit, me qëllim të:
   1.1. Mbrojtjes së fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, ndëshkimit trupor, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës;
   1.2. përcaktimit të detyrave dhe përgjegjësive, të subjekteve për mbrojtjen e fëmijës, si dhe mënyrës së koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit të tyre me qëllim të kontributit në sistemin për mbrojtjen e fëmijës, si dhe
   1.3. kontributit në krijimin e një komunë mike për fëmijë.

### Neni 2
### Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore:
   1.1. zbatohet për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fazat, për të gjitha, masat, veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, nga të gjitha subjektet për mbrojtjen e fëmijës në Komunën e Rahovecit, në përputhje me obligimet e dala nga Ligji për mbrojtjen e fëmijës, këtë rregullore si dhe legjislacionin përkatës në fuqi, dhe

1.2. zbatohet për fëmijën me shtetësi kosovare, pa shtetësi, të pa regjistruar, azilkërkues, refugjat ose me shtetësi të huaj, brenda territorit të Komunës së Rahovecit.

2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk mund të merren si kufizim apo pakësim i të drejtave ekzistuese të fëmijës të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, Konventën për të Drejtat e fëmijës ose me instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

**Neni 3**
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **Administrata komunale-** të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal siç përkufizohet në Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 04 qershor 2008);

1.2. **Fëmijë** –nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet. Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë, derisa mosha e tij të jetë përcaktuar plotësisht;

1.3. **Komunë mike ndaj fëmijës -** nënkupton sistemin e qeverisjes së mirë lokale me fëmijën në qendër, e zotuar për zbatimin dhe realizimin e plotë të të drejtave të fëmijës në nivelin më të lartë të arritshëm, që garanton respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës, dhe që konsideratë mbizotëruese ka interesin më të mirë të fëmijës, mos diskriminimin, mbrojtjen e dinjitetit dhe pjesëmarrjen e fëmijës, duke i dhënë vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë, të kuptuarit e fëmijës dhe rrethanave të rastit;

1.4. **Komunë –** Komuna e Rahovecit, njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);

1.1. **Konventa mbi të drejtat e fëmijës/Konventa -** Konventa mbi të drejtat e fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989;

1.2. **Kryetar-** Kryetari i Komunës së Rahovecit;

1.3. **Kushtetutë -** Kushtetuta e Republikës së Kosovës;

1.4. **Kuvend-** Kuvendi i Komunës së Rahovecit;

1.5. **Ligj -** Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 17 korrik 2019);

1.6. **Ligji për bashkëpunim ndërkomunal** - Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 10 gusht 2011);

1.7. **Ligji për shërbime sociale dhe familjare** - Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare nr. 12, 01 maj 2007) dhe Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare, nr. 5, 05 prill 2012);

1.8. **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë;

1.9. **Ministri** - Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale;

1.10. **Në të gjitha fazat** - përfshin të gjitha procedurat në të cilat fëmija është në kontakt me subjektet për mbrojtjen e fëmijës;

1.11. **Organe komunale** - nënkupton kuvendin dhe kryetarin;

1.12. **Përfaqësues ligjor**- nënkupton prindin/ërit ose personin, që ushtron autoritetin prindëror apo kujdestarin, i cili, brenda përgjegjësive, që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi nga gjykata, ose nga Organi i Kujdestarisë, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës;

1.13. **Qendra për Punë Sociale/QPS** - është institucion publik profesional, kompetent për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të komunës;

1.14. **Statut** - Statuti i Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017.

1.15. **Subjekt për mbrojtjen e fëmijës** – nënkupton çdo persona të punësuar nga autoriteti komunal, administrat komunale, institucion komunal, organ komunal, institucion qendror që vepron në nivel komunal, shërbimet dhe qendrat për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve, të cilat janë nën administrimin e Komunës, apo që veprojnë në nivel komunal, profesionistë për mbrojtjen e fëmijës dhe çdo person apo subjekt tjetër që ka përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në përkujdesjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve;

1.16. **Zyra për Qeverisje të Mirë/ZQM** - nënkupton Zyrën/Njësinë përkatëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin.

# KAPITULLI II
# PARIMET E PËRKUJDESJES DHE MBROJTJES SË FËMIJËS

## Neni 4
## Mbrojtja e jetës dhe të drejtave të fëmijës

Mbrojtja e jetës dhe të drejtave të fëmijës është detyrimi kryesor, në masën maksimale të mundshme, për çdo përfaqësues ligjor, person, subjekt për mbrojtjen e fëmijës, institucion apo organ tjetër në territorin e Komunës së Rahovecit.

## Neni 5
## Parimet për mbrojtjen e fëmijës dhe interesi më i mirë i fëmijës

1. Të gjitha veprimet dhe vendimet, në të gjitha fazat, që kanë të bëjnë me fëmijën, të ndërmarra nga përfaqësuesit ligjor dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës të Komunës së Rahovecit, duhet të jenë në përputhje me parimet dhe dispozitat e Ligjit, që përfshin edhe interesin më të mirë të fëmijës.
2. Për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës, duhet të respektohen parimet e përcaktuara në Ligj dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Kushtetuta, Konventa, Ligji dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.
3. Përfaqësuesit ligjor dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës, në të gjitha fazat dhe në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, koordinojnë masat dhe veprimet e tyre për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës.

## Neni 6
## Parimi i trajtimit të barabartë të fëmijës

Përfaqësuesit ligjor dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës, në të gjitha fazat dhe në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit, duhet të veprojnë në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të fëmijës dhe të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim, që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit, sipas kuptimit të cilido nga bazat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

## Neni 7
## Fryma e edukimit të fëmijës

Të gjithë përfaqësuesit ligjor dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës në Komunën e Rahovecit, duhet të përkujdesen që fëmijët të rriten në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi, ku nuk përdorët ndëshkimi trupor, në mënyrë që të edukohen në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit, dhe fëmijët të përgatiten

plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri, e cila nxit zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës.

**Neni 8**
**Vlerësimi i ndikimit tek fëmijët**

1. Organet dhe administrata komunale, me qëllim të identifikimit të natyrës, përmasave dhe nevojës për mbrojtjen e fëmijës, e bëjnë në mënyrë të rregullt vlerësimin e ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët dhe zhvillojnë procesin për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjislacionit, strategjive e planeve të veprimit dhe programeve për fëmijë.
2. Vlerësimi fillon në faza të hershme, gjatë analizës së situatës së fëmijëve dhe ndikimit të ndërhyrjeve tek fëmija, për të marrë vendime bazuar në interesin më të mirë të fëmijës.
3. Vlerësimi i ndikimit në fëmijë të aspekteve të qeverisjes lokale, duhet të rezultojë me rekomandime për përmirësime si dhe me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga organet komunale në mënyrë që të krijohet një komunë mike për fëmijë si dhe
4. Vlerësimi i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët mund të bëhet edhe nga organizata të shoqërisë civile, të cilat mund t'i referojnë të gjeturat tek organet komunale.

## KAPITULLI III
## PËRKUJDESJA DHE MBROJTJA E FËMIJËS

**Neni 9**
**Përgjegjësia prindërore dhe familjare për përkujdesjen për fëmijën**

1. Mbrojtja kryesore e të drejtave të fëmijës nis në familje, nga prindërit ose kujdestarët.
2. Interesi më i mirë i fëmijës përmbushet kur nevojat e zhvillimit të tij fizik dhe psikologjik, plotësohen brenda kontekstit të familjes së tij biologjike. Të gjithë subjektet duhet të bëjnë çdo përpjekje të promovojnë, mirëqenien e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike përmes ofrimit të përkujdesjes, mbrojtjes dhe këshillimit social dhe në raste të jashtëzakonshme, asistencës materiale.
3. Familja, ka përgjegjësi primare për rritjen, mirëqenien, edukimin dhe mbrojtjen e fëmijës. Përfaqësuesit ligjor dhe anëtarët e tjerë të familjes janë përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha aktet dhe situatat që e vënë fëmijën në rrezik, nga të gjitha format e ndëshkimit trupor, dhunës fizike dhe mendore, neglizhimit, abuzimit, keqtrajtimit, dhe shfrytëzimit dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara në Ligj.
4. Përfaqësuesit ligjor janë të obliguar në radhë të parë të përkujdesen për sigurimin e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur dhe mbajtur raporte vetanake me fëmijën dhe obligimin për

t'i siguruar fëmijës jetën, sigurinë, shëndetin, mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës.

5. Organet dhe administrata komunale dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar integrimin e fëmijës në familje dhe shoqëri dhe të bëjnë çdo përpjekje të promovojnë, mirëqenien e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike përmes ofrimit të përkujdesjes, mbrojtjes dhe këshillimit social dhe në raste të jashtëzakonshme, asistencës materiale.

6. Fëmija mund të largohet nga kujdesi i përfaqësuesit ligjor, vetëm në rastet siç përcaktohet me legjislacion në fuqi.

## Neni 10
## Ndihma prindërve dhe familjeve në përkujdesjen për fëmijën

1. Subjektet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës respektojnë përgjegjësinë kryesore të përfaqësuesve ligjor dhe familjes për përkujdesjën për fëmijën.

2. Subjektet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të parandaluar dhe pakësuar risqet e mundshme me të cilat mund të përballen fëmijët dhe për t'i pajisur prindërit me aftësitë përkatëse jo të dhunshme dhe proaktive për të rritur fëmijët, mbështesin përfaqësuesit ligjor në rritjen e fëmijës së tyre dhe duhet të sigurojnë ndihmat e nevojshme të familjes në nevojë, madje qysh në fazat e hershme kur një gjë e tillë del të jetë e nevojshme, si dhe t'i referojë fëmijën dhe familjen në shërbimet e mbrojtjes së fëmijës, sipas masave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Subjektet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tyre, ndihmojnë dhe ndërhyjnë në familje, në bazë të referimit apo në raste kur familja nuk është në gjendje apo kur ekziston dyshimi i bazuar se familja nuk është në gjendje që të mbrojë fëmijën nga rreziku për jetë, dhuna, neglizhimi, keqtrajtimi, abuzimi dhe shfrytëzimi. Në këtë drejtim, subjektet për mbrojtjen e fëmijës, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tyre, janë të obliguara t'u dalin në ndihmë familjeve në përkujdesjen për fëmijën dhe duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë:

   3.1. familjeve në nevojë, që u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës,

   3.2. fëmijës pa përkujdesje prindërore,

   3.3. fëmijës së neglizhuar, abuzuar apo keqtrajtuar,

   3.4. fëmijës i cili bie në konflikt me ligjin si dhe

   3.5. fëmijës që i përket grupeve të ndryshme shoqërore apo komuniteteve të caktuara.

4. Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të

përhershme nga përkujdesja dhe mbrojtja e prindërve, ose kur për shkak të interesit të tij më të mirë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.

5. Ndërhyrjet dhe shërbimet duhen bazuar mbi njohuri të shëndosha të nevojave të fëmijëve dhe familjeve, dhe duhet të jenë të përshtatura për fëmijën.

**Neni 11**
**Obligimet e komunës ndaj fëmijës**

1. Komuna e Rahovecit, përkujdeset që në territorin e saj, nga të gjitha subjektet për mbrojtjen e fëmijës dhe në të gjitha fazat, të zbatohen plotësisht, të gjitha të drejtat e fëmijës.
2. Organet dhe administrata komunale si dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës, janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtëse dhe riintegruese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e Komunës. Për këtë qëllim, sipas përgjegjësive të përcaktuara në Ligj, duhet të:

4.1. marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të Komunës;
4.2. zhvillojnë masa për të parandaluar rreziqet që rrezikojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës, nevojën e fëmijës për ndihmë dhe për të zvogëluar problemet ekzistuese;
4.3. marrin masa që të parandalojnë dhe të luftojnë rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet ne fuqi;
4.4. zhvillojnë programe dhe projekte për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës;
4.5. organizojnë takime informuese, promovuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës, duke koordinuar dhe harmonizuar veprimet përmes shërbimeve të integruara të sektorëve të edukimit, shërbimeve sociale, shëndetësisë dhe organizatave të tjera qeveritare, joqeveritare dhe komunitetit, për vetëdijesimin e komunitetit dhe arritjen e rezultateve konkrete dhe të sigurta për fëmijët të cilët nuk kanë qasje në shërbimet ekzistuese;
4.6. promovojnë artin, kulturën dhe sportin në institucionet arsimore dhe më gjerë;
4.7. krijojnë një sistem që të jenë më pranë fëmijëve në nevojë dhe sipas nevoje ofrimin e financimit emergjent për fëmijë;
4.8. përkrahin ekzekutimin e masave të diversitetit, masave edukative dhe dënimeve për fëmijë që kanë rënë ndesh me ligjin;
4.9. zhvillojnë praktika të prindësisë së mirë dhe promovimit shëndetësor;
4.10. krijojnë mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët për t'u regjistruar në shkollë, për ta vijuar dhe për përfunduar atë;

4.11. inkurajojnë dhe i mbështesin organizatat e të rinjve dhe fëmijëve dhe u ofrojnë mbështetje organizatave të shoqërisë civile, për të zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrjen e pavarur në fushën e të drejtave të fëmijëve;

4.12. komunikojnë dhe mund të krijojnë partneritet me institucionet qendrore dhe organizatat dhe institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve, në mënyrë që në komunë të sigurohet një mjedis i sigurt për fëmijët.

3. Subjektet për mbrojtjen e fëmijës, kryejnë shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të Komunës, sipas përgjegjësive të përcaktuara në Ligjin për shërbime sociale dhe familjare, standardeve të specifikuara nga Ministria dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

## Neni 12
## Komuna e Rahovecit: Komunë mike ndaj fëmijës

1. Komuna e Rahovecit e përkushtuar në zbatimin e konceptit: Komunë mike për fëmijë, e cila do të mundësojë gjithë përfshirje të fëmijës në përmbushjen e të drejtave të tyre, duke ofruar mbështetje në realizimin dhe jetësimin e qëllimeve për një mirëqenie më të mirë për fëmijët dhe përkujdeset që të gjitha organet dhe administrata komunale, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tyre përkatëse, të marrin masa dhe veprime për të siguruar që çdo fëmijë në territorin e komunës do të:

1.1. ndjehet i sigurtë në rrugë, shkollë dhe në mjedisin ku jeton;

1.2. mbrohet nga shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, dhuna, abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër që mund të vijë si rezultat i moshës apo gjinisë;

1.3. këtë qasje në burime të ujit të pastër dhe të jetojë në një mjedis të pastër dhe me hapësira të gjelbra;

1.4. pranojë shërbimet kryesore, si kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe kujdesi alternativ;

1.5. ketë të drejtë të dëgjohet, të shpreh lirisht opinionet e tij dhe të marr pjesë në proceset vendimmarrëse të rëndësishme lidhur me jetën e tij, si dhe të ndikojnë në vendimet lidhur me ta - në familje, shkollë, komunitet dhe shoqëri;

1.6. këtë në disponim hapësira të mjaftueshme dhe të sigurta për lojëra dhe argëtim;

1.7. marrë pjesë në ngjarjet kulturore, sportive, rekreative dhe sociale;

1.8. këtë qasje të barabartë në secilin shërbim të ofruar nga Komuna, pa asnjë diskriminin në cilido nga bazat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus të veçantë në kategoritë e fëmijëve në nevojë;

2. Subjektet për mbrojtjen e fëmijës kanë përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me konceptin e Komunës mike për fëmijë.

3. Organet dhe administrata komunale në çdo plan vjetor për të drejtat e fëmijës duhet të parashohin masa dhe veprime konkrete për realizimin e konceptit të Komunës mike për fëmijë.

**Neni 13**
**Detyrimi i raportimit për dhunën dhe ndëshkimin trupor ndaj fëmijës**

1. Subjektet për mbrojtjen e fëmijës dhe çdo person që punonë me dhe për fëmijët dhe çdo pjesëtar i profesionit të mësuesisë, infermierisë, mjekësisë, stomatologjisë, psikologjisë ose i policisë apo profesionist tjetër që ka për detyrë përkujdesjen për fëmijët, i cili dyshon ose ka dëshmi se që ndaj fëmijës, qoftë nga ana e prindit ose përkujdesësit të tij apo nga cilido person, është ushtruar çdo formë e dhunës fizike ose mendore, ndëshkim trupor, keqtrajtimi, braktisja, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në Polici ose në Qendrën për Punë Sociale ose tek mbrojtësi i viktimave, në pajtim me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje.
2. Subjektet e caktuara në paragrafin një të këtij neni, për rastet e ndëshkimit trupor në shkolla, raportojnë në Drejtorinë Komunale përkatëse të Arsimit dhe Inspektoratin e Arsimit rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet ne fuqi, dhe këto marrin masa disiplinore ndaj personelit arsimor si dhe i raporton organeve të hetuesisë.
3. Detyra dhe mënyra e raportimit të dhunës ndaj fëmijës duhet të jenë pjesë e programeve të rregullta të trajnimeve, kur përgatiten profesionistët e ardhshëm që do të punojnë me dhe për fëmijët. Kjo duhet të bëhet edhe përmes fushatave të ndryshme promovuese duke përfshirë edhe udhëzimet përkatëse për mënyrën dhe vendin e raportimit.
4. Pamundësia e subjekteve dhe personave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, për të raportuar, sanksionohet sipas ligjit në fuqi.

**Neni 14**
**Plani vjetor për të drejtat e fëmijës**

1. Njësia apo Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës, në kuadër të komunës, udhëheq procesin e hartimit të planit të veprimit si dhe rishikon zbatimin e planit në baza vjetore, bazuar ne vetëvlerësimin komunal.
2. Gjatë hartimit dhe zbatimit të planit vjetor për të drejtat e fëmijës:
    2.1. Njësia apo Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës bashkëpunon me institucionet qëndrore apo lokale përkatëse, organizatat e shoqërisë civile, profesionistët që punojnë për dhe me fëmijët, dhe grupet e tjera relevante;
    2.2. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të komunës të japin kontributin e tyre dhe të marrin pjesë aktive dhe të ofrojnë të dhënat përkatëse;
    2.3. Fëmijët duhet dëgjuar dhe inkurajuar që të kontribuojnë dhe që pikëvështrimet e tyre duhet të merren në konsideratë;
    2.4. Duhet marrë parasysh nevojat dhe specifikat e fëmijëve në Komunë; si dhe

2.5. duhet bazuar në të dhëna dhe njohuri shkencore për mbrojtjen e fëmijës

3. Plani i veprimit për të drejtat e fëmijës duhet të përcaktojë:
   3.1. Prioritetet;
   3.2. objektiva realiste;
   3.3. masat përkatëse;
   3.4. njësitë përgjegjëse dhe
   3.5. afatet;

4. Hartimi dhe zbatimi i Planit vjetor vjetor për të drejtat e fëmijës, duhet mbështetur me burime njerëzore dhe financiare, dhe vlerësimi i tyre duhet bërë në mënyrë sistematike.

5. Plani vjetor vjetor për të drejtat e fëmijës miratohet në Kuvend.

## KAPITULLI IV
## MEKANIZMAT KOMUNAL PËR MBROJTJE TË FËMIJËS

### Neni 15
### Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës

1. Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës, përgjegjëse për zbatimin e kësaj rregulloreje, janë:
   1.1. Kryetari i komunës;
   1.2. Drejtoritë dhe njësitë përkatëse komunale sipas fushës që mbulojnë në lidhje me të drejtat e fëmijës;
   1.3. Qendra për Punë Sociale;
   1.4. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës;
   1.5. Njësia/Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës;
   1.6. Institucionet shëndetësore;
   1.7. Institucionet arsimore publike dhe jopublike në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë;
   1.8. Organizatat e shoqërisë civile (organizatave joqeveritare, shoqatat, klubet dhe organizatat formale dhe joformale);
   1.9. Familjet strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore;
   1.10. Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës dhe
   1.11. Subjetet tjera që kanë përgjegjësitë me legjislacionin përkatës në fuqi.

### Neni 16
### Roli i Qendrës për Punë Sociale

1. Qendra për Punë Sociale, ofron përkujdesje sociale dhe/ose këshillim në rrethanat kur një fëmijë është në nevojë për shërbime sociale dhe familjare dhe duhet të marrë çdo hap të nevojshëm për ruajtjen e sigurisë së fëmijës dhe siguron që shërbimet e ofruara janë në përputhje

me përgjegjësitë që përmban Ligji për shërbime sociale dhe familjare, Ligji dhe legjislacioni përkatës në fuqi.

2. Qendra për Punë Sociale identifikon rastet e fëmijëve që janë në situatë rreziku apo në nevojë dhe ndërhyn për menaxhimin e rastit, së bashku me subjektet përkatëse deri në zgjidhjen përfundimtare.

3. Qendra për Punë Sociale sipas përgjegjësive të përcaktuara në Nenin 15 të Ligjit duhet që të:

   3.1. koordinojë dhe organizojë sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të komunës;

   3.2. zbatojë politikat nacionale dhe lokale për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna;

   3.3. shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në kuadër të komunës, mund të informohen apo të referohen te shërbimet apo institucionet e tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;

   3.4. përcaktojë së paku një (1) zyrtar përkatës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës;

   3.5. Ushtron çdo kompetencë tjetër, në përmbushjen e mandatit që ka, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Qendra për Punë Sociale mobilizon të gjitha subjektet për mbrojtjen e fëmijës për funksionalizuar sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës.

**Neni 17**
**Caktimi i Njësisë/Zyrtarit për mbrojtjen e fëmijës**

1. Kryetari, me qëllim të përmirësimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës si dhe të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara me Ligj dhe këtë Rregullore, sipas vlerësimit të nevojave specifike të komunës, cakton Njësinë/Zyrtarin përkatës për mbrojtjen e fëmijës, nga radhët e punonjësve të QPS-së .

2. Kryetari, siguron që të ndahen burime të mjaftueshme nga buxheti për kryerjen e detyrave të Njësisë apo zyrtarit përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

3. Njësia apo zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës i jep llogari:

   3.1. Kryetarit, për koordinimin dhe raportimin lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe

   3.2. Drejtorit të QPS-së, për mbajtjen në nivel të standardeve të praktikës profesionale dhe ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara me Ligj dhe me këtë rregullore.

4. Kryetari, në afat prej më së largu tre (3) muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, cakton njësinë apo zyrtarin/ët përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

**Neni 18**
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Njësisë apo Zyrtarit përkatës për mbrojtjen e fëmijës**

1. Njësia apo Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës, në kuadër të komunës, ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. bashkëpunon, koordinon, monitoron, raporton, mbron, promovon zbatimin e Ligjit;

1.2. ofron mbështetje në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve lokale për promovimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës;

1.3. mbështetë dhe promovon praktikat e mira dhe ndihmon në ngritjen e kapaciteteve të komunës për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve;

1.4. informon dhe udhëzon, në formën verbale apo të shkruar, për të drejtat e fëmijës dhe për mjetet ligjore të disponueshme për mbrojtjen e fëmijës, për të gjithë punonjësit dhe personat të komunës;

1.5. bashkëpunon dhe kryej detyrat dhe përgjegjësitë e veta në bashkërendim dhe koordinim me ZQM-në si dhe me institucionet tjera kompetente sipas Ligjit;

1.6. prezanton një raport vjetor tek ZQM-ja sipas formatit të përcaktuar nga ajo për zbatimin e Ligjit në kuadër të komunës, duke përfshirë edhe raportin për zbatimin e Konventës pranë Komitetit për të drejtat e fëmijës në Gjenevë;

1.7. bashkëpunon dhe mbështetë ZQM-në dhe institucionet përkatëse në hartimin e planeve relevante të veprimit lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e fëmijës;

1.8. bashkëpunon me Komitetin Ndërministror për të Drejtat e Fëmijës për zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, zbaton rekomandimet e Komitetit, ofron të dhënat e kërkuara nga ZQM në emër të Komitetit, si dhe marrin pjesë në takimet e Komitetit, sipas ftesës dhe agjendës përkatëse;

1.9. mbledh të dhëna statistikore lidhur me rastet e diskriminimit të fëmijës, si dhe të dhëna tjera për fëmijët në territorin e komunës;

1.10. zhvillon aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi lidhur me promovimin e Ligjit, si dhe të kryejë hulumtime, sondazhe në çështjet e të drejtave të fëmijës;

1.11. publikon raporte dhe bën rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, në mënyrë që institucionet përkatëse t'i shfrytëzojnë raportet dhe rekomandimet për të zhvilluar politika, plane të veprimit dhe buxhetin për fëmijë;

1.12. shkëmben dhe siguron informata për Avokatin e Popullit, për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës dhe ato që u përkasin rekomandimeve të Avokatit të Popullit;

1.13. merr pjesë, sipas ftesës, në takimet e Këshillit të Drejtorëve të komunës dhe paraqet raportin, duke përshkruar në detaje punët e kryera për të cilat është përgjegjëse;

1.14. përgatit vetëvlerësimet periodike, të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga Komuna, në mënyrë që të krijohet një Komunë mike ndaj fëmijës;

1.15. siguron sistem komunikimi që mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të komunës dhe institucioneve qendrore;

1.16. siguron sistem komunikimi që mundëson shprehjen e mendimeve të fëmijëve, me pjesëmarrjen e fëmijëve, të cilat përfshihen në punën e qeverisjes në nivel komunal;

1.17. bashkëpunon dhe koordinon mekanizmat në territorin e komunës që merren me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve;

1.18. Përcakton treguesit dhe të dhënat për fëmijët dhe interesat e tyre, sipas prioriteteve të Komunës;

1.19. bashkëpunon me tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit.

1.20. bashkëpunon me Ekipin për të Drejtat e Fëmijës për zbatimin e planit për aftësimin prindëror dhe për cështjet tjera të ndërlidhura sipas legjislacionit në fuqi.

2. Administrata komunale, organet komunale dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet e tyre me Njësinë apo Zyrtarin përkatës për mbrojtje të fëmijës, për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e Ligjit.

**Neni 19**
**Ekipi për të drejtat e fëmijës**

1. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës në nivel të vendimmarrjes politike në kuadër të komunës, ka përgjegjësitë e përcaktuara në Nenin 20 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, që përcaktojnë:

1.1. definimin e prioriteteve të komunës dhe masave të nevojshme që duhet ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të koordinojë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e tyre;

1.2. koordinon dhe monitoron zbatimin e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës;

1.3. kujdeset për zbatimin e rekomandimeve dhe vendimeve të nxjerra nga strukturat e parapara për mbrojtjen e fëmijës sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijës;

1.4. vlerëson dhe siguron përputhshmërinë e politikave, akteve juridike dhe masave të tjera të ndërmarra nga Komuna me legjislacionin, politikat, Strategjinë për të Drejtat e Fëmijës dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

1.5. zhvillimi i programeve, për të parandaluar përfshirjen e fëmijës në fenomene të mundshme negative dhe ulur faktorët e rrezikut që mund të rrezikojnë fëmijët;

1.6. rekomandon kryetarin e komunës për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejme, të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi;

2. Mënyra e themelimit dhe funksionimit të Ekipit për të drejtat e fëmijës rregullohet sipas aktit nënligjor të miratuar nga Qeveria.

3. Kryetari nxjerrë vendime përkatëse dhe krijon kushtet e nevojshme Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, për kryerjen e funksionit sipas Ligjit dhe aktit nënligjor të nxjerrë nga Qeveria dhe sipas nevojës Rregullores që do të miratohet në Kuvend.

## Neni 20
## Asambleja Komunale e Fëmijëve

1. Asambleja Komunale e Fëmijëve përfaqëson në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionet dhe pozitën e të gjithë fëmijëve në Komunë dhe ka përgjegjësitë si në vijim:

1.1. siguron pjesëmarrjen e fëmijës për të pasqyruar në mënyrë të drejtë opinionet dhe qëndrimet e fëmijës, karshi moshës dhe pjekurisë së tyre, në zhvillimin dhe realizimin e veprimeve në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, punës humanitare dhe aktiviteteve të tjera me interes për fëmijët dhe komunitetin;

1.2. avokon tek institucionet përkatëse për të drejtat e fëmijës dhe për çështjet e ngritura nga vetë fëmijët në nivel lokal;

1.3. bashkëpunon me këshillat drejtues të shkollave, këshillat e prindërve, këshillat e nxënësve dhe komunitetin lokal;

1.4. zhvillon dhe bashkëpunon me mekanizmat dhe organizatat tjera;

1.5. ndihmon në ngritjen e vetëdijes për të drejtat e fëmijës, përgjegjësitë dhe gjithë përfshirja e interesave të fëmijëve/nxënësve;

1.6. organizon aktivitete të identifikuara nga vetë fëmijët, dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës;

1.7. inkurajon frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit, në shoqëri dhe tek fëmijët;

1.8. promovon vlerat shoqërore dhe nxitë ndjenjën për t'u marrë në të ardhmen me aktivitete institucionale dhe politike;

1.9. siguron bashkëpunimin e nxënësve dhe mësuesve, edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë;

1.10. informon nxënësit rreth çështjeve me rëndësi të veçantë për ta;

2. Asambleja Komunale e Fëmijëve do të funksionojë sipas Rregullores që do të miratohet në Kuvend.

### Neni 21
### Themelimi i tryezave multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit

Tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve themelohen në nivel profesionistësh, dhe veprojnë mbi bazën e procedurave të detajuara në pajtim me aktin nënligjor që aprovohet nga Qeveria.

### Neni 22
### Roli i personave fizikë dhe juridikë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës

1. Siç është përcaktuar në Nenin 23 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, personat fizikë dhe juridikë, mund të ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës.
2. Personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë edhe zyrtarët e punësuar në institucionet që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës, duhet të licencohen sipas legjislacionit në fuqi dhe duhet t'i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara.
3. Administrata dhe organet komunale, në fushëveprimin e tyre, mund të lidhin kontrata vetëm me personat fizikë dhe juridikë të licencuar apo që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara, për ofrimin e shërbimeve të veçanta për mbrojtjen e fëmijës.
4. Kontrtata sipas paragrafit 3 të këtij neni, duhet të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime të mbrojtjes së fëmijës, përmes procedurave të kontraktimit sipas legjislacionit në fuqi.

### Neni 23
### Familjet strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore

1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale obligohet që të sigurojë që në territorin apo për territorin e Komunës të ketë së paku tri (3) familje strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të vlerësuara, trajnuara dhe të aprovuara sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria.
2. Ministria dhe Komuna i ofrojnë mbështetje materiale familjes strehuese për përkujdesje për fëmijën gjatë qëndrimit në strehim familjar, në pajtim me legjislacionin dhe standardet përkatëse në fuqi.
3. Familja strehuese nuk lejohet të ndaj asnjë informatë me personat e paautorizuar, mediat dhe të tjerët lidhur me fëmijën gjatë qëndrimit dhe pas largimit nga qëndrimi në strehim familjar.

**Neni 24**
**Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës**

Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës themelohen nga Ministria pranë Qendrave për Punë Sociale ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore sipas standardeve të përcaktuara nga ministria dhe aktit nënligjor të miratuar nga qeveria.

**Neni 25**
**Pjesëmarrja aktive e fëmijëve**

1. Organet dhe administrata komunale, institucionet edukative-arsimore, kulturore dhe sportive, mbështesin dhe inkurajojnë krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjve, klubeve të artit, kulturës dhe sportit dhe sigurojnë forma të ndryshme të pjesëmarrjes aktive të fëmijëve në jetën shoqërore.
2. Kryetari nxjerrë vendimet përkatëse dhe i krijon kushtet e nevojshme për format e ndryshme të organizimit të fëmijëve, që janë në interesin më të mirë të fëmijës.

## KAPITULLI V
## BASHKËPUNIMI PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

**Neni 26**
**Bashkëpunimi për mbrojtjen e fëmijës**

1. Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës, bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për identifikimin e çështjeve të zbatimit të masave dhe gjetjes së mënyrave me efektive për mbrojtjen e fëmijës si dhe për zbatimin e kësaj rregulloreje, Ligjit, Ligjit për shërbime sociale dhe familjare, legjislacionit në fuqi dhe të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
2. Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës bashkëpunojnë me ministritë përkatëse dhe me palët e interesuara për hartimin e politikave dhe legjislacionit për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e mbrojtjes së fëmijës si dhe zbatojnë politikat në fushën e mbrojtjes së fëmijës të përcaktuar nga ministritë përkatëse dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës, bashkëpunojnë me Qeverinë, institucionet e drejtësisë, policinë, prokurorinë, gjykatat, shërbimin sprovues dhe shërbimin korrektues, Avokatin e Popullit, Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe insitucionet tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 27**
**Bashkëpunimi ndër-komunal**

1. Për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të mbrojtjes së fëmijës, komuna ka të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi me dy apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në pajtim me format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal.
2. Nismat për vendosjen e bashkëpunimit ndër-komunal nga paragrafi 1 i këtij neni, të ndërmarra nga palët me të drejtë nisme, Kryetari, 1/3 e anëtarëve të Kuvendit, së paku 5 % e qytetarëve të komunës me të drejtë vote apo nga Qeveria, merren me prioritet nga administrate dhe organet komunale.
3. Dispozitat e Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal vlejnë edhe për të gjitha format e bashkëpunimit ndër-komunal për mbrojtjen e fëmijës. Këto marrëveshje nënshkruhen nga kryetarët dhe miratohen nga kuvendet komunale që janë pjesëmarrëse në bashkëpunimin ndër-komunal. Marrëveshja e bashkëpunimit ndër-komunal bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj nga Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale dhe publikimit të marrëveshjes në Gazetën Zyrtare.

**Neni 28**
**Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare për mbrojtjen e fëmijës**

1. Organet dhe administrata komunale:
   1.1. bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në pajtim me këtë rregullore dhe aktit nënligjor të përcaktuar nga Qeveria;
   1.2. sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare në çështjet e mbrojtjes e fëmijës dhe në aktivitetet planifikuese dhe zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla.
   1.3. Mbajnë komunikime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e fëmijëve në komunë nga një perspektivë tjetër.
2. Organizatat joqeveritare të licencuara nga Ministria, sigurojnë shërbimet përkatëse të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, qoftë me nismën e tyre ose me kontratë.
3. Administrata dhe Organet komunale mund të hyjnë në kontrata me organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe familjare brenda territorit të tyre. Kontratat e tilla duhet të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime sociale dhe familjare në territorin e saj.

## KAPITULLI VI
## PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËS

### Neni 29
### Promovimi i të drejtave të fëmijës

1. QPS, Njësia apo Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës dhe administrata komunale, ndërmarrin masa konkrete, në mënyrë që të promovohen, mbrohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, përmes, lansimit të fushatës së promovimit lidhur me të drejtat e fëmijës dhe hartimit të programeve të trajnimit dhe organizimin e trajnimeve për të drejtat e fëmijëve për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve që merren me të drejtat e fëmijëve dhe për persona të cilët punojnë me fëmijë ose për fëmijë në nivel komunal;
2. Kujdes i veçantë duhet kushtuar promovimit të:
   - 2.1. mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe ndëshkimit trupor;
   - 2.2. mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna e shfaqur qoftë nga personeli arsimor, bashkëmoshatarët;
   - 2.3. ndalimit të gjuhës së urrejtjes, dhunës, jo tolerancës, diskriminimit dhe formave tjera që nxisin konflikte ndër njerëzore;
   - 2.4. ndalimit të praktikave dhe zakoneve diskriminuese ndaj fëmijës;
   - 2.5. inkurajimit të mësim-nxënien gjatë gjithë jetës, të zhvillimit të respektit të fëmijës për identitetin kulturor, për gjuhën dhe vlerat kombëtare, respektin për kulturat e ndryshme si dhe respektin për ruajtjen e mjedisit;
   - 2.6. kujdesit shëndetësor parandalues që siguron zhvillim optimal të fëmijës;
   - 2.7. mbrojtjes së fëmijëve nga përdorimi i substancave narkotike, alkoolit, produkteve të duhanit, produkteve toksike, substancave psikotrope dhe substancave të tjera që janë të deklaruara të dëmshme nga autoritetet përkatëse;
   - 2.8. mbrojtjes së fëmijëve nga hyrja në klubet e natës, lokalet e lojërave të fatit, qasja në lojërat e fatit online si dhe në qendrat argëtuese për të rritur dhe të ngjashme.
   - 2.9. mbrojtjes së fëmijëve nga publikimet, filmat, video lojërat, muzika, transmetimet ose llojet e tjera mjetet e komunikimit masiv, të cilat janë të dëmshme për shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e tyre;
   - 2.10. mbrojtjes së fëmijëve nga ndikimet e mundshme negative që ekspozimi ndaj medieve mund të ketë mbi fëmijën;
   - 2.11. eliminimit të diskriminimit dhe paragjykimeve ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara.
   - 2.12. Mbrojtjes së fëmijës nga rrëmbimi, trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe akteve të tjera në fuqi;
   - 2.13. Mbrojtjes së fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik dhe Puna e ndaluar për fëmijë, dhe

2.14. Masave kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës.

2.15. Programeve përkatëse dhe atyre vetanake të rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me efektet e dëmshme të ndëshkimit trupor dhe edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor dhe programe përkatëse dhe atyre vetanake prindërimi, që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe institucione edukativo arsimore dhe në Institucione të Kujdesit.

**Neni 30**
**Seanca/t vjetore për të drejtat e fëmijëve**

1. Kuvendi organizon të paktën një (1) seancë vjetore, për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijëve.
2. Në seancën/at vjetore për të drejtat e fëmijëve secili drejtor i drejtorisë komunale raporton për çështjet, veprimet dhe masat që janë në përgjegjësinë e tij dhe që kanë të bëjnë më të drejtat e fëmijëve, si dhe paraqet aktivitetet që janë ndëmrarrë për realizimin e Planit vjetor për të drejtat e fëmijës.
3. Në Seanca/t vjetore për të drejtat e fëmijëve marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile, Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, Asamblesë së Fëmijëve dhe kanë të drejtë të parashtrojnë pyetje.
4. Seanca/t vjetore për të drejtat e fëmijëve organizohen në koordinim me Njësinë/zyrtarin përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

**Neni 31**
**Ditët mike për fëmijë**

1. Nën patronatin e Kryetarit të Komunës organizohen dhe mbahen "Ditët mike për fëmijë".
2. Gjatë këtyre ditëve organizohen aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e subjekteve të ndryshme që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
3. Kryetari i Komunës me vendim i cakton datat e "Ditëve mike për fëmijë" në Komunë dhe përcakton përgjegjësitë e mekanizmave përkatëse për detyrat e tyre në këto ditë dhe aktivitetet konkrete që duhet ndërmarrë.

## KAPITULLI VII
## DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

**Neni 32**
**Përgjegjësia individuale**

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për mbrojtjen e fëmijës kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë shkeljen.

## Neni 33
## Buxhetimi për fëmijë

1. Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijës, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme.
2. Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet ne konsultime me palët, duke i përfshirë edhe fëmijët. Ky buxhet i reflekton nevojat për ndarjen e burimeve për fëmijë ne te gjitha aspektet e qeverisjes komunale.
3. Administrata dhe organet komunale zhvillojnë një proces për analizimin e nevojave te buxhetimit për fëmijët e komunës, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit. Ky proces përfshinë:
    3.1. analizën e buxhetit të përgjithshëm komunal për të vlerësuar pjesën e shpenzuar për fëmijë dhe sa kanë përfituar fëmijët nga investimet publike të Komunës;
    3.2. ndarjen e përqindjes së nevojshme, bazuar në Planin e veprimit për mbrojtjen e fëmijëve, nga granti i përgjithshëm, te ndarë nga Qeveria për Komunë;
    3.3. analizon adekuate të buxhetit te përgjithshëm komunal dhe elementet brenda tij, ne mënyrë qe te zbulohet pjesa qe është shpenzuar për fëmijë dhe te shfrytëzohen produktet e zhvilluara për të investuar në fëmijë;
    3.4. analizën e ndarjes buxhetore për fëmijë ndër vite dhe tregon trendet e ndarjeve buxhetore për fëmijë.
4. Kryetari bashkëpunon me Ministrinë dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për mbrojtjen e fëmijës, dhe marrjen e fondeve për mbrojtjen e fëmijëve.

## Neni 34
## Ngritja e kapaciteteve për mbrojtjen e fëmijës

1. Për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të gjithë punonjësit e komunës, vecanarishtë punonjësitë që kanë përgjegjësi direkte në mbrojtjen e fëmijës, janë të obliguar të ndjekin trajnime dhe aktivitete që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së fëmijës si dhe të venë në shfrytëzim, në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përftuar.

2. Organet komunale duhet të luajnë rol të vazhdueshëm dhe proaktiv që të jenë në hap me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës dhe në këtë drejtim organizojnë apo inkurajon zyrtarët komunal për pjesëmarrje në trajnime për aspekte të të drejtave të fëmijës dhe buxhetimit për fëmijë.
3. Punonjësit që kanë përgjegjësi në mbrojtjen e fëmijës, trajnohen në nivel teorik dhe praktik, duke përdorur metodologjinë "mësimi nëpërmjet punës".

**Neni 35**
**Informimi në interes të fëmijës**

1. Zyra përkatëse për informim në Komunën e Rahovecit, në bashkëveprim me QPS-në dhe Njësinë apo Zyrtarin përkatës për mbrojtjen e fëmijës, përmes fushatave, ligjeratave publike si dhe materialeve të ndryshme promovuese për ngritjen e vetëdijes për të rriturit e fëmijët, krijojnë një sistem të informimit për tërësinë e shërbimeve që ofrohen për fëmijë dhe informata të tjera të cilat janë në interes të fëmijës.
2. Organizatat e shoqërisë civile inkurajohen dhe përkrahen që të monitorojnë, promovojnë dhe informojnë për të drejtat e fëmijës.

**Neni 36**
**Raporti për zbatimin e rregullores**

1. Njësia/Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe nxjerre raporte vjetore.
2. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të komunës për ofrimin e të dhënave të kërkuara nga Njësia/Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

**Neni 37**
**Zbatimi**

1. Përgjegjësia në radhë të parë për zbatimin e kësaj rregulloreje është për organet dhe administrata komunale e Komunës së Rahovecit.
2. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e Zëvendës kryetarit.
3. Kryetari mund të nxjerrë Vendime për zbatimin e kësaj Rregulloreje.
4. Administrata dhe Organet komunale janë të obliguara qe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për krijimin e mekanizmave për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive përkatëse.
5. Subjektet për mbrojtjen e fëmijës janë të obliguara qe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive përkatëse.

**Neni 38**
**Interpretimi i Rregullores**

1. Kjo rregullore duhet interpretuar dhe zbatuar brenda kuadrit të Kushtetutës, Konventës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.
2. Në të gjitha rastet kur ka kundërthënie të kësaj Rregulloreje me Ligjet dhe dispozitat e Statutit të Komunës do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe statutit.

**Neni 39**
**Publikimi**

1. Kjo rregullore publikohet në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtare.
2. Kjo rregullore dhe ndryshimet e mëpasshme të saj publikohen ueb faqen e komunës dhe në "Gazetën Zyrtare".

**Neni 41**
**Përgatija e Planit vjetor për të drejtat e fëmijës**

1. Organet e përcaktuara në këtë rregullore janë të obliguara që të përgatisin Planin vjetor për të drejtat e fëmijës, duke marrë parasysh nevojat dhe specifikat e fëmijëve në Komunën e Rahovecit si dhe duke marrë parasysh mundësitë buxhetore dhe kohën në dispozicion, duke toleruar shmangien nga standardet e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Përgatitja e Planit të parë vjetor për të drejtat e fëmijës, duhet të shërbejë për analiza përkatëse në mënyrë që në vitet pasuese të respektohen kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.

**Neni 42**
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, publikohet në ueb faqen e komunës.
2. Në ditën në të cilën kjo rregullore publikohet në ueb faqe të komunës do të përcaktohet si dita e shpalljes.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga data 1 janar 2021.

**Smajl Latifi**

______________________

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 pika 1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Kryetarit të Komunës me Nr. Protokolli 00/00/00 të dt. 00.00.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.01.2021 miraton këtë:

**VENDIM**
**Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit te Komunës 02 Nr. 012/01/21 i dt. 11.01.2021 dhe shpallet interes i përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale **P-71510066-00386-1,** në sipërfaqe prej **1000m$^2$ (njëmijë metra katror)** nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22005m$^2$ (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur Seishte, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E Kosovës, K.K. Rahovec, Shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë: **"Caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit të fshatit Pastasellë".**
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01 Nr.___/21**
**Datë:29.01.2021**

**Afrim Dina**

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 011 Nr. i faq/Br.str/No.pg 166
Data/Datum/Date 11/01/2021

Në mbështetje të nenit 13, nenit 14.1, nenit 17 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

**PROPOZON**
**Shpalljen me interesi të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë**

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon inicimin e procedurës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510066-00386-1** në Pastasellë, në sipërfaqe prej **1000m² (njëmijë metra katror)** nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur Seishte, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E. Kosovës, K.K. Rahovec, Shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec.

2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës së cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë: **"Caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit të fshatit Pastasellë".**

3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në Librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

4. Për zbatimin e këtij Propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

5. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Të njoftohen:***

- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit,***
- ***Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT**
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510066-00386-1

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **08-942/03-0000836/21** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 08.01.2021 - 09:00 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | PASTASELLË / PUSTO SELO / PUSTOSELLË |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-71510066-00386-1** | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | **22005** | 1-2004 | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| SEISHTE-SEISHTE/SEISHTE-SEISHTE/SEISHTE-SEISHTE | | SEISHTE-SEISHTE | | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Atip.Kryeziu | P-71510066-00386-1 |

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Oborr/Dvorište/BackYard | | 21540 |
| 2 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building | | 465 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>single possessor | PASURI SHTET.E<br>KOSOV.K.K.RAHOVEC<br>SHFRY. EKO.E PYJEVE<br>RAHOVEC | KCID1505767 | RAHOVEC /<br>ORAHOVAC /<br>RAHOVEC / | | RAHOVEC | 1/1 | 1-2004 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pastasellë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Povšina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510066-00386-1 | Parcelë / Parcela / Parcel | 22005 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1529

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.01.2021

Koha/ Vreme/ Time: 09:13:52

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

# Skicë Tereni

Z.k. Pastasel

P/1:750




Rahovec dt. 08.01.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. prot 2254 Më 10.07.20 20
RAHOVEC - ORAHOVAC

# KËRKESË

Për: Kryetarin e Komunës, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë e Urbanizmit, **Drejtorinë për Kadaster Gjeodezi dhe Prone** dhe Komitetit për Politikë dhe Financa.

Nga: Këshilli i fshatit Pastasel.

1. Rregullimin e kanalizimit në disa pjesë të fshatit dhe bartja e një pjese afërsisht 700 metra nga pika që ku derdhet kanalizimi,
2. Kubëzimi i rrugëve të fshatit.
3. Eliminimin e deponive ilegale në një pronë publike dhe dy private,
4. Një trotuar në fshat në rrugën kryesore,
5. **Lejimi i një hapësire për ndertimin e një objekti për novoja të fshatit,**
6. Një park afër varrezave të Dëshmorëve e Martirëve,
7. Drunjë dekorativ.
8. Ndriçimin Publik,

Me respekt Këshilli i fshatit Pastasel

10.07.2020

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

**Kuvendi Komunal Rahovec**
Skupština Opštine Orahovac/Municipality Assembly Rahovec

---

**Këshilli i Fshatit Hoçë e Madhe**

**Lënda:** Raporti vjetorë i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe
**Për:** Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit – z. Afrim Dina.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2020 Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe ka mbajtur 14 mbledhje të cilat në përgjithësi janë kryesuar nga kryetari i këshillit të fshatit z. Bojan Pavloviq.

Në fillim të vitit është përpiluar strategjia e punë së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për periudhën ekzistuese.

- Aktivitet e filluara **në përpunim të planit zhvillimor janë ndërprerë për shkak të rrethanave të reja të krijuara nga pandemija COVID 19.**
- Vizita e anëtarëve të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe pranë ministrive gjegjëse (projektet dhe aktivitetet e dakorduara momentalisht janë ndërprerë për shkak të rrethanave të reja të krijuara).
- Vizita studimore e qytetit Butrint, Sarandë (Shqipëri) – nderimi i përvojës me përfaqësues të zonave të mbrojtura.

- **Shqyrtimi i kërkesës së dërguar nga drejtoria për urbanizëm nr. 114 i datës 16.07.2020.**

Parashtrues i kërkesës: **Jugosllav Gariq.**

Kërkesa për renovimin e shtëpisë familjare. Ndërrimi i konstruksionit të kulmit dhe trarëve. Kërkesa në përputhje të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, pas shqyrtimit është aprovuar renovimi.

- **Shqyrtimi i kërkesës së dërguar nga drejtoria për urbanizëm nr. 134 i datës 24.07.2020.**

**Kërkesë për ndërtimin e shtëpisë familjare në parcelën personale.**

Parashtruesi i kërkesës: **Sasha Çubanoviq**

Kërkesa në përputhje të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, pas shqyrtimit është aprovuar ndërtimi.

- **Shqyrtimi i kërkesës së dërguar nga drejtoria për urbanizëm nr. 187 i datës 13.10.2020.**
- Parashtruesi i kërkesës: **Zlatko Lukiq**
- **Kërkesë për ndërtimin e shtëpisë familjare në parcelën personale.**
- Kërkesa në përputhje të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, pas shqyrtimit është aprovuar ndërtimi.

- **Shqyrtimi i kërkesës së dërguar nga drejtoria për urbanizëm nr. 195 i datës 17.11.2020.**

**Parashtruesi i kërkesës Dioqeza e Rashkës – Prizrenit**

Kërkesa e parë, pas mospërputhjes së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, e kthyer pranë drejtorisë për urbanizëm dhe Dioqezës së Rashkës – Prizrenit, për korrigjim në mënyrë që ndërtimi të jetë në përputhje me ligjin.

Pas pranimit të kërkesës së re (Është korrigjuar metri katror i objektit në mënyrë që të jetë në përputhje me ligjin për fshatin Hoçë e Madhe) është formuar komisioni e përbër nga anëtarët e këshillit.

Komisioni ka konstatuar që kërkesa e re është në përputhje me ligjin e fshatit Hoçë e Madhe dhe është dhënë pëlqimi për ndërtim.

- **Shqyrtimi i kërkesës së dërguar nga drejtoria për urbanizëm nr. 222 i datës 23.11.2020.**

**Parashtruesit e kërkesës:**

1. Nebojsha Dolasheviq
2. Gjoka Miciq
3. Zlatko Lukiq

- **Kërkesat për ndërtimin e shtëpisë familjare në parcelën personale.**

- Kërkesat në përputhje me Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe, pas shqyrtimit është aprovuar ndërtimi.

Deri në përpilimin e këtij raporti, raporti financiar i këshillit nuk është aprovuar.

Nr. protokolli; **6**

Me datë:

**05.01.2021**

Kryetari i këshillit të fshatit Hoçë e Madhe

**NËNSHKRIMI**

**Bojan Pavlloviq**